VENDIM
Nr. 81, datë 21.11.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Genti Ibrahimi	anëtar,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 19.11.2024 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 12 (S) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: SALI BERISHA, përfaqësuar nga avokatët Klodiana Gjyzari dhe Genci Gjokutaj, me prokurë të posaçme.

SUBJEKT I INTERESUAR:

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përfaqësuar nga prokurorët Arben Kraja dhe Enkeleda Millonai, me autorizim.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm, Genci Gjonçaj.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 112, datë 20.10.2023, dhe nr. 117, datë 26.10.2023, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 56 (87-2023-156), datë 21.11.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2024-384, datë 5.3.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 3, 4, 5, 7, 15, 17, 18, 27, 29, 31, shkronja "b", 32, pika 2, 38, 42, 46, pika 1, 73, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta);* nenet 5, 7, 10, 14 dhe 18 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(KEDNJ);* nenet 9, 14, 15, 25 dhe 26 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, të ratifikuar me ligjin nr. 7510, datë 8.8.1991, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike"; nenet 27 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar *(ligji nr. 8577/2000).*

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesit Sali Berisha *(kërkuesi),* i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar *(Prokuroria e Posaçme),* që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë *(Kuvendi),* i cili nuk ka mbajtur qëndrim për çështjen, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është një politikan, ish-president dhe ish-kryeministër, aktualisht deputet i Kuvendit dhe kryetar i partisë kryesore opozitare.

2. Mbi bazën e një kallëzimi për kryerjen e disa veprave penale nga funksionarë të lartë shtetërorë, të bërë nga shtetasi T.B., i cili në atë kohë ka qenë kryetari i grupit parlamentar të partisë në pushtet, Prokuroria e Posaçme në vitin 2020 ka regjistruar procedimin penal nr. 287 për veprën penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale", të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal *(KP)*. Objekti i kallëzimit dhe i hetimit në vijim lidhet me procesin e kthimit të pronës në favor të 5 familjeve ish-pronare, procesin e privatizimit të pronës shtetërore (të objekteve të ish- klubit sportiv "Partizani"), procesin e ndryshimit të destinacionit dhe, më pas, edhe të zhvillimit të pronës.

3. Me urdhrin e datës 2.10.2023, prokurorët e çështjes kanë shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale edhe emrin e kërkuesit Sali Berisha, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale "Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë", në bashkëpunim me shtetasit J.M. dhe F.B., të parashikuar nga nenet 260 e 25 të KP-së. Për sa i përket kërkuesit, faktet penale objekt hetimi lidhen me sjelljen e dyshuar të tij gjatë kohës kur ai ka ushtruar funksionin e Kryeministrit, pas vitit 2005, në proceset e kthimit të pronës, të privatizimit të pronës shtetërore (objekteve të klubit sportiv "Partizani" në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Klubit Shumësportesh Partizani në varësi të Ministrisë së Kulturës), të ndryshimit të destinacionit dhe të zhvillimit të pronës, duke favorizuar shtetasit J.M., F.B. e XH.B., ku këta të fundit dhe shoqëria e lidhur me ta kanë realizuar ndërtimin e një blloku pallatesh. Për këto procese dyshohet se janë dhënë dhe marrë përfitime monetare, paligjshmëria në origjinën e të cilave është fshehur nëpërmjet veprimeve financiare, transaksioneve të copëzuara ose në *cash*.

4. Në datën 16.10.2023 Prokuroria e Posaçme ka paraqitur në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*) kërkesën për caktimin e masave të sigurimit personal ndaj personave nën hetim, përfshirë edhe kërkuesin Sali Berisha, për të cilin është kërkuar vendosja e masave të sigurimit personal "*Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore*" dhe "*Ndalimi i daljes jashtë shtetit",* të parashikuara nga nenet 234 dhe 233 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*). Sipas Prokurorisë së Posaçme, ekziston dyshimi i arsyeshëm, i mbështetur në prova, se nga ana e kërkuesit, në ushtrim të pushtetit të tij si Kryeministër, janë kryer veprime konkrete dhe aktive në drejtim të: përgatitjes dhe miratimit të projektligjeve dhe të projektvendimeve të qeverisë, në bashkëpunim me aleatët e vetë politikë, me qëllim përshtatjen e tyre sipas nevojave që paraqiteshin për pesë familjet ish-pronare, ku përfitues i drejtpërdrejt ishte dhe shtetasi J.M., bashkëshorti i vajzës së tij; kryerjes së kontrolleve administrative, duke shfrytëzuar kompetencat e vartësve të tij, me qëllim ushtrimin e presionit dhe dhënien e urdhrave konkrete për veprime që duhet të kryenin funksionarët që pengonin procesin e privatizimit të klubeve sportive në favor edhe të shtetasit J.M.; vendosjes në dispozicion të shtetasit J.M. të strukturave të ndryshme të administratës shtetërore për realizimin e procesit të kthimit të pronës, privatizimit të pronës shtetërore dhe ndryshimit të destinacionit të pronës edhe në favorin e këtij shtetasi. Po ashtu, sipas Prokurorisë së Posaçme, përfitimi i parregullt në favor të shtetasit J.M. lidhet me dyshimin se të gjitha këto procedura, pavarësisht interesit publik në lidhje me nevojën për ambiente sportive, janë bërë me qëllimin e vetëm për të shtënë në dorë pronën dhe për ta përdorur atë për përfitime materiale, ku si të tilla janë konsideruar të gjitha ato përfitime monetare që ky shtetas ka marrë përmes shoqërisë ndërtuese, konkretisht nga shpërndarja e fitimeve të saj të akumuluara ndër vite përpara se ai të deklarohej bashkortak i saj, të llogaritura në shumën 672 976 832 lekë ose 5 420 345 euro.

5. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, gjyqtari i hetimeve paraprake, me vendimin nr. 112, datë 20.10.2023, ka vendosur të pranojë kërkesën e Prokurorisë së Posaçme, duke caktuar për kërkuesin masat e sigurimit personal me karakter shtrëngues "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" dhe "Ndalimi i daljes jashtë shtetit", të parashikuara nga nenet 234 dhe 233 të KPP-së. Sipas asaj gjykate, në rastin konkret plotësohen kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për caktimin e masave të sigurimit, të parashikuara në nenin 228 të KPP-së, pasi nga aktet dhe provat e

administruara deri në këtë fazë të hetimeve krijohet dyshimi i arsyeshëm se kërkuesi ka konsumuar elementet e veprës penale për të cilën është proceduar penalisht dhe nuk ekzistojnë shkaqe padënueshmërie ose të shuarjes së saj. Në vijim, sipas asaj gjykate, ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës në funksion të hetimit të çështjes, pasi për shkak të marrëdhënieve të krijuara si rezultat i ushtrimit më parë të funksionit të Kryeministrit, por edhe atij aktual si deputet, sikundër edhe të influencave që mund të ketë te persona të tjerë, ekziston mundësia që personi nën hetim të ndërhyjë dhe ndikojë në prishjen ose asgjësimin e provave, si dhe në krijimin e rrethanave që vështirësojnë mbledhjen e tyre, çka do të ndikonte në një hetim të mangët për sqarimin e plotë të faktit penal për të cilin dyshohet. Po ashtu, vijon gjykata, ekziston rreziku i largimit të personit nën hetim nisur nga sanksioni dhe marzhi i lartë që parashikon ligji për veprën penale që ai dyshohet, konkretisht nga 4 deri në 12 vjet burgim. Për sa u takon kritereve për caktimin e masave të sigurimit të parashikuara në nenin 229 të KPP-së, sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë, ajo ka mbajtur parasysh rëndësinë e faktit dhe rrezikshmërinë e lartë të veprës penale, sanksionin me burgim të parashikuar për të dhe përhapjen e gjerë të saj, rolin e personit nën hetim dhe kryerjen e veprës penale në formën e bashkëpunimit, pasojat e ardhura prej saj, si dhe moshën e gjendjen gjyqësore të personit nën hetim, referuar të cilave masat e sigurimit të kërkuara nga prokurori janë në përshtatje me shkallën e nevojave të sigurimit në rastin konkret.

6. Në datën 23.10.2023 Prokuroria e Posaçme, e ngarkuar për ekzekutimin e vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë nëpërmjet shërbimeve të Policisë Gjyqësore të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, i ka paraqitur asaj gjykate aktin e datës 22.10.2023 në lidhje me zbatimin përmes njoftimit të masës së sigurimit personal të vendosur ndaj kërkuesit. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, gjyqtari i hetimeve paraprake, ka caktuar datën 24.10.2023, ora 13:30 për zhvillimin e seancës për marrjen në pyetje të kërkuesit në funksion të verifikimit të kushteve dhe të kritereve të caktimit të masës dhe nevojave të sigurimit. Kërkuesi nuk është paraqitur në atë seancë, por janë paraqitur mbrojtësit e zgjedhur prej tij, të cilët kanë parashtruar disa kërkesa procedurale përpara asaj gjykate, më konkretisht: i. përjashtimin e gjyqtares së hetimeve paraprake; ii. pajisjen me kopje të akteve që ka depozituar organi i akuzës dhe lënien e një kohe të mjaftueshme për t'u njohur me to; iii. dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*) për interpretimin e nenit 73, pika 2, të Kushtetutës. Më pas mbrojtësit e kërkuesit janë larguar nga salla e gjykimit. Në vijim, pas disa shtyrjeve, seanca për pyetjen e kërkuesit është zhvilluar në datën 26.10.2023, në mungesë të tij, ndërsa ai është mbrojtur nga një avokat i caktuar kryesisht nga gjykata, në kushtet kur mbrojtësit e zgjedhur nga kërkuesi nuk janë paraqitur.

7. Për sa u takon kërkesave procedurale të paraqitura nga mbrojtësit e zgjedhur nga kërkuesi, GJKKO-ja e Shkallës së Parë në seancën e datës 24.10.2023 ka vendosur shtyrjen e saj për ditën e nesërme, në datën 25.10.2023, me qëllim për t'iu dhënë mundësi mbrojtësve të kërkuesit të njihen me aktet e procedimit, si dhe për të paraqitur në formën e kërkuar nga ligji kërkesën për përjashtimin e gjyqtares së hetimeve paraprake mbi shkakun se vendimi i caktimit të masës së sigurimit është në shkelje të nenit 73, pika 2, të Kushtetutës dhe se për këtë kanë paraqitur kallëzim penal ndaj saj. Në vijim, në seancën e datës 25.10.2023, ku sërish janë paraqitur vetëm mbrojtësit e zgjedhur nga kërkuesi, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vendosur të rrëzojë kërkesën e paraqitur në atë seancë për dërgimin e çështjes në Gjykatë për interpretimin e nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, të shprehjes "t'i hiqet liria në çfarëdo lloj forme", me arsyetimin se nuk vërehen dyshime për paligjshmëri kushtetuese për vënien në lëvizje të kontrollit kushtetues incidental. Edhe në këtë seancë mbrojtësit e kërkuesit kanë deklaruar se kërkojnë përjashtimin e gjyqtares së hetimeve paraprake për të njëjtin shkak të artikuluar edhe më parë, kërkesë të cilën do ta paraqisnin pasi të merrnin procesverbalin audio të seancës, përveçse edhe dhënien e një kohe të mjaftueshme për t'u njohur me aktet e depozituara nga organi i prokurorisë, duke u larguar sërish nga salla e gjykimit. Seanca për marrjen në pyetje të kërkuesit është shtyrë nga gjykata për ditën e nesërme, në datën 26.10.2023, me qëllim dhënien e mundësisë mbrojtësve të kërkuesit për t'u njohur me aktet e procedimit penal. Ndërsa, kërkesa me shkrim në formën e kërkuar nga ligji për përjashtimin e gjyqtares së hetimeve paraprake është paraqitur vetëm në datën 26.10.2023, ndërkohë që ajo dhe

është shqyrtuar po atë ditë, nga një gjyqtare tjetër e asaj gjykate, e cila, me vendimin nr. 430, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, me arsyetimin se nuk ekziston asnjë nga rastet ligjore të parashikuar nga neni 17 i KPP-së që të ketë ndikuar në sjelljen e gjyqtares së hetimeve paraprake, e cila të sillte cenimin e paanshmërisë. Seanca e marrjes në pyetje të kërkuesit është zhvilluar në këtë datë (26.10.2023), në mungesën e tij dhe në prani të një mbrojtësi të caktuar kryesisht nga gjykata, ndërsa mbrojtësit e zgjedhur nga kërkuesi nuk janë paraqitur pa njoftuar gjykatën për ndonjë shkak të arsyeshëm.

8. Në përfundim të seancës për marrjen në pyetje, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 117, datë 26.10.2023, ka vendosur vazhdimin e zbatimit të masave të sigurimit të vendosura nga ajo më herët ndaj kërkuesit, ku për sa i përket masës "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" ka urdhëruar kërkuesin të paraqitet të hënën e parë dhe të tretë të çdo muaji, ora 10:00, përpara oficerit të Policisë Gjyqësore pranë Prokurorisë së Posaçme, ndërsa për sa i përket masës "Ndalimi i daljes jashtë shtetit" ka urdhëruar kërkuesin të mos largohet nga territori i Republikës së Shqipërisë pa autorizimin e gjykatës, si dhe ndalimin e përdorimit të pasaportës dhe të dokumenteve të tjera identifikuese të vlefshme për daljen jashtë shtetit të tij.

9. Në vlerësimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë, edhe pas seancës së pyetjes së personit nën hetim, në mungesë të parashtrimit nga ai të fakteve, argumenteve apo provave në dobi të tij, ndërsa në mënyrë të vullnetshme ka zgjedhur të mos paraqitet duke hequr dorë kështu nga e drejta për t'u pyetur (dëgjuar), rezulton se kushtet dhe kriteret e caktimit të masës, si dhe nevojat e sigurimit të mos kenë ndryshuar, pra ato vijojnë të ekzistojnë, ndaj, për rrjedhojë, zbatimi i masave të sigurimit të caktuara ndaj kërkuesit me vendimin e saj nr. 112, datë 20.10.2023 duhet të vazhdojë. Për këtë, po sipas asaj gjykate, mbahet në konsideratë edhe sjellja e kërkuesit, pas njoftimit të masës, ndërsa referuar deklaratave të tij për të mos e zbatuar atë, ngrihet dyshimi për rrezikun se ai nuk do të jetë në dispozicion të organit procedues gjatë hetimeve paraprake. Ajo gjykatë ka analizuar edhe pretendimin e mbrojtjes së kërkuesit për shkeljen e nenit 73, pika 2, të Kushtetutës në caktimin e masave të sigurimit ndaj kërkuesit, në kushtet e mungesës së autorizimit nga ana e Kuvendit, duke e gjetur atë të pabazuar.

10. Kundër vendimeve të GJKKO-së së Shkallës së Parë, atij nr. 112, datë 20.10.2023, për caktimin e masave të sigurimit personal dhe atij nr. 117, datë 26.10.2023, për vazhdimin e zbatimit të masave të sigurimit personal, kërkuesi ka paraqitur ankim në gjykatën e apelit, në përfundim të shqyrtimit të të cilit, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO e Apelit*), me vendimin nr. 56 (87-2023-156), datë 21.11.2023, ka vendosur miratimin e vendimeve të GJKKO-së së Shkallës së Parë. Edhe GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se plotësohen kushtet për caktimin ndaj kërkuesit të masave të sigurimit personal me karakter shtrëngues dhe se masat e caktuara dhe të zbatuara ndaj tij janë në përputhje me kriteret dhe nevojat e sigurimit në rastin konkret. Sipas saj, ekziston një dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova për kryerjen nga kërkuesi të veprës penale për të cilën është proceduar penalisht, se nuk ka shkaqe padënueshmërie apo të shuarjes së saj, si dhe se ekziston rreziku i "helmimit" të marrjes ose vërtetësisë së provave, sikundër edhe ai i largimit të kërkuesit. GJKKO-ja e Apelit ka shqyrtuar pretendimet e ngritura në ankim për shkeljen e nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, për mungesën e paanësisë së gjyqtares së hetimeve paraprake, për shkeljen e së drejtës së mbrojtjes efektive dhe për mungesën e arsyetimit të vendimit gjyqësor, ku pas një analize të bëra atyre, ka arritur në përfundimin se janë të pabazuara. Kundër vendimit të GJKKO-së së Apelit kërkuesi ka paraqitur rekurs.

11. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-384, datë 5.3.2024, ka vendosur mospranimin edhe të rekursit të paraqitur nga kërkuesi, duke vlerësuar se është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Sipas Kolegjit Penal, gjykatat kanë argumentuar mjaftueshëm dhe në mënyrë ezauruese kushtet dhe kriteret për caktimin dhe zbatimin e masave të sigurimit personal me karakter shtrëngues dhe proporcionalitetin e tyre. Po ashtu, Kolegji Penal ka arsyetuar se gjykata e apelit u ka dhënë përgjigje pretendimeve në ngritura në ankimin e mbrojtësve të kërkuesit, ndërsa në vendimmarrjen e saj nuk konstatohet mosrespektim ose zbatim i gabuar i ligjit material apo procedural penal me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e

praktikës gjyqësore, apo me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave, sikundër nuk konstatohet që vendimi i saj të jetë në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

12. Në datën 29.7.2024 kërkuesi, nëpërmjet përfaqësuesve të tij, i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në po të njëjtën datë. Me vendimin e datës 17.9.2024, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Ndërkohë, në datën 16.9.2024 kërkuesi ka paraqitur në Gjykatë kërkesë për përshpejtimin e shqyrtimit të gjykimit të çështjes së tij, e cila është pranuar nga Mbledhja e Gjyqtarëve me vendimin e datës 17.9.2024.

13. Pas kalimit të çështjes për shqyrtim në seancë plenare, në datën 15.10.2024, një gjyqtar i Gjykatës ka paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes, e cila është rrëzuar nga Mbledhja e Gjyqtarëve me vendimin nr. 23/1, datë 17.10.2024. Gjithashtu, edhe kërkuesi në datën 18.10.2024 ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e këtij gjyqtari nga shqyrtimi i çështjes, e cila, po ashtu, është rrëzuar nga Mbledhja e Gjyqtarëve me vendimin nr. 24, datë 6.11.2024.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

14. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se në caktimin e masave të sigurimit ndaj tij gjykatat kanë zhvilluar një proces jo të rregullt, në drejtim të:

14.1. *Parimit të paanshmërisë në gjykim dhe të pavarësisë,* pasi: i. në *aspektin objektiv* gjyqtarët e GJKKO-së nuk ofrojnë garanci paanësie apo pavarësie, sepse sipas neneve 48-51 të ligjit nr. 95/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", të ndryshuar *(ligji nr. 95/2016),* të gjitha komunikimet elektronike dhe të tjera të gjyqtarëve, përfshirë edhe ato familjarëve të tyre, janë të vëzhguara. Ky vëzhgim është i pakufizuar në kohë dhe hapësirë, kryhet pa asnjë arsye specifike, si edhe nuk monitorohet *a priori* ose kontrollohet *a posteriori* nga ndonjë gjykatë në lidhje me proporcionalitetin e kësaj ndërhyrjeje. Për më tepër, vëzhgimi realizohet nga hetuesi i telekomunikimeve që është pjesë e Byrosë Kombëtare të Hetimit (*BKH*), e cila varet nga Prokuroria e Posaçme, që është organi që ka kërkuar masat e sigurimit personal në rastin e kërkuesit dhe i mbron ato përpara gjykatave; ii. në *aspektin subjektiv*, gjyqtarja e GJKKO-së I.GJ., që ka vendosur masën shtrënguese ndaj kërkuesit, është shkarkuar nga detyra e gjyqtares nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë (*KLD*) në vitin 1996, kohë kur ky institucion kryesohej nga kërkuesi në cilësinë e Presidentit të Republikës.

14.2. *Së drejtës së mbrojtjes efektive,* pasi: i. kërkuesi nuk është njoftuar për përmbajtjen e vendimit nr. 112, datë 20.10.2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë sipas rregullave të parashikuara nga neni 246, pika 3, i KPP-së. Në këtë mënyrë, gjykimi i verifikimit të kushteve të zbatimit të masës së sigurimit është zhvilluar pa u njohur kërkuesi me vendimin e arsyetuar me të cilin janë caktuar masat e sigurimit personal ndaj tij. ii. GJKKO-ja e Shkallës së Parë nuk i ka dhënë kohën e mjaftueshme mbrojtësve të zgjedhur nga kërkuesi për të realizuar një mbrojtje efektive. iii. Mbrojtësja e caktuar kryesisht nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë, shtetasja V.T., ishte e papërshtatshme për të mbrojtur kërkuesin, për shkak të qëndrimeve të saj kundër tij në rrjetet sociale. Ajo duhej të përjashtohej si avokat i caktuar kryesisht për të njëjtin shkak që u përjashtua edhe avokati i mëparshëm i caktuar kryesisht. iv. GJKKO-ja e Shkallës së Parë nuk e ka dorëzuar vendimin e arsyetuar sipas afatit të përcaktuar nga neni 248, pika 2, i KPP-së.

14.3. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe së drejtës së aksesit,* pasi: i. Kolegji Penal nuk i ka dhënë përgjigje pretendimeve me natyrë kushtetuese të ngritura në rekurs dhe atyre që kishin të bënin me interpretimin dhe zbatimin e gabuar të dispozitave procedurale penale; ii. në vendimin e tij Kolegji Penal nuk përdor gjuhën shqipe, por një gjuhë me terma dhe fjali të pakuptueshme, të cilat krijojnë konfuzion dhe nuk përcjellin vijimësi të mendimit logjik e juridik dhe konkluzionit të arritur, duke e bërë vendimin të pakuptueshëm; iii. vendimet e gjykatave përmbajnë të dhëna kontradiktore, nuk janë logjike dhe nuk i kanë dhënë përgjigje shteruese pretendimeve të kërkuesit;

(iv) gjykatat nuk kanë marrë parasysh asnjë nga provat dhe pretendimet e ngritura nga kërkuesi dhe nuk kanë analizuar provat e ndodhura në dosjen gjyqësore.

14.4. *Parimit të proporcionalitetit,* pasi gjykatat nuk kanë arsyetuar nevojshmërinë e caktimit të masave të sigurimit personal ndaj kërkuesit, duke cenuar lirinë e tij personale dhe atë të lëvizjes, të drejtën për t'u zgjedhur dhe të drejta të tjera kushtetuese. Masa e sigurimit personal ndaj kërkuesit është caktuar në shkelje të ligjit, nuk është e arsyeshme ose e nevojshme dhe është qartazi joproporcionale me qëllimin e kërkuar. Procedimi penal ndaj kërkuesit ka filluar në datën 1.12.2020, pas kallëzimit të deputetit T.B., i cili që prej vitit 2012 ka dalë publikisht me të njëjtat pretendime me ato të pasqyruara në kallëzim. Ndërkohë kërkuesi nuk ushtron asnjë funksion në administratën publike përveç atij të deputetit. Aktet për të cilat akuzohet janë akte normative me efekt të përgjithshëm dhe nuk i drejtohen një personi apo grupi personash të caktuar. Që nga momenti i fillimit të hetimit paraprak në datën 1.12.2020, për fakte që kanë ndodhur në vitin 2012, dhe deri në datën 16.10.2023, kur është dorëzuar kërkesa për caktimin e masës së sigurimit personal, për kërkuesin nuk ka asnjë të dhënë, dëshmitar, shkresë ose indicie të largët, nga e cila të rezultojë se ai në ndonjë mënyrë ka ndikuar mbi këto akte ose të jetë përpjekur të zhdukë ndonjë prej tyre. Gjykatat nuk arsyetojnë në vendimet e tyre se në cilën mënyrë kërkuesi ka ndikuar për ndryshimin e akteve ligjore ose nënligjore të propozuara apo miratuara prej tij, pra të ketë ndikuar mbi provat.

14.5. *Kufizimit të lirive kushtetuese* të kërkuesit, pasi kanë tejkaluar qëllimet për të cilat lejohet kufizimi, duke cenuar nenin 17 të Kushtetutës dhe nenin 18 të KEDNJ-së. Procedimi penal ka filluar para tre vjetësh, për fakte të cilat pretendohet se kanë ndodhur më shumë se 10 vjet më parë dhe që kallëzuesi i ka pretenduar që prej vitit 2012. Qëllimi i vërtetë i izolimit të kërkuesit ka qenë shuarja e zërit të opozitës dhe jo zbulimi i të vërtetës dhe shkaqet për të cilat janë caktuar masat e sigurimit ndaj tij kanë pasur si qëllim pengimin që ai të organizojë opozitën.

14.6. *Mosrespektimit të nenit 73, pika 2, të Kushtetutës,* duke i kufizuar kërkuesit lirinë personale dhe atë të lëvizjes, të mbrojtura nga nenet 27 dhe 38 të Kushtetutës, në kundërshtim me procedurën e parashikuar në këtë dispozitë, pa autorizim të Kuvendit. Togfjalëshi i përdorur në nenin 73, pika 2, të Kushtetutës "*... t'i hiqet liria në çfarëdo lloj forme*" nuk nënkupton, në asnjë rast, vetëm caktimin e masave të sigurimit personal "Arresti në burg" ose "Arresti në shtëpi", por përfshin edhe masat e sigurimit personal të vendosura ndaj kërkuesit, të cilat i kanë kufizuar lirinë personale dhe të lëvizjes.

14.7. *Mosrespektimit të nenit 73, pika 1, të Kushtetutës,* pasi i. kërkuesit i është kufizuar liria personale dhe e lëvizjes për fakte të cilat mbrohen nga imuniteti absolut i deputetit. Kërkuesi nuk mund të ndiqet penalisht për veprimet e kryera në ushtrim të detyrës së deputetit; ii. ndaj kërkuesit, drejtues i opozitës parlamentare, është zbatuar një standard i ndryshëm nga ai i mbajtur në rastin e ish-deputetit të shumicës parlamentare dhe ish-ministrit S.T., ku Kuvendi ka vlerësuar se masat e sigurimit personal "Ndalimi i daljes jashtë shtetit" dhe "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" janë masa shtrënguese të heqjes së lirisë. Interpretimi i Kuvendit në atë rast është ai që duhej të ndiqej nga gjykatat edhe në rastin e tij, pra se masat e sigurimit të caktuara ndaj kërkuesit janë masa shtrënguese të heqjes së lirisë, për të cilat duhet autorizim nga Kuvendi.

14.8. *Kufizimit të të drejtave kushtetuese për veprime që nuk parashikohen nga ligji si vepër penale,* pasi: i. kërkuesi është akuzuar për miratimin e akteve normative me fuqi juridike në të gjithë territorin dhe jo për akte individuale që kanë për qëllim favorizimin e një personi, siç është rasti i bashkëshortit të vajzës së kërkuesit ose një grupi të përcaktuar personash; ii. gjykatat nuk kanë evidentuar se disa nga ndryshimet në aktet ligjore dhe nënligjore, për të cilat kërkuesi akuzohet se i ka kryer për të favorizuar shtetasin J.M., janë bërë gjatë kohës kur në pushtet ka qenë shumica qeverisëse. Për më tepër, nga verifikimi i ndryshimeve ligjore dhe nënligjore për të cilat akuzohet kërkuesi, evidentohet se janë pothuajse të njëjtat formulime me parashikimet e mëparshme, por edhe me parashikimet ligjore të cilat janë aktualisht në fuqi dhe që nuk janë propozuar nga kërkuesi; iii. nuk ekziston asnjë lidhje shkakësore midis akteve nënligjore të miratuara nga organet shtetërore të drejtuara nga kërkuesi në cilësinë e Kryeministrit dhe interesave pasurorë të shtetasit J.M.; iii. nuk rezulton të jetë vërtetuar asnjë nga elementet e veprës penale për të cilën është akuzuar kërkuesi. Ai nuk rezulton

të ketë qenë pjesë e komisionit që ka përgatitur ndryshimet e ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004, "Për kthimin dhe kompensimin e pronave" dhe as të ketë propozuar asnjëherë ligje si deputet. Edhe ndryshimet e bëra në ligjin për sportin, të cilat janë bërë edhe me mbështetjen e deputetëve të Partisë Socialiste, nuk kanë pasur ndikim dhe nuk mund të ndikonin në procesin e kthimit apo kompensimit ose në procedurat e privatizimit në favor të familjes, trashëgimtar i së cilës është edhe dhëndri i kërkuesit, shtetasi J.M.

14.9. *Parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve,* pasi duke hetuar dhe ngritur akuza mbështetur në vlerësimin nëse dy ligje dhe vendimi i Këshillit të Ministrave kanë qenë të nevojshme apo të drejta, si dhe mbi bazueshmërinë në prova të disa akteve të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave *(AKKP),* Prokuroria e Posaçme ka marrë kompetencat e Kuvendit, Gjykatës Kushtetuese dhe gjykatave të zakonshme. Prokuroria e Posaçme ka vlerësuar: i. politikën sociale dhe ekonomike, pra programin e qeverisë, duke marrë kompetencat e Kuvendit; ii. nevojshmërinë, drejtësinë apo procedurën e diskutimit dhe miratimit të ligjeve e akteve nënligjore, duke marrë kompetencat e Gjykatës; iii. bazueshmërinë në ligj të vendimeve të formës së prerë të AKKP-së, duke marrë atributet e gjykatave civile; iv. qëllimet dhe përfitimet e palëve në kontrata civile, duke cenuar lirinë kontraktore.

15. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme***, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

15.1. Pretendimi i kërkuesit për cenimin e *parimeve të pavarësisë dhe paanshmërisë* është i pabazuar. Kërkuesi nuk ka arritur të provojë paanshmërinë ose mungesën e pavarësisë së gjyqtarëve, si në aspektin objektiv ashtu edhe atë subjektiv, pasi: i. Ligji nr. 95/2016 ka vendosur garanci të rëndësishme gjatë procesit të monitorimit, ku oficerit përgjegjës nuk i lejohet të dëgjojë telefonatat që cenojnë të drejtën për jetë private të personave që nuk kanë dhënë miratim paraprak për vëzhgim. Ligji nr. 95/2016 e ka kaluar vlerësimin e përputhshmërisë me Kushtetutën që i është bërë në konsultimin e draftit final nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë në datën 3.10.2016. Në thelb argumentet e kërkuesit në këtë drejtim kanë të bëjnë me shfuqizimin e dispozitave ligjore. Ndërkohë që Gjykata kur vihet në lëvizje për shqyrtimin e një ligji që rishikon Kushtetutën, nuk shqyrton përmbajtjen ose përputhshmërinë e amendamenteve kushtetuese me Kushtetutën e mëparshme, por vetëm procedurën me të cilën janë miratuar këto ndryshime. Për rrjedhojë, edhe kushtetutshmëria e dispozitave të ligjit nr. 95/2016 nuk mund të shqyrtohet nga Gjykata. ii. Për sa i përket pretendimit për paanshmërinë subjektive të gjyqtares I.GJ., kërkuesi u referohet ngjarjeve të vitit 1996, pra një marrëdhënieje të përfunduar para 27 vjetësh, për të cilat nuk ka sjellë asnjë provë në mbështetje të këtij pretendimi.

15.2. Pretendimi i kërkuesit për cenimin e *së drejtës së mbrojtjes efektive* është i pabazuar, pasi: i. për vendimin nr. 112, datë 20.10.2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë janë kryer të gjitha veprimet për t'ia vënë në dispozicion kërkuesit, por ai ka shfrytëzuar të gjitha mundësitë për të mos e marrë atë, duke refuzuar kështu njohjen me vendimin; ii. në seancën gjyqësore të datës 24.10.2023 vendimi u është vënë në dispozicion mbrojtësve të kërkuesit, duke qenë se ata gëzonin tagrat për të marrë në dorëzim akte për llogari të kërkuesit. Mbrojtësve të kërkuesit u është lënë një kohë e mjaftueshme për t'u njohur me aktet e dosjes për të realizuar mbrojtjen e tij, por ata zgjodhën të mbroheshin duke kërkuar shtyrjen e seancës dhe nëpërmjet kërkesave të tjera procedurale; iii. GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vepruar në respektim të të drejtave të kërkuesit, duke i caktuar atij edhe mbrojtës kryesisht.

15.3. Pretendimet për cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* dhe *të së drejtës së aksesit* janë të pabazuara, pasi gjykatat i kanë kushtuar vëmendjen e duhur provave të paraqitura, analizës së tyre, bazës ligjore dhe kanë konkluduar më pas në vendimmarrjet respektive. Pretendimet e kërkuesit kanë marrë përgjigje të arsyetuar nga gjykatat dhe vendimi për caktimin e masës së sigurimit përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 245 të KPP-së. Edhe vendimet e GJKKO-së së Apelit dhe Gjykatës së Lartë i përmbajnë elementet për arsyetimin e tyre dhe vendimet e kundërshtuara janë logjike, nuk kanë kundërthënie, si dhe përmbajnë referenca në ligjin e zbatueshëm.

15.4. Edhe pretendimi për cenimin e *lirisë personale,* në kundërshtim me nenet 27 dhe 38 të Kushtetutës, është i pabazuar, pasi nga leximi i neneve 27 dhe 28 të Kushtetutës konstatohet se bëhet fjalë për burgosje të individit ose heqje të lirisë në kuptimin e kapjes së tij. Neni 73 i Kushtetutës nuk ka si qëllim mbrojtjen e çdo lloj lirie, pasi kjo do të binte në kundërshtim me atributet e tjera për të cilat prokurorisë i është lejuar të veprojë pa autorizim të Kuvendit. Autorizimi i Kuvendit kërkohet vetëm në rast se kërkohet "Arresti në burg" ose "Arresti në shtëpi" dhe jo për çdo lloj heqje lirie të mundshme të personit nën hetim. Termat "në çfarëdo lloj forme" nuk nënkuptojnë "çfarëdo lloj lirie". Në rastin e ish-deputetit dhe ish-ministrit S.T., Prokuroria e Posaçme nuk ka kërkuar të njëjtat masa sigurimi si në rastin e kërkuesit, por ka kërkuar autorizim për arrestimin e tij, duke mos qenë para rasteve të njëjta. Masa e sigurimit "Ndalimi i daljes jashtë shtetit" e vendosur ndaj kërkuesit nuk e ka kufizuar në lirinë e lëvizjes brenda territorit, pjesëmarrjes në Kuvend apo komisione parlamentare, si dhe kryerjen e të gjitha aktiviteteve të tij personale. Ky ndalim nuk është vendosur në atë masë që të barazohet me heqjen e lirisë.

15.5. Pretendimet për kufizimin e *lirisë personale dhe të lëvizjes* për fakte të cilat ai gëzon imunitet, sipas nenit 73, pika 1, i Kushtetutës janë të pabazuara, pasi kërkuesi nuk është ngarkuar me përgjegjësi penale vetëm se ka miratuar ligje apo akte nënligjore, por për faktin se sjellja e tij ka pasur si qëllim dhe motivim realizimin e objektivave të kërkuar nga subjekti aktiv i mitës dhe jo në funksion të ushtrimit të detyrës që i është besuar. Këto objektiva në një pikë përputhen edhe me ato të dhëndrit të tij si trashëgimtar i familjes në favor të cilës është kthyer prona, me qëllim shtënien në dorë të mitës, përfitimit të premtuar. Ai ka ushtruar pushtetin e tij në mënyrë të paautorizuar, duke i dhënë formën që ka dëshiruar ligjeve dhe akteve nënligjore për t'ia përshtatur interesave të familjes së tij.

16. ***Subjekti i interesuar, Kuvendi,*** ka sjellë përpara Gjykatës raportin e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, të shumicës parlamentare, si dhe vendimin nr. 127, datë 21.12.2023 të Kuvendit për miratimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme për dhënien e autorizimit nga Kuvendi për arrestimin/heqjen e lirisë së deputetit Sali Berisha, por nuk ka paraqitur prapësime me shkrim dhe qëndrim të tijin në lidhje me çështjen.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

17. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si edhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

18. Gjykata vëren, fillimisht, se kërkuesi ka kundërshtuar në objektin e kërkesës vendimet gjyqësore që kanë caktuar ndaj tij masat e sigurimit personal. Ndërkohë, në përmbajtje të ankimit kushtetues kërkuesi ka sjellë argumente që lidhen me cenimin e parimeve të paanshmërisë dhe pavarësisë, duke ngritur si shkak papajtueshmërinë me Kushtetutën të neneve 48 - 51 të ligjit nr. 95/2016 dhe duke pretenduar, në thelb, se për shkak të përmbajtjes së tyre atij i është cenuar e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme dhe e pavarur. Në këtë kuptim, duke pasur parasysh se objekti dhe shkaqet e kërkesës, me të cilat ngrihet çështja e kushtetutshmërisë, përbëjnë thelbin *(thema decidendum)* e gjykimit kushtetues *(shih vendimin nr. 22, datë 11.4.2016, të Gjykatës Kushtetuese)* dhe se sipas nenit 48, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000: "kufijtë e shqyrtimit të çështjes janë brenda objektit të kërkesës dhe shkaqeve të parashtruara në të", Gjykata, në vijim, duke e

konsideruar si një kërkim të mëvetshëm verifikimin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të përmbajtjes së dispozitave ligjore të ligjit nr. 95/2016[1], vlerëson të ndalet në verifikimin e kritereve të legjitimimit të kërkuesit në drejtim të secilit prej kërkimeve të kërkesës në shqyrtim.

19. Gjykata, bazuar në parashikimet e nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, si dhe neneve 49, pika 3, shkronja "e" dhe 71, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë se objekt i ankimit kushtetues individual mund të jetë edhe ligji ose akti normativ, ka vlerësuar se kërkuesi legjitimohet nëse plotësohen bashkërisht këto kritere: *i.* individi provon se është bartës i së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar, si dhe provon interesin në lidhje me çështjen, pra cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të së drejtës kushtetuese *(legjitimimi ratione personae); ii.* janë shteruar mjetet juridike efektive për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar ose individi provon se akti i kundërshtuar është drejtpërdrejt i zbatueshëm; *iii.* ankimi është paraqitur brenda afatit 4-mujor nga konstatimi i cenimit *(legjitimimi ratione temporis); iv.* individi provon se pretendimet e ngritura janë të tilla që bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, pra të drejtat dhe liritë themelore, që pretendohen se janë cenuar, janë të garantuara në Kushtetutë, si dhe shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur *(legjitimimi ratione materiae) (shih vendimet nr. 38, datë 12.7.2023; nr. 4, datë 21.2.2022; nr. 31, datë 4.10.2021, të Gjykatës Kushtetuese).*

20. Kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës "f" të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës "i" të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, për kundërshtimin e vendimeve gjyqësore që kanë caktuar masat e sigurimit personal ndaj tij, pasi ka qenë palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

21. Në lidhje me kërkimin e kërkuesit për cenimin e parimeve të paanshmërisë dhe pavarësisë, për shkak të parashikimeve të ligjit nr. 95/2016, Gjykata vëren se ligji nr. 95/2016 ka si objekt të tij, ndër të tjera, përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Posaçme, e cila është organi që ka vënë në lëvizje këtë proces penal ndaj kërkuesit, sikundër edhe të Njësisë së Posaçme Hetimore, organe kushtetuese këto sipas pikës 4 të nenit 148 të Kushtetutës; përcaktimin e kushteve dhe kritereve shtesë të sigurisë që duhet të përmbushin gjyqtarët, ndër të tjera, edhe për t'u ngritur në detyrë si gjyqtarë pranë gjykatave të posaçme; përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e procesit të kontrollit të figurës, vëzhgimit të të dhënave financiare dhe të telekomunikacioneve, ndër të tjerë, edhe të gjyqtarëve të gjykatave të posaçme dhe të anëtarëve të afërt të familjeve të tyre (neni 1). Sipas nenit 6, pika 1, të ligjit, ndër të tjerë, kandidati për gjyqtar në gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar duhet të plotësojë kushtet e sigurisë përpara se të caktohet në këtë pozicion dhe asnjë kandidat nuk mund të caktohet në detyrë pa plotësuar këto kushte. Sipas shkronjave "a" dhe "b" të së njëjtës dispozitë të ligjit (nenit 6, pika 1), kushtet e sigurisë para caktimit në detyrë janë: *a)* kontrolli i verifikimit të pasurisë dhe të figurës; *b)* dhënia e pëlqimit nga kandidati për kontrollin periodik të llogarive të tij bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, për të cilën ai plotëson dhe nënshkruan një deklaratë standarde me shkrim; *c)* dhënia e pëlqimit nga anëtarët e afërt të familjes së kandidatit për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, për të cilën ata plotësojnë dhe nënshkruajnë një deklaratë standarde me shkrim. Ndërkohë, rregullat për organizimin dhe funksionimin e procesit të kontrollit të kushteve të sigurisë për besimin dhe konfidencialitetin edhe për kandidatin për gjyqtar të gjykatave të posaçme, janë parashikuar në kreun III të të njëjtit ligj, përkatësisht nenet 48–54, ku përfshihen edhe dispozitat e kundërshtuara nga kërkuesi (nenet 48–51). Në këto dispozita përcaktohet mënyra e heqjes dorë nga të drejtat si kusht për caktimin në detyrë edhe të gjyqtarëve të gjykatave të posaçme, vëzhgimit periodik të llogarive financiare dhe

[1] Gjyqtarët Holta Zaçaj, Sonila Bejtja dhe Genti Ibrahimi vlerësuan që parashtrimet e kërkuesit lidhur me efektin e këtyre dispozitave të trajtoheshin si argumente në funksion të kërkimit për konstatimin e cenimit të parimeve të pavarësisë dhe paanësisë së gjyqtarit të GJKKO-së së Shkallës së Parë, në funksion të testit objektiv të paanësisë të gjyqtarit, dhe jo si kërkim me vete.

telekomunikimeve, organi dhe personi përgjegjës për mbikëqyrjen, si dhe roli i prokurorit të posaçëm në kuadër të këtij procesi kontrolli periodik edhe i gjyqtarëve të gjykatave të posaçme.

22. Gjykata vëren se për sa kohë që dispozitat e kundërshtuara nga kërkuesi janë të zbatueshme edhe ndaj gjyqtares që ka caktuar masat e sigurimit personal ndaj tij mbi bazën e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme, dhe për sa kohë që kërkuesi ka vënë në dyshim parimet e pavarësisë dhe paanshmërisë së asaj gjyqtareje, për shkak të rolit të prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme në procesin e kontrollit periodik të gjyqtarëve të gjykatave të posaçme, sipas dispozitave të kundërshtuara, ky pretendim lidhet me garantimin e së drejtës kushtetuese për një proces të drejtë, ndaj konsiderohet se kërkuesi ka justifikuar interesin e tij për të kërkuar shfuqizimin e dispozitave të ligjit nr. 95/2016.

23. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka funksion përfundimtar dhe, si e tillë, mund të zbatohet në lidhje me vendime për të cilat kanë përfunduar procedurat gjyqësore. Cenimi i të drejtave themelore mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelimeve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte *(shih vendimet nr. 18, datë 19.3.2024; nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 14, datë 11.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese).*

24. Gjykata vëren se ajo është vënë në lëvizje për kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të vendimeve gjyqësore që kanë caktuar ndaj kërkuesit masat e sigurimit personal "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" dhe "Ndalimi i daljes jashtë shtetit". Për shkak të natyrës së ndërmjetme, jo përfundimtare, të këtyre vendimeve, për sa kohë që ato janë dhënë në kuadër të një procedimi penal që është ende duke u zhvilluar, Gjykata do të analizojë në vijim nëse përjashtimisht ato mund të konsiderohen përfundimtare për ushtrimin e kontrollit kushtetues ndaj tyre.

25. Në këtë kuptim, në jurisprudencën kushtetuese janë evidentuar disa kritere që duhet të plotësojë një vendim i ndërmjetëm në mënyrë që të konsiderohet përfundimtar, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës. Konkretisht, Gjykata ka përcaktuar se ai: i. duhet të ketë vendosur një kufizim mbi të drejtën e individit të pretenduar të cenuar, pra që shkelja e pretenduar të jetë pasojë e drejtpërdrejtë e vendimit të ndërmjetëm të kundërshtuar, që do të thotë se kërkuesi duhet të provojë se është viktimë e shkeljes të së drejtës kushtetuese; ii. duhet të jetë bërë objekt i ankimit të veçantë dhe të jetë shqyrtuar edhe nga gjykatat më të larta, të cilat të jenë shprehur, qoftë edhe tërthorazi, për të drejtën që pretendohet të jetë cenuar; iii. duhet të ketë një masë autonomie nga procesi i themelit, në kuptimin që pavarësisht se shqyrtimi gjyqësor i mosmarrëveshjes së themelit vazhdon, vendimi përfundimtar që do të jepet në themel nuk është i aftë të ndryshojë vendimin e ndërmjetëm, në kuptimin që të riparojë në masën e duhur efektet që ai ka sjellë. Kjo do të thotë se cenimi është në atë masë dhe formë që pasojat e ardhura është e vështirë ose e pamundur të riparohen gjatë procesit të themelit *(shih vendimet nr. 22, datë 4.4.2024; nr. 18, datë 19.3.2024; nr. 14, datë 11.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese).*

26. Në rastin në shqyrtim ankimi kushtetues individual i kërkuesit në pjesën që kundërshton kushtetutshmërinë e vendimeve gjyqësore është mbështetur në dy pretendime kryesore: *i pari,* për cenimin e lirisë personale dhe asaj të lëvizjes, për shkak se prokuroria dhe gjykatat kanë vepruar në kundërshtim me përcaktimet e nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, në kushtet kur kërkuesi është deputet i Kuvendit, për rrjedhojë çdo kufizim i këtyre lirive duhet të bëhet me autorizim të Kuvendit, por edhe cenimin e së drejtës për t'u zgjedhur si rezultat i vendosjes ndaj tij të masave të sigurimit në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit, të lidhur edhe me statusin e tij si deputet dhe drejtues i partisë më të madhe opozitare; *i dyti,* për cenimin e së drejtës për proces të rregullt në drejtim të parimit të paanshmërisë në gjykim, së drejtës për mbrojtje efektive, si edhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe së drejtës së aksesit.

27. Gjykata, duke pasur parasysh qasjen e saj në drejtim të rasteve përjashtimore për kontrollin e vendimeve që vendosin masa me karakter të ndërmjetëm, ka pohuar se ajo i trajton pretendimet e parashtruara në ankimin kushtetues në drejtim të të drejtave substanciale. Ndërsa pretendimet që

kanë të bëjnë me të drejtën për proces të rregullt trajtohen si aspekte procedurale të së drejtës substanciale të pretenduar të cenuar. Në këtë kuptim, Gjykata ndalet në aspekte të veçanta të së drejtës për proces të rregullt ligjor, për sa ato mund të ndikojnë drejtpërdrejt në të drejtën substanciale në vetvete *(shih vendimet nr. 29, datë 16.4.2024; nr. 18, datë 19.3.2024, të Gjykatës Kushtetuese)*.

28. Duke iu referuar pretendimeve të kërkuesit, si dhe duke pasur parasysh natyrën e të drejtave që vihen në diskutim *(shih paragrafin 21),* ashtu edhe pasojat që pretendohet se kanë ardhur mbi këto të drejta për shkak të caktimit të masave të sigurimit personal ndaj kërkuesit, Gjykata konsideron se përmbushet kriteri i parë i lartpërmendur, pasi shkelja e pretenduar është pasojë e drejtpërdrejtë e vendimit të ndërmjetëm të kundërshtuar. Vendimi që ka caktuar masat e sigurimit është kundërshtuar në të gjitha shkallët e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, prandaj edhe kriteri i dytë është përmbushur në rastin konkret. Gjithashtu, Gjykata konstaton se gjatë procesit gjyqësor të themelit të çështjes, i cili ka të bëjë me fajësinë e kërkuesit, do të ishte e pamundur që të rikuperohen këto të drejta kushtetuese të pretenduara të cenuara ose të korrigjohen pasojat e ardhura nga vendimet e ndërmjetme në to, për rrjedhojë plotësohet edhe kriteri i tretë. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk ka mjete të tjera juridike në dispozicion në lidhje me pretendimet që lidhen me vendimet gjyqësore objekt i ankimit kushtetues individual.

29. Gjithashtu, Gjykata konstaton se kërkuesi ka pretenduar se të drejtat dhe liritë e tij janë cenuar për fakte të cilat mbrohen nga imuniteti absolut i deputetit, i parashikuar nga neni 73, pika 1, i Kushtetutës. Për rrjedhojë, sipas tij, ai nuk mund të ndiqet penalisht për veprimet e kryera në ushtrim të kësaj detyre. Në lidhje me këtë pretendim të kërkuesit, Gjykata vëren se sipas pikës 1 të nenit 73 të Kushtetutës: *"deputeti nuk mban përgjegjësi për mendimet e shprehura në Kuvend dhe votat e dhëna prej tij në ushtrim të funksionit"*. Në këtë kuptim, Gjykata, *së pari,* vlerëson se kjo dispozitë nuk është e zbatueshme në rastin konkret, për sa kohë kërkuesi nuk rezulton të jetë ndjekur penalisht për mendimet ose votat e tij gjatë ushtrimit të funksionit të deputetit, por për veprime të kryera gjatë kohës që ai ushtronte detyrën e Kryeministrit, dhe, *së dyti,* ky pretendim i tij lidhet me çështjen e të provuarit nëse ai e ka kryer ose jo veprën penale për të cilën akuzohet, e cila i nënshtrohet procesit të themelit. Për këtë arsye, Gjykata vlerëson se në lidhje me këtë pretendim kërkuesi ka mjete të tjera juridike në dispozicion, duke qenë se argumenti lidhet me fajësinë që është objekt i gjykimit të themelit dhe nuk mund të merret në shqyrtim në këtë fazë. Për këtë arsye, Gjykata çmon se ky pretendim i kërkuesit nuk mund të merret në shqyrtim.

30. Për sa i përket kriterit pretendimeve për cenimin e parimeve të paanshmërisë dhe pavarësisë, të lidhur me përmbajtjen e dispozitave të ligjit nr. 95/2016, rezulton se kërkuesi nuk e ka ngritur këtë pretendim, në formë dhe përmbajtje, përpara gjykatave të zakonshme. Ai është paraqitur për herë të parë në ankimin kushtetues individual. Gjykata, duke pasur parasysh natyrën e kontrollit që ushtrohet nga gjykatat e zakonshme dhe kompetencat e këtyre të fundit, të cilat nuk mund të shprehen për antikushtetushmërinë e normave, si edhe qëndrimin e saj se paraqitja e kërkesës për inicimin e kontrollit incidental të normës nuk përbën element të domosdoshëm në këndvështrim të përmbushjes së kriterit të shterimit të mjeteve juridike efektive *(shih vendimin nr. 4, datë 21.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese)*, vlerëson se paraqitja e këtij pretendimi përpara gjykatave të zakonshme nuk rezulton se do të kishte perspektivë suksesi për kërkuesin. Për rrjedhojë, lidhur me këtë pretendim, kërkuesi nuk ka pasur mjete të tjera juridike efektive në dispozicion.

31. Nga ana tjetër, Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar se, në caktimin e masave të sigurimit ndaj tij, gjykatat i kanë cenuar të drejtat kushtetuese edhe në drejtimet e mëposhtme: i. sepse i kanë kufizuar të drejtat e tij kushtetuese (lirinë personale dhe të lëvizjes) për veprime që nuk parashikohen nga ligji si vepër penale, për sa kohë ai është akuzuar për miratimin e akteve normative me fuqi juridike në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jo për akte individuale të cilat kanë për qëllim favorizimin e një personi apo një grupi të përcaktuar personash; ii. sepse kanë cenuar parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, teksa kanë marrë kompetencat e Kuvendit, Gjykatës Kushtetuese dhe gjykatave të zakonshme për vlerësimin e politikave socio – ekonomike të qeverisë, nevojën dhe dobinë e akteve ligjore dhe nënligjore, ligjshmërinë e

vendimeve të AKKP-së dhe kontratave civile midis personave privatë. Për sa u përket këtyre pretendimeve, Gjykata vlerëson se ato, në thelb, kanë të bëjnë me çështjen e të provuarit të fajësisë së kërkuesit dhe, si të tilla, mund të parashtrohen përpara gjykatave penale gjatë gjykimit të themelit të çështjes penale, ku kërkuesi ka mundësinë që të paraqesë çdo pretendim dhe provë si në lidhje me akuzën ashtu edhe me juridiksionin e gjykatave. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se edhe në lidhje me këto pretendime kërkuesi ka mjete të tjera juridike në dispozicion, ndaj ato nuk mund të merren në shqyrtim.

32. Po kështu, duke pasur parasysh se në kuadër të verifikimeve për shterimin e mjeteve juridike nga kërkuesi Gjykata vlerëson shterimin e mjeteve të ankimit në aspektin formal dhe substancial, ajo vëren se në drejtim të së drejtës për proces të rregullt kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e parimeve të paanshmërisë dhe pavarësisë së gjyqtares së GJKKO-së së Shkallës së Parë që ka caktuar masat e sigurimit personal ndaj tij. Në drejtim të këtij pretendimi kërkuesi ka parashtruar dy shkaqe: a) gjyqtarja I.Gj. është shkarkuar nga detyra në vitin 1996 nga ish-KLD-ja, në kohën kur ky institucion kryesohej nga kërkuesi i cili e ushtronte këtë detyrë *ex officio* në cilësinë e Presidentit të Republikës; b) dispozitat e ligjit nr. 95/2016 parashikojnë vëzhgimin periodik nga BKH-ja të telekomunikimeve të gjyqtarëve të gjykatave të posaçme, përfshirë edhe ato të familjarëve të tyre. Sipas kërkuesit, duke pasur parasysh se BKH-ja varet nga Prokuroria e Posaçme, që është organi që ka kërkuar masat e sigurimit personal në rastin e kërkuesit dhe që i mbron ato përpara gjykatave, gjyqtarët e gjykatave të posaçme nuk mund të jenë të pavarur dhe të paanshëm.

33. Për sa i përket shkakut të parë, Gjykata vëren se gjatë gjykimit pranë GJKKO-së së Shkallës së parë kërkuesi ka ngritur pretendimin për anshmërinë e gjyqtares, duke argumentuar se ndaj saj është paraqitur një kallëzim penal prej tij dhe se vendimi i dhënë më parë prej saj, ku janë vendosur masat e sigurimit personal, është antikushtetues, fakte këto që ngrenë dyshimin se ajo gjyqtare është e njëanshme. Në vlerësimin e kësaj kërkese, një tjetër gjyqtare e GJKKO-së së Shkallës së Parë, me vendimin nr. 430, datë 26.10.2023, ka vendosur mospranimin e saj, si të pabazuar në ligj dhe në prova. Në këtë kuptim, nuk rezulton se shkaku i paraqitur nga kërkuesi në këtë ankim kushtetues, pra shkarkimi i gjyqtares nga ish-KLD-ja, të jetë ngritur përpara GJKKO-së së Shkallës së Parë. Duke mbajtur në konsideratë se kërkuesi pretendon se kjo është një rrethanë e rëndësishme e njëanshmërisë së gjyqtares, Gjykata vëren se është e paqartë/e pakuptueshme përse ai nuk e ka ngritur atë përpara gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe nuk u ka dhënë atyre mundësinë që të mbajnë një qëndrim të shprehur, duke ritheksuar se shterimi i mjeteve, në thelb, synon t'u japë organeve publike dhe në veçanti gjykatave të juridiksionit të zakonshëm mundësinë të parandalojnë ose korrigjojnë në substancë shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese të individit *(shih vendimet nr. 18, datë 19.3.2024; nr. 25, datë 13.10.2022, të Gjykatës Kushtetuese).*

34. Po ashtu, në raste të ngjashme, edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) ka vlerësuar se për sa kohë kërkuesi nuk ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e anëtarëve të trupit gjykues, sipas parashikimeve të dispozitave procedurale, pra nuk ka përdorur procedurën standarde për këtë qëllim, konsiderohet se ai nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion *(shih vendimin nr. 67, datë 3.10.2024, të Gjykatës Kushtetuese)*. Bazuar në këtë qasje, Gjykata vlerëson se në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të paanshmërisë për shkak të shkarkimit të gjyqtares nga ish-KLD-ja në vitin 1996, edhe pse ai është ngritur formalisht në rekurs, për sa kohë që kërkuesi nuk ka paraqitur përpara GJKKO-së së Shkallës së Parë kërkesë për përjashtimin e gjyqtares pikërisht për këtë shkak, edhe pse dispozitat procedurale, nenet 15 e vijuese të KPP-së, ia garantonin këtë të drejtë, dhe për sa kohë që ai nuk ka parashtruar ndonjë shkak për mospasjen dijeni të shkakut të përjashtimit apo për pamundësinë për të përdorur këtë mjet procedural, konsiderohet se kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës. Për rrjedhojë, ky pretendim, për këtë shkak, nuk mund të merret në shqyrtim.

35. Ndërkohë, për sa i përket shkakut tjetër të pretenduar të paanshmërisë dhe pavarësisë, që lidhet me antikushtetutshmërinë e pretenduar të dispozitave ligjore, Gjykata ka vlerësuar më sipër se do e trajtojë këtë aspekt si kërkim për kontrollin e kushtetutshmërisë së neneve 48–51 të ligjit

nr. 95/2016, pra nëse këto dispozita ofrojnë garanci për gjyqtarin në drejtim të pavarësisë dhe paanshmërisë së tij në proces.

36. Në drejtim të legjitimimit *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 5.3.2024, i cili u është komunikuar mbrojtësve të kërkuesit në adresat e tyre të postës elektronike me *e-mail*-in e datës 30.5.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 29.7.2024, pra brenda afatit 4-mujor. Duke llogaritur datën e komunikimit të vendimit të Gjykatës së Lartë si momentin nga i cili fillon afati 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues për të dyja kërkimet e kërkesës në shqyrtim, konsiderohet se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*.

37. Për sa i përket legjitimimit *ratione materiae,* në lidhje me pretendimet e tjera të kërkuesit, Gjykata konstaton se ai ka pretenduar cenimin e lirisë personale dhe të lirisë së lëvizjes, të mbrojtura nga nenet 27 dhe 38 të Kushtetutës, si rezultat i një procesi të parregullt ligjor, me argumentin se masat e sigurimit "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" dhe "Ndalimi i daljes jashtë shtetit" janë caktuar në kundërshtim me procedurën e nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, që parashikon se deputetit nuk mund *"... t'i hiqet liria në çfarëdo lloj forme"*. Po ashtu, sipas kërkuesit, atij i janë kufizuar disa të drejta dhe liri themelore, midis të cilave edhe e drejta për t'u zgjedhur, në kundërshtim me kriteret e nenit 17 të Kushtetutës.

38. Gjykata, fillimisht evidenton se masat e sigurimit të caktuara ndaj kërkuesit, kanë vendosur ndaj tij detyrimin për t'u paraqitur të hënën e parë dhe të tretë të çdo muaji, ora 10:00 përpara oficerit të Policisë Gjyqësore, pranë Prokurorisë së Posaçme dhe detyrimin për të mos u larguar nga territori i Republikës së Shqipërisë pa autorizimin e gjykatës, detyrime të cilat nuk kanë intensitet të tillë që të mund të barazohen me heqjen e lirisë. Në këtë këndvështrim, Gjykata duke mbajtur në konsideratë se neni 27, garanton lirinë personale, e cila është e ndryshme nga liria e lëvizjes, e garantuar nga neni 38 i Kushtetutës *(shih infra paragrafët 59–60 të këtij vendimi),* funksionin e deputetit që ushtron kërkuesi, si edhe thelbin e argumenteve të kërkuesit për kufizimin e të drejtave dhe lirive themelore, bazuar në parimin *iura novit curia,* vlerëson t'i shqyrtojë ato nën prizmin e të drejtave substanciale të mëposhtme: *i. e drejta për t'u zgjedhur* në drejtim të ushtrimit të mandatit përfaqësues të deputetit nga kërkuesi, e mbrojtur nga neni 45 i Kushtetutës, për shkak të caktimit të dy masave të sigurimit personal ndaj tij; *ii. liria e lëvizjes*, e mbrojtur nga neni 38 i Kushtetutës, për shkak të caktimit të masës së sigurimit "Ndalimi i daljes jashtë shtetit". Në këtë kuptim, Gjykata do të shqyrtojë, fillimisht, në drejtim të së drejtës kushtetuese për t'u zgjedhur dhe lirisë së lëvizjes[2], nëse ka pasur shkelje të nenit 73, pika 2, të Kushtetutës në lidhje me autorizimin e Kuvendit. Në vijim, në varësi të përfundimit të arritur në lidhje me këtë pretendim, Gjykata do të shqyrtojë, në të njëjtin këndvështrim, edhe aspektet e tjera të procesit gjyqësor që kanë të bëjnë me: *i.* cenimin e parimeve të paanshmërisë dhe pavarësisë të gjykatës si rezultat i rregullimeve ligjore, të cilat Gjykata do t'i shqyrtojë në drejtim të elementit objektiv të parimit të paanshmërisë *ii.* cenimin e së drejtës për mbrojtje efektive; *iii.* cenimin e standardit të arsyetimit si aspekte procedurale të të drejtave substanciale të sipërpërmendura; *iv.* aspektin substancial të kufizimit të këtyre të drejtave në drejtim të parimit të proporcionalitetit të masave të sigurimit të vendosura mbi kërkuesin.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për t'u zgjedhur dhe të lirisë së lëvizjes (aspekti procedural)

B.1.1. Për autorizimin nga Kuvendi sipas nenit 73, pika 2, të Kushtetutës

39. Sipas kërkuesit, Prokuroria e Posaçme ka vepruar në kundërshtim me nenin 73, pika 2, të Kushtetutës, duke mos ndjekur procedurën e parashikuar në këtë dispozitë, për shkak se duke qenë ai deputet i Kuvendit, çdo kufizim i lirisë personale dhe lirisë së lëvizjes duhej të bëhej me autorizim të këtij të fundit, çka nuk është bërë në rastin e tij. Sipas kërkuesit, dispozita kushtetuese nuk

[2] Gjyqtarët Holta Zaçaj, Sonila Bejtja dhe Genti Ibrahimi vlerësuan se pretendimi i kërkuesit duhej të shqyrtohej nga Gjykata edhe në drejtim të lirisë personale, të garantuar nga neni 27 i Kushtetutës.

nënkupton në asnjë rast caktimin ndaj deputetit vetëm të masave të sigurimit personal "Arresti në burg" ose "Arresti në shtëpi", por përfshin edhe masat e tjera të sigurimit personal që kufizojnë lirinë personale dhe atë të lëvizjes. Ai ka pretenduar se ndaj tij është zbatuar një standard i ndryshëm nga ai i mbajtur nga organet gjyqësore dhe Kuvendi në rastin deputetit S.T., për të cilin, për vendosjen e masave të sigurimit personal "Ndalimi i daljes jashtë shtetit" dhe "Detyrimi për t'u paraqitur në Policinë Gjyqësore", të parashikuara nga neni 232, pika 1, shkronjat "a" dhe "b", të KPP-së, në kohën kur kryente funksionin e deputetit dhe të ministrit, është kërkuar autorizimi nga Kuvendi, i cili, në cilësinë edhe të organit që ka miratuar KPP-në, është shprehur se këto janë masa shtrënguese të heqjes së lirisë. Sipas kërkuesit, ky është interpretimi institucional që u ka bërë këtyre dispozitave vetë Kuvendi, i cili duhej të merrej parasysh edhe nga gjykatat dhe jo të bënin ato një interpretim të ndryshëm, duke shmangur marrjen e autorizimit nga Kuvendi.

40. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se pretendimi për cenimin e *lirisë personale,* në kundërshtim me nenet 27 dhe 38 të Kushtetutës, është i pabazuar, pasi nga leximi i neneve 27 dhe 28 të Kushtetutës konstatohet se bëhet fjalë për burgosje të individit, ose heqje e lirisë në kuptimin e kapjes së tij. Sipas Prokurorisë së Posaçme, referuar nenit 73 të Kushtetutës, legjislatori nuk ka pasur si qëllim mbrojtjen e çdo lloj lirie, pasi kjo do të binte në kundërshtim me atributet e tjera, për të cilat prokurorisë i është lejuar të veprojë pa autorizim të Kuvendit dhe se autorizimi i Kuvendit kërkohet vetëm në rast se kërkohet arresti në burg ose arresti në shtëpi dhe jo për çdo lloj heqjeje lirie të mundshme që ka personi nën hetim. Gjithashtu, subjekti i interesuar ka parashtruar se termat "në çfarëdo lloj forme" nuk nënkuptojnë "çfarëdo lloj lirie" dhe se në rastin e ish-deputetit dhe ish-ministrit, shtetasit S.T., Prokuroria e Posaçme nuk ka kërkuar të njëjtat masa sigurimi si në rastin e kërkuesit, por ka kërkuar autorizimin për arrest. Sipas Prokurorisë së Posaçme, masa e sigurimit "ndalim i daljes jashtë shtetit" vendosur ndaj kërkuesit, sipas subjektit të interesuar, nuk e ka kufizuar atë në lirinë e lëvizjes së tij brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, pjesëmarrjes së tij në Kuvend ose komisione parlamentare, si edhe në kryerjen e të gjitha aktiviteteve të tij personale dhe ky ndalim nuk është vendosur në atë masë që të barazohet me heqjen e lirisë.

41. Gjykata vëren se neni 124 i Kushtetutës përcakton funksionin kryesor të kësaj Gjykate, që është garantimi i respektimit të Kushtetutës dhe interpretimi përfundimtar i saj, të cilin ajo e ushtron sa herë vihet në lëvizje për t'u shprehur për një nga çështjet e parashikuara në nenin 131 të Kushtetutës dhe në normat e tjera kushtetuese, sepse gjatë kontrollit kushtetues është i nevojshëm, në çdo rast, interpretimi i kuptimit të normave kushtetuese që lidhen me çështjen konkrete në shqyrtim *(shih vendimet nr. 7, datë 24.2.2016; nr. 24, datë 9.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese).* Nëpërmjet këtij interpretimi, Gjykata synon që t'u japë jetë normave kushtetuese përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre *(shih vendimet nr. 7, datë 24.2.2016; nr. 29, datë 30.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese).*

42. Gjykata vëren se, sipas nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, deputeti nuk mund të arrestohet ose t'i hiqet liria në çfarëdo lloj forme ose ndaj tij të ushtrohet kontroll personal, ose i banesës, pa autorizimin e Kuvendit. Në këtë kuptim, duke qenë se pretendimi i kërkuesi në thelb ka natyrë kushtetuese, Gjykata, bazuar edhe në parimin e subsidiaritetit, sipas të cilit kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë, e cila duhet të investohet në shqyrtimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur lidhur me to *(shih vendimet nr. 68, datë 8.10.2024; nr. 13, datë 9.3.2021; nr. 11, datë 16.4.2018, të Gjykatës Kushtetuese),* në vijim do të analizojë edhe arsyetimin e gjykatave të zakonshme për interpretimin e nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, si dhe të dispozitave procedurale penale në lidhje me këtë pretendim të kërkuesit.

43. Lidhur me pretendimin e kërkuesit se mungesën e autorizimit nga Kuvendi, sipas parashikimit të nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, për vendosjen ndaj tij të masave të sigurimit *(detyrim paraqitjeje dhe ndalim i daljes jashtë shtetit),* GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka arsyetuar se koncepti i lirisë së përmendur në nenin 73, pika 2, të Kushtetutës duhet krahasuar me atë të parashikuar në nenin 27 të saj dhe se bazuar në interpretimin sistematik, rezulton e qartë se autorizimi paraprak i

Kuvendit kërkohet vetëm për rastet e disponimit të lirisë personale të deputetit, por jo për liritë e tjera, ndërsa liria e personit nënkupton lirinë nga arrestimi dhe ndalimi, kurse siguria e personit nënkupton mbrojtjen kundër ndërhyrjes arbitrare ndaj lirisë së tij. GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se në analizë të nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, "liria" i referohet vetëm "lirisë personale" të personit nën hetim dhe jo lirisë së tij për të dalë lirisht jashtë shtetit, kurse shprehja "në çfarëdo lloj forme" nuk nënkupton çfarëdo lloj lirie, por format që mund të zbatohen për heqjen e saj, siç mund të jenë: paraburgimi i urdhëruar nga gjykata, ndalimi i urdhëruar nga prokurori ose Policia Gjyqësore, arrestimi në flagrancë. Sipas saj, ky interpretim është në përputhje me parashikimin e pikës 3 të kësaj dispozite kushtetuese, që lejon ndalimin ose arrestimin e deputetit pa autorizim të Kuvendit në rastin kur kapet në kryerje e sipër ose menjëherë pas kryerjes së një krimi të rëndë, sikundër edhe me parashikimet e nenit 289 të KPP-së, sipas të cilit, mosdhënia e autorizimit nga Kuvendi, sipas nenit 288 të këtij kodi, nuk pengon prokurorin të kërkojë një nga masat e tjera të sigurimit personal sipas nenit 244 të tij. Po sipas saj, edhe në jurisprudencën e GJEDNJ-së, "e drejta e lirisë", në kuptim të nenit 5 të KEDNJ-së, ka të bëjë me lirinë fizike të personit, qëllimi i së cilës është që askush të mos privohet nga kjo liri në mënyrë arbitrare, ndërkohë që objekti i mbrojtjes së këtij neni nuk ka të bëjë me kufizimet e "lirisë së lëvizjes", e cila rregullohet nga neni 2 i Protokollit nr. 4 të Konventës. Mbi këtë arsyetim, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se masat e sigurimit të caktuara prej saj nuk kanë cenuar lirinë personale të kërkuesit dhe në kuptim të dispozitës kushtetuese, si dhe dispozitave procedurale penale ato përbëjnë "masa të tjera", që nuk përbëjnë "heqje të lirisë personale", por kufizim të "lirisë për të lëvizur jashtë shtetit", masa për të cilat shprehimisht nuk kërkohet autorizimi paraprak i Kuvendit *(shih faqet 25–26 të vendimit nr. 117/2023, të GJKKO-së së Shkallës së Parë).*

44. Po kështu, edhe sipas GJKKO-së së Apelit, për caktimin e masave të sigurimit personal që nuk heqin lirinë personale ose fizike të deputetit, nuk kërkohet autorizim paraprak nga Kuvendi. Sipas saj, duke pasur parasysh formën e qeverisjes (republikë parlamentare), parimin e ndarjes dhe balancimin ndërmjet tre pushteteve dhe se Kuvendi përbëhet nga deputetë të cilët zgjidhen për një periudhë 4-vjeçare, me qëllim për të siguruar pavarësinë dhe integritetin e Kuvendit në tërësi dhe për ta mbrojtur atë nga çdo ndërhyrje arbitrare të pushteteve të tjera, Kushtetuta ka parashikuar garanci ose mbrojtje paraprake të deputetëve, e njohur si imunitet parlamentar, situatë juridike e privilegjuar dhe e garantuar për deputetët, duke pasur parasysh pozicionin dhe funksionin institucional të tyre. Pjesë e imunitetit parlamentar, vijon ajo, është edhe imuniteti procedural, të cilit i referohet mbrojtja e kërkuesit, imunitet për të cilin GJEDNJ-ja është shprehur se garancitë që ky imunitet ofron, në të dyja aspektet e tij (papërgjegjshmëri dhe paprekshmëri), shërbejnë për të njëjtën nevojë, pikërisht për të siguruar pavarësinë e parlamentit në kryerjen e misionit të tij, ku paprekshmëria e deputetit parandalon çdo lloj mundësie ndjekjesh penale të frymëzuara nga qëllimi për të dëmtuar veprimtarinë politike të tij, duke mbrojtur kështu në të njëjtën kohë opozitën nga trysnitë dhe abuzimet e shumicës. GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se me ndryshimet kushtetuese të vitit 2012, imuniteti procedural është kufizuar nisur nga rëndësia që paraqet për interesat e shoqërisë procedimi penal, ku pika 2 e nenit 73 të Kushtetutës, garanton imunitetin e kufizuar procedural penal të deputetëve, veçanërisht në lidhje me masat e sigurimit dhe të kontrollit, për rastet kur deputeti i nënshtrohet procedimit penal. Edhe sipas GJKKO-së së Apelit, në interpretim të nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, me termin "heqje të lirisë" nënkuptohet liria personale ose fizike e deputetit ose liria nga arrestimi arbitrar, e njohur si nga më të rëndësishmet në nenin 27 të Kushtetutës dhe nenin 5 të KEDNJ-së, nocioni i së cilës, sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, përmban njëherazi një aspekt objektiv, konkretisht mbylljen e një personi brenda një hapësire të kufizuar për një periudhë kohore të konsiderueshme dhe një aspekt subjektiv, domethënë që ky i fundit nuk ka dhënë në mënyrë të vlefshme pëlqimin për mbylljen e tij, duke mos pasur të bëjë me kufizime të thjeshta ndaj lirisë së lëvizjes, të cilat përcaktohen nga një dispozitë më vete, konkretisht neni 2 i Protokollit nr. 4 të Konventës, referuar të cilit kemi të bëjmë me një dallim shkalle ose shpeshtësie, por jo natyre ose thelbi. Ky interpretim i nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, edhe sipas GJKKO-së së Apelit, është në harmoni me parashikimet e nenit 288 të KPP-së, ndërsa plotësohet

edhe me parashikimin e nenit 289 të këtij kodi, nga deduktohet se për cilëndo masë tjetër sigurimi, që nuk çon në heqjen e lirisë personale (arrest në burg ose arrest në shtëpi), nuk është i nevojshëm dhënia e autorizimit nga Kuvendi. Po sipas saj, liria për të lëvizur jashtë shtetit, e njohur nga neni 38 i Kushtetutës, nuk barazohet me lirinë personale ose fizike, ndaj, në këtë kuptim, caktimi i një mase sigurimi personale ndaj kërkuesit edhe pse me fuqi shtrënguese, që nuk heq lirinë personale, por vetëm lirinë e lëvizjes ose e detyron të paraqitet në ditë të caktuara përpara Policisë Gjyqësore, nuk kërkon autorizim nga Kuvendi sipas nenit 73, pika 2, të Kushtetutës *(shih faqet 14–16 të vendimit të GJKKO-së së Apelit).*

45. Edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se caktimi i një mase sigurimi shtrënguese që nuk heq lirinë personale dhe fizike të deputetit, por vetëm lirinë e lëvizjes jashtë shtetit ose e detyron të paraqitet në Policinë Gjyqësore, nuk kërkon autorizim nga Kuvendi, pasi del jashtë mburojës garantuese të nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, nenit 5, pika 1, të KEDNJ-së dhe nenit 288, pika 1, të KPP-së. Sipas Kolegjit Penal, qëndrimi i prokurorit dhe, në vijim, edhe i gjykatave më të ulëta, është në përputhje dhe në koherencë të plotë me parashikimin dhe qëllimin e imunitetit parlamentar të pjesshëm të garantuar nga neni 73, pika 2, i Kushtetutës, sikundër edhe me përcaktimin pothuajse identik të nenit 288, paragrafi 1, të KPP-së (normë zbatuese e përcaktimit kushtetues), i cili identifikon dy nga format klasike të heqjes së lirisë, atyre përmes masave të sigurimit personal "Arresti në burg" dhe "Arresti në shtëpi", por pa përjashtuar forma të tjera të heqjes së lirisë. Detyrimi i organit procedues për të kërkuar autorizim nga Kuvendi kërkohet qartazi vetëm në kushtet e paraqitjes së një kërkese për caktimin e masave të sigurimit paragjykuese të lirisë së personit, në format e heqjes, eliminimit të saj, ndërsa nuk e pengon atë për të kërkuar në gjykatë caktimin e një mase sigurimit të ndryshme, më të butë se ato. Në lidhje me kuptimin e termit "heqje e lirisë në çfarëdo lloj forme" në nenin 73, pika 2, të Kushtetutës, sipas Kolegjit Penal, neni 27 i saj, pasi shpall paprekshmërinë e lirisë së personit, si e drejtë themelore, në pikën 2 rendit dhe specifikon rastet përjashtimore të heqjes së saj, duke sqaruar në mënyrë ezauruese dhe pa asnjë ekuivok përmbajtjen e këtij termi në lidhje me format e përkohshme të heqjes së kësaj lirie, të cilat pa asnjë dyshim kërkojnë në thelb eliminimin integral të saj në kuptimin e izolimit të personit. Mbi këtë bazë, Kolegji Penal ka vlerësuar se masat e caktuara ndaj deputetit të hetuar në rastin konkret, me të drejtë, janë vlerësuar se nuk kufizojnë ushtrimin lirisht të mandatit të tij si deputet dhe se liria ose e drejta për të lëvizur jashtë vendit nuk mund të barazohet me lirinë fizike ose personale, ndërsa termi "heqja e lirisë në çfarëdo lloj forme" nuk nënkupton liri të ndryshme nga liria personale, por format që mund të zbatohen për heqjen e saj, të përcaktuara në nenin 27 të Kushtetutës, përfshirë këtu edhe ato në dispozicion të organit procedues të aplikuara në kushte urgjence dhe provizorisht, të identifikuara si masat parasiguruese të "ndalimit" dhe të "arrestimit në flagrance", të parashikuara nga nenet 253 dhe 251 të KPP-së *(shih paragrafët 41–45 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë).*

46. Për të arritur në një përfundim lidhur me pretendimin se mosmarrja e autorizimit nga Kuvendi sipas parashikimit të nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, për vendosjen e masave të sigurimit *(detyrim paraqitje dhe ndalim i daljes jashtë shtetit),* përbën ose jo cenim të së drejtës së kërkuesit për t'u zgjedhur dhe lirisë së tij të lëvizjes, Gjykata do të vlerësojë për sa më poshtë: i. nëse ky rregullim kushtetues shtrihet vetëm mbi *lirinë personale* ose edhe mbi *lirinë e lëvizjes* apo *liri të tjera* të garantuara nga Kushtetuta; ii. më tej, në varësi të rezultatit të analizës për pyetjen e parë, Gjykata do të vlerësojë nëse masa "Detyrimi për t'u paraqitur në Policinë Gjyqësore" përbën ose jo cenim të së drejtës për t'u zgjedhur dhe lirisë së lëvizjes. Për kryerjen e kësaj analize që synon të shpjegojë kuptimin e normës kushtetuese, Gjykata, bazuar edhe në nenin 124 të Kushtetutës, sipas të cilit ajo bën interpretimin përfundimtar të saj, do të ndalet edhe në identifikimin e qëllimit të kushtetutëbërësit për fushën e veprimit dhe të mbrojtjes që ofron neni 73, pika 2, i Kushtetutës, duke iu referuar në këtë drejtim: *travaux preparatoires* të procesit kushtetues të vitit 2012 që ka çuar në miratimin e përmbajtjes së kësaj dispozite; analizës semantike të dispozitës kushtetuese në fjalë; dhe precedentit të zbatimit të kësaj dispozite në rastin e deputetit S.T., të referuar nga kërkuesi, si dhe doktrinës .

47. *Për sa i takon qëllimit të kushtetutëbërësit,* Gjykata, fillimisht, vëren se rregullimi i nenit 73 të Kushtetutës, së bashku me rregullimin e neneve 126 dhe 137 të saj, përbën të ashtuquajturin *regjim*

të imuniteteve të njohur nga Kushtetuta për disa funksionarë të lartë publikë. *Regjimi i imuniteteve*, në çdo rast, synon, *nga njëra anë*, të garantojë ushtrimin e qetë dhe të pandikuar të funksioneve të rëndësishme publike nga zyrtarët e lartë të shtetit, të cilët nuk duhet të druhen se veprimtaria e tyre shtetërore mund të bëhet shkas për pasoja personale, si, për shembull, një padi civile ose një akuzë penale. *Nga ana tjetër*, dispozitat që përbëjnë *regjimin e imuniteteve* synojnë të garantojnë përgjegjshmërinë e këtyre funksionarëve të lartë në qoftë se, në përfundim të verifikimeve përkatëse dhe një procesi të rregullt ligjor, rezulton se veprimet e tyre nuk janë të motivuara nga interesi publik, por nga interesi privat ose keqbesimi. Në doktrinën juridike koncepti i imunitetit përfshin 2 (dy) aspekte[3]: i. *Mospërgjegjësinë* – një formë e mbrojtjes nga përgjegjësia që lind tipikisht si rezultat i ushtrimit të funksioneve publike, si, për shembull, një fjalim ose prononcim zyrtar, opinione teknike ose politike të shprehura ose vota të hedhura në ushtrim e sipër të detyrës; ii. *Paprekshmërinë* – një formë e mbrojtjes së përkohshme e të posaçme nga procedurat e ndryshme ligjore (p.sh., aspekte të caktuara të procedimit penal, paditë civile, procedimet disiplinore etj.) për aktet e zyrtarëve publikë që kryhen jashtë ushtrimit të funksioneve të tyre publike (p.sh. kryerja e një krimi, shkelja e një kontrate etj.). Kjo mbrojtje e përkohshme dhe e posaçme, tipikisht, konsiston në detyrimin e organeve ligjzbatuese për të marrë paraprakisht autorizimin e organit përkatës për kryerjen e disa veprimeve procedurale kundër funksionarëve publikë të veshur me imunitet.

48. Duke iu kthyer përmbajtjes së nenit 73 të Kushtetutës, Gjykata vëren se ai i garanton deputetit imunitet në të dyja format e lartpërmendura, ku paragrafi i parë ofron mbrojtje në formën e *mospërgjegjësisë*, ndërsa paragrafi i dytë ofron mbrojtje në formën e *paprekshmërisë*. Gjykata vëren, gjithashtu, se neni 73 i Kushtetutës në përmbajtjen e tij fillestare të miratuar në vitin 1998 parashikonte se: "*Deputeti nuk mund të ndiqet penalisht pa autorizimin e Kuvendit. Autorizimi kërkohet edhe në rastin kur ai do të arrestohet.*". Në vitin 2012 kjo dispozitë kushtetuese u ndryshua sipas përmbajtjes aktuale të saj dhe konkretisht pika 2 e saj parashikon: "*Deputeti nuk mund të arrestohet ose t'i hiqet liria në çfarëdo lloj forme apo ndaj tij të ushtrohet kontroll personal ose i banesës, pa autorizimin e Kuvendit.*". Referuar diskutimeve në Këshillin për Legjislacionin dhe Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, është e qartë se diskutimet e ligjvënësve janë përqendruar rreth pengesave që vendosen mbi veprimtarinë parlamentare të deputetit si rezultat i zbatimit ndaj tij të masave të sigurimit personal që kufizojnë lirinë. Nga ana tjetër, nga *travaux preparatoires* nuk rezulton e qartë nëse qëllimi i kushtetutëbërësit ka qenë shtrirja e mbrojtjes së posaçme që ofron pika 2 e nenit 73 edhe mbi masa të tjera të sigurimit përtej asaj të arrestit (në burg ose në shtëpi).

49. Megjithatë, duke pasur parasysh se qëllimi i kushtetutëbërësit në marrjen e nismës për miratimin e reformës kushtetuese të vitit 2012, që lidhet me regjimin e imuniteteve, ishte kufizimi i paprekshmërisë së deputetit nga ndjekja penale, i cili sipas Kushtetutës së vitit 1998 ishte i plotë (deri në marrjen e një autorizimi nga Kuvendi), Gjykata evidenton qëndrimin e mbajtur nga Komisioni Venecias, sipas të cilit, rregullat për paprekshmërinë e deputetëve në çështjet penale nuk duhet të shkojnë përtej asaj që është e justifikuar për qëllime të ligjshme dhe rrjedhimisht ato duhet të interpretohen të mënyrë të kufizuar. Sipas Komisionit të Venecias, rregullat për paprekshmërinë e deputetëve mund të justifikohen në rast se mjetet e tjera të mbrojtjes nuk janë të përshtatshme, por ato duhet gjithnjë të interpretohen në mënyrë të kufizuar[4]. Po kështu, edhe sipas GJEDNJ-së, mungesa e ndonjë lidhjeje të qartë me një aktivitet parlamentar kërkon një interpretim të ngushtë të konceptit të proporcionalitetit midis qëllimit që kërkohet të arrihet dhe mjeteve të përdorura *(shih Cordova kundër Italisë (nr. 1), datë 30 janar 2003, § 63)*. Në këtë kuptim, Gjykata thekson se imuniteti i deputetit nuk përbën përjashtim nga rregulli, sipas të cilit çdo person që kryen një vepër penale është subjekt i përgjegjësisë penale, e cila ndiqet nga prokurorët dhe në fund vendoset nga gjykatat e pavarura. Për këtë arsye, kur interpretohen rregullat për imunitetin, duhet të përjashtohet metoda e interpretimit të zgjeruar, ndaj Gjykata vlerëson se edhe fusha e rregullimit

---

[3] Ky kuptim i imunitetit është zhvilluar origjinalisht nga komiteti GRECO *(Group of States Against Corruption)* i Këshillit të Evropës dhe referohet gjerësisht në doktrinën juridike.

[4] Raporti i Komisionit të Venecias CDL-AD (2014) 011 (14 maj 2014), paragrafët 157 dhe 185.

të pikës 2 të nenit 73, që lidhet me imunitetin procedural të deputetëve, duhet interpretuar në mënyrë të kufizuar/ngushtë.

50. Kështu, në vlerësimin e Gjykatës, mbrojtja që ofrohet nga kjo dispozitë (neni 73, pika 2, i Kushtetutës) kuptohet e lidhur, si rregull, me procesin penal në kuadër të të cilit individit mund t'i kufizohet liria edhe përpara marrjes së një vendimi përfundimtar nga gjykata në lidhje me themelin e çështjes penale dhe fajësinë e tij. Duke parashikuar marrjen e autorizimit nga Kuvendi për zbatimin e masave që kufizojnë paraprakisht lirinë e deputetit, pika 2 e nenit 73 synon të mbrojë veprimtarinë e vetë Kuvendit *(jo të deputetëve të veçantë)* për aq sa ajo mund të cenohet si rezultat i procedimeve penale me sfond politik ndaj deputetëve të veçantë. Megjithatë, Gjykata pajtohet në këtë drejtim edhe me qëndrimin e Komisionit të Venecias, sipas të cilit imuniteti i deputetëve nuk është privilegj personal i tyre, por qëllimi kryesor i tij (imunitetit parlamentar) është mbrojtja e vetë parlamentit dhe në veçanti funksionimi i duhur i tij[5]. Në këtë kuptim, Gjykata pajtohet edhe me qëndrimin tjetër të Komisionit të Venecias, sipas të cilit duhet të ekzistojë një prezumim themelor që imuniteti duhet të hiqet në të gjitha rastet kur nuk ka asnjë arsye për të dyshuar se akuzat ndaj deputetit përkatës janë të motivuara politikisht dhe se paprekshmëria e tij duhet të zbatohet vetëm në rastet kur ka arsye për të dyshuar se në vendimin për ndjekjen penalisht të deputetit ka element partiakopolitik[6]. Për këto arsye, në referencë të qëllimit të kushtetutëbërësit, Gjykata vlerëson se neni 73, pika 2, i Kushtetutës i garanton deputetit mbrojtje të posaçme nga ato veprime procedurale të ndërmarra nga organet ligjzbatuese në kuadër të procedimit penal, të cilat kufizojnë lirinë e tij personale.

51. *Për sa i takon analizës semantike*, Gjykata vlerëson të ndalet në analizën e togfjalëshit "*ose t'i hiqet liria në çfarëdo lloj forme*" në përmbajtjen e pikës 2 të nenit 73, për të kuptuar nëse ky togfjalësh i referohet vetëm lirisë personale, të mbrojtur nga neni 27 i Kushtetutës ose edhe lirive të tjera kushtetuese, përfshirë atë të lëvizjes, të mbrojtur nga neni 38 i Kushtetutës. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se katalogu i lirive dhe të drejtave kushtetuese përfshin disa liri (nenet 21–58 të Kushtetutës), ndër të cilat me interes, në rastin në shqyrtim, janë liria personale e garantuar nga neni 27 Kushtetutës dhe liria e lëvizjes e garantuar nga neni 38 i saj, të cilat janë të ndryshme në thelbin e tyre. Sipas nenit 27, pikat 1 dhe 3, të Kushtetutës, askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj dhe askujt nuk mund t`i hiqet liria vetëm për shkak se nuk është në gjendje të përmbushë një detyrim kontraktor. Ndërkohë që në pikën 2 të kësaj dispozite janë parashikuar edhe rastet e kufizimit të lirisë, kurse në nenin 28 të Kushtetutës janë parashikuar të drejtat që i garantohen menjëherë personit të cilit i hiqet liria. Gjykata, referuar përmbajtjes së nenit 27 të Kushtetutës, vëren se ai përdor alternativisht konceptet "*heqje lirie*" dhe "*kufizim lirie*" pa bërë ndonjë dallim të dukshëm midis tyre.

52. Për sa më lart, për qëllim të kësaj analize, Gjykata çmon t'i referohet edhe jurisprudencës së GJEDNJ-së, e cila ka bërë dallimin midis "heqjes" së lirisë dhe "kufizimit" të saj. Kështu, sipas GJEDNJ-së, dallimi midis "heqjes" dhe "kufizimit" të lirisë, sipas nenit 5, pika 1, dhe kufizimit të lirisë së lëvizjes, sipas qëllimit të nenit 2 të Protokollit nr. 4, përcaktohet nga shkalla ose intensiteti dhe jo nga natyra ose substanca *(shih Guzzardi kundër Italisë, 6 nëntor 1980, §§ 92-93; Nada kundër Zvicrës [DHM], nr. 10593/08, § 225, GJEDNJ 2012; Austin dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar [DHM], nr. 39692/09, 40713/09 dhe 41008/09, § 57, GJEDNJ 2012; Stanev kundër Bulgarisë [DHM], nr. 36760/06, § 115; dhe Medvedyev dhe të tjerët kundër Francës [DHM], nr. 3394/03, GJEDNJ 2010)*. Në këtë kuptim, sipas GJEDNJ-së, në rastet kur ngrihen pretendime për të dyja dispozitat e mësipërme, gjykata duhet të përcaktojë se cila është e zbatueshme. Nëse ankimi që lidhet me një kufizim të caktuar rezulton se bie në fushën e nenit 5, gjykata nuk e shqyrton atë sipas nenit 2 të Protokollit nr. 4 *(shih Assanidze kundër Gjeorgjisë [DHM], 2004, § 194)*. Kur neni 5 rezulton të jetë i pazbatueshëm, ankimi shqyrtohet sipas nenit 2 të Protokollit nr. 4 *(shih De Tommaso kundër Italisë [GC], 2017, § 91; M.S. kundër Belgjikës, 2012, § 195),* përveç rastit kur kërkuesi kërkon në mënyrë

[5] Raporti I Komisionit të Venecias CDL-AD (2006) 005 (20 mars 2006), paragrafi 10.
[6] Raporti i Komisionit të Venecias CDL-AD (2014) 011 (14 maj 2014), paragrafi 162.

specifike të provojë se një masë e caktuar përbën një heqje lirie dhe jo thjesht një kufizim të lirisë së lëvizjes *(shih Terheş kundër Rumanisë, nr. 49933/20, 2021, § 38).*

53. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson të ndalet në përdorimin e lidhëzave "*osë*" dhe "*apo*" në formulimin e pikës 2 të nenit 73 të Kushtetutës për të kuptuar nëse togfjalëshi "*ose t'i hiqet liria në çfarëdo lloj forme*", i cili pason togfjalëshin "*Deputeti nuk mund të arrestohet*" i referohet ndonjë lirie tjetër, të ndryshme nga liria personale, e cila qartësisht hiqet/kufizohet për shkak të zbatimit të masës së sigurimit personal të arrestit të personit. Gjykata vëren të theksojë se pjesa e dytë e fjalisë së pikës 2 të nenit 73 "*ndaj tij të ushtrohet kontroll personal* ***ose*** *i banesës"*, e cila ndahet në dy nënpjesë, i referohet qartësisht të drejtave të mbrojtura nga neni 37 i Kushtetutës, që janë paprekshmëria e banesës dhe e personit. Ndërkohë Gjykata vëren se, në të njëjtën mënyrë, edhe pjesa e parë e fjalisë së pikës 2 të nenit 73 ndahet në dy nënpjesë nga lidhëza ***"ose"*** *("nuk mund të arrestohet"* ***ose*** *"t'i hiqet liria në çfarëdo lloj forme").* Nga ana tjetër, të dyja pjesët e fjalisë të pikës 2 të nenit 73, të cilat ndahen në vetvete në nënpjesë nga lidhëza ***"ose"****,* ndahen midis tyre nga lidhëza ***"apo"****.* Në kuptimin gjuhësor lidhëzat ***"ose"*** dhe ***"apo"*** nuk kërkojnë praninë e njëkohshme të të dyja elementeve, në dallim nga rastet e tjera kur në dispozitën ligjore përdoret lidhëza ***"dhe"****.* Ndonëse të dyja këto lidhëza përdoren për të shprehur alternativa, në formulimin e dispozitës kushtetuese këto lidhëza kanë dallime semantike dhe përdorimi të tyre duhet të kuptohet në varësi të kontekstit.

54. Gjykata vlerëson se përdorimi i lidhëzës ***"apo"*** në pikën 2 të nenit 73 për të ndarë dy pjesët përbërëse të fjalisë ka pasur qëllim që të theksojë ndarjen ndërmjet rasteve në të cilat e shtrin mbrojtjen e saj dispozita kushtetuese. Ndërsa pjesa e parë e fjalisë i ofron deputetit mbrojtje të përkohshme procedurale nga masat e sigurimit të cilat kufizojnë lirinë personale të garantuar nga neni 27 i Kushtetutës, derisa Kuvendi të autorizojë vendosjen e këtyre masave, pjesa e dytë e fjalisë i ofron deputetit mbrojtje të përkohshme procedurale nga masat e kontrollit personal dhe të banesës, të cilat kufizojnë të drejtat e mbrojtura nga neni 37 i Kushtetutës, derisa Kuvendi të autorizojë vendosjen e këtyre masave. Në këtë kuptim, në vlerësimin e Gjykatës, edhe analiza semantike e dispozitës konfirmon rezultatin e analizës qëllimore se neni 73, pika 2, i Kushtetutës i garanton deputetit mbrojtje të posaçme nga ato veprime procedurale të ndërmarra nga organet ligjzbatuese në kuadër të procedimit penal të cilat kufizojnë lirinë e tij personale. Ky interpretim është në përputhje edhe me parashikimin e pikës 3 të nenit 73, të Kushtetutës, që lejon ndalimin ose arrestimin e deputetit pa autorizim të Kuvendit në rastin kur kapet në kryerje e sipër ose menjëherë pas kryerjes së një krimi të rëndë. Për më tepër, duke mbajtur në konsideratë kohën e hartimit të kushtetutës dhe legjislacionin penal të mëparshëm, Gjykata vëren se koncepti i heqjes se lirisë në atë legjislacion i referohej izolimit në burg të individit.

55. *Për sa i takon analizës se precedentit,* në rastin e deputetit të shumicës parlamentare S.T., Gjykata vëren se Kuvendi, i vënë në lëvizje me kërkesën e prokurorisë për dhënien e autorizimit për arrestimin ose heqjen e lirisë, si dhe kontrollit personal dhe të banesës së atij deputeti, me vendimin nr. 104/2017, datë 25.10.2017, ka vendosur pranimin e kërkesës për: dhënien e autorizimit për kontrollin personal dhe të banesës; dhënien e autorizimit për ndalimin e daljes jashtë shtetit, detyrimin për t'u paraqitur në Policinë Gjyqësore, ndalimin dhe detyrimin për të qëndruar në një vend të caktuar si masë shtrënguese të heqjes së lirisë, në kuptim të shkronjave "a", "b" dhe "c" të nenit 232 të KPP-së; rrëzimin e kërkesës për dhënien e autorizimit për masën e arrestit në burg ose në shtëpi për deputetin, në kuptim të shkronjave "d" dhe "dh" të nenit 232 të po këtij kodi.

56. Thënë këtë, Gjykata konstaton se në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se Kuvendi shfaqet edhe si interpretuesi i parë i normës kushtetuese dhe hapësira e këtij interpretimi varet nga karakteri dhe natyra e dispozitave kushtetuese *(shih vendimet nr. 16, datë 27.6.2022; nr. 9, datë 1.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese).* Megjithatë, duke iu referuar vetëm asaj çka ka disponuar në rastin konkret Kuvendi, Gjykata vëren se ndonëse i ka dhënë përgjigje kërkesës së prokurorisë për zhveshjen e deputetit nga imuniteti parlamentar, ka autorizuar, midis të tjerash, edhe vendosjen e masës "Detyrimi për t`u paraqitur në policinë gjyqësore" dhe "Ndalimi i daljes jashtë shtetit", duke dhënë në pamje të parë idenë se ky lloj autorizimi ishte i nevojshëm edhe për zbatimin e këtyre masave.

Në fakt, duke iu referuar specifikave të atij rasti konkret, Gjykata vëren se nuk ndodhet përpara rrethanave të njëjta që kanë çuar në vënien në lëvizje të Kuvendit, për sa kohë që kërkesa e prokurorisë e paraqitur për deputetin S.T. në fakt kishte për objekt vetëm autorizimin e arrestimit të tij, çka në kuptim të dispozitës kushtetuese nuk linte vend për interpretim në drejtim të detyrimit të prokurorisë për marrjen e autorizimit për atë qëllim. Nga ana tjetër, referuar edhe përmbajtjes së vendimit të Kuvendit të dhënë në atë rast, gjuha e përdorur rezulton e përgjithshme, për rrjedhojë nuk mund të konsiderohet se ajo ka bërë apo se lejon ndonjë interpretim për shtrirjen e regjimit të autorizimeve edhe për masat e tjera siç janë "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" dhe "Ndalimi i daljes jashtë shtetit".

57. Në këtë kuptim, Gjykata thekson se ky rast i vetëm, i cili për më tepër ka rrethana të ndryshme, nuk mund të përbëjë shkak për të krijuar pritshmëri të ligjshme për kërkuesin dhe as detyrim për gjykatat, në kuptimin e praktikës së konsoliduar të Kuvendit ose barazisë përpara ligjit. Në vlerësimin e Gjykatës, edhe pse çështja në dukje ka problematikë për shkak se rasti i parë i referohej një deputeti të shumicës parlamentare, ndërsa në rastin konkret atij të pakicës, kjo nuk do të thotë që një praktikë pune e Kuvendit, e paqartë në zbatimin e Kushtetutës, të përligjet vetëm për këtë shkak, sepse në këtë mënyrë krijohen norma të reja kushtetuese. Për këto arsye, Gjykata çmon se edhe analiza e precedentit konfirmon rezultatin e analizës qëllimore dhe semantike se neni 73, pika 2, i Kushtetutës i garanton deputetit mbrojtje të posaçme nga ato veprime procedurale të ndërmarra nga organet ligjzbatuese në kuadër të procedimit penal të cilat kufizojnë lirinë e tij personale.

58. Gjithashtu, Gjykata vëren se argumenti i kërkuesit, sipas të cilit, Kuvendi duhet të japë autorizimin në rastin e caktimit të masave të detyrimit për paraqitje në Policinë Gjyqësore dhe të ndalimit të daljes jashtë shtetit, nuk pajtohet me parashikimin e nenit 73 të Kushtetutës. Një argument i tillë, nëse pranohet, tejkalon qëllimin e normës kushtetuese për imunitetin procedural (paprekshmërinë) e deputetit, të detajuar në nenet 288–289 të KPP-së, sipas të cilave, mosdhënia e autorizimit nuk e pengon prokurorin që të kërkojë një masë tjetër sigurimi. Një argument i tillë, nëse pranohet, jep rezultatin se ndaj një deputeti, përgjatë procedimit penal, nuk mund të caktohet asnjë masë sigurimi personal pa autorizim të Kuvendit. Në këtë drejtim, Gjykata evidenton se KPP-ja parashikon dy kategori të masave të sigurimit personal, ato shtrënguese dhe ato ndaluese (neni 227). Në kategorinë e masave shtrënguese, KPP-ja ka listuar sipas rëndesës, ndalimin e daljes jashtë shtetit, detyrimi për t'u paraqitur në Policinë Gjyqësore, ndalimi dhe detyrimi për qëndrimin në një vend të caktuar, garancia pasurore, arresti në shtëpi, arresti në burg dhe shtrimi i përkohshëm në një spital psikiatrik (neni 232), ku është e qartë se ndaj kërkuesit janë caktuar dy masat më të lehta. Ndërsa në kategorinë e masave ndaluese, kodi ka parashikuar dy masa, që janë pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik dhe ndalimi i përkohshëm i ushtrimit të veprimtarive të caktuara profesionale ose afariste (neni 240). Mirëpo të dyja këto masa ndaluese nuk mund të caktohen ndaj deputetit, sepse neni 242, pika 2, i KPP-së parashikon shprehimisht se pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik nuk zbatohet ndaj personave të zgjedhur sipas ligjit elektoral, ndërsa neni 243 tregon se ndalimi i ushtrimit të veprimtarive profesionale ka të bëjë me persona që ushtrojnë profesionin pranë personave juridikë privatë.

59. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se togfjalëshi *"ose t'i hiqet liria në çfarëdo lloj forme"* i referohet vetëm *lirisë personale*, të mbrojtur nga neni 27 i Kushtetutës dhe ai gjen zbatim vetëm në ato raste kur ndaj deputetit vendoset një masë kufizuese, që i heq lirinë personale. Për pasojë, autorizimi i Kuvendit është i nevojshëm vetëm nëse masat kufizuese të vendosura ndaj kërkuesit përbëjnë kufizim/heqje të lirisë së tij personale, i cili është i tillë që sjell pasoja në vetë të drejtën e deputetit për t'u zgjedhur, në aspektin e ushtrimit të të drejtave të tij si deputet, pra të vetë veprimtarisë parlamentare. Gjykata vlerëson se masa e sigurimit "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore", në këndvështrim të së drejtës për t'u zgjedhur, sipas nenit 45 të Kushtetutës, duke iu referuar llojit të detyrimit dhe shpeshtësisë së zbatimit të saj (në rastin konkret një herë në dy javë), nuk prek funksionet legjislative të Kuvendit dhe nuk e pengon kërkuesin të ushtrojë të drejtat e tij si deputet. Mbi të njëjtin argument, Gjykata vlerëson se edhe masa e sigurimit e ndalimit

për të dalë jashtë shtetit nuk e pengon kërkuesin të zhvilloje jetën e tij parlamentare. Për rrjedhojë, për sa kohë që kjo masë nuk përbën kufizim të lirisë personale pika 2 e nenit 73 të Kushtetutës nuk kërkon autorizimin e Kuvendit për zbatimin e saj ndaj deputetit. Në këtë këndvështrim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit në drejtim të mënyrës së zbatimit të nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, është i pabazuar.

B.1.2. Për cenimin e parimit të paanshmërisë për shkak të dispozitave ligjore

60. Referuar pretendimeve të kërkuesit për cenimin e parimeve të paanshmërisë dhe pavarësisë të gjykatës si rezultat i dispozitave të ligjit nr. 95/2016 për kontrollin periodik të telekomunikimeve, Gjykata, në vijim do t'i shqyrtojë ato në drejtim të testit objektiv të parimit të paanshmërisë së gjyqtarit. Sipas kërkuesit, atij i është cenuar e drejta për t'u dëgjuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, pasi referuar dispozitave të ligjit nr. 95/2016, gjyqtarët e gjykatave të posaçme nuk ofrojnë garancitë e nevojshme të pavarësisë për arsyet e mëposhtme: i. të gjitha komunikimet elektronike të këtyre gjyqtarëve dhe të familjarëve të tyre të afërt janë të vëzhguara nga Prokuroria e Posaçme. Ky vëzhgim është i pakufizuar në kohë dhe hapësirë, bëhet pa asnjë arsye specifike, si edhe nuk monitorohet *a priori* ose kontrollohet *a posteriori* nga ndonjë gjykatë në lidhje me proporcionalitetin e kësaj ndërhyrjeje; ii. oficeri përgjegjës për vëzhgimin është pjesë e strukturës së BKH-së, e cila varet nga Prokuroria e Posaçme, që është organi që ka kërkuar masat e sigurimit personal në rastin e tij dhe i mbron ato përpara gjykatave të posaçme; iii. referuar nenit 53, Prokuroria e Posaçme ka të drejtë të hetojë çdo gjyqtar të gjykatave të posaçme edhe për veprat penale të cilat nuk janë brenda kompetencës së saj lëndore. Për sa më sipër, në vlerësimin e kërkuesit, ky ligj cenon procesin e rregullt të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës.

61. Subjekti i interesuar ka parashtruar se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimeve të paanshmërisë dhe pavarësisë është i pabazuar, pasi: i. ligji nr. 95/2016 ka vendosur garanci të rëndësishme gjatë procesit të monitorimit, ku oficerit përgjegjës nuk i lejohet të dëgjojë telefonatat që cenojnë të drejtën për jetë private të personave që nuk kanë dhënë miratim paraprak për vëzhgim; ii. Prokuroria e Posaçme e ushtron ndjekjen penale vetëm përpara gjykatave të posaçme dhe janë këto të fundit, të cilat, në mënyrë të pavarur, kontrollojnë veprimet e saj procedurale, duke filluar që në fazat e hetimit paraprak dhe dhënien e miratimit të mjeteve hetimore të mbledhjes së provave. Po kështu, Prokuroria e Posaçme ka prapësuar se ligji nr. 95/2016 e ka kaluar vlerësimin e përputhshmërisë me Kushtetutën që i është bërë në konsultimin e draftit final nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar në Sistemin e Drejtësisë në datën 3.10.2016. Sipas Prokurorisë së Posaçme, në thelb, argumentet e kërkuesit në këtë drejtim kanë të bëjnë me shfuqizimin e dispozitave ligjore, ndërkohë që Gjykata kur vihet në lëvizje për shqyrtimin e një ligji që rishikon Kushtetutën, nuk shqyrton përmbajtjen ose përputhshmërinë e amendamenteve kushtetuese me Kushtetutën e mëparshme, por vetëm procedurën me të cilën janë miratuar këto ndryshime. Për rrjedhojë, sipas Prokurorisë së Posaçme, edhe kushtetutshmëria e dispozitave të ligjit nr. 95/2016 nuk mund të shqyrtohet nga Gjykata.

62. E drejta për një proces të drejtë, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, kërkon që një çështje duhet të shqyrtohet nga një "gjykatë e pavarur dhe e paanshme". Pavarësia e gjyqtarëve dhe e gjykatave është një element thelbësor i shtetit të së drejtës. Parimi i pavarësisë, i deklaruar në disa dispozita të Kushtetutës, kërkon, në radhë të parë, që gjyqtarët dhe gjykatat ndërsa japin drejtësi, t'u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve *(shih vendimet nr. 1, datë 26.1.2021; nr. 5, datë 16.2.2012, të Gjykatës Kushtetuese)*.

63. Po kështu, Gjykata ka pranuar se vlerësimi i sistemit të garancive dhe pavarësia e gjyqtarëve dhe gjykatave janë ngushtësisht të ndërlidhura ndërmjet tyre. Kjo pavarësi, e parë në kontekstin e parimit kushtetues të shtetit të së drejtës, nuk është privilegj, por një nga detyrimet më të rëndësishme të gjyqtarëve dhe gjykatave që buron nga të drejtat e garantuara kushtetutshmërisht individit që pretendon cenimin e të drejtave dhe lirive të tij, për të pasur një arbitër të paanshëm të mosmarrëveshjes, që do ta zgjidhë atë në themel sipas Kushtetutës dhe ligjeve *(shih vendimin nr. 35, datë 22.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese)*. Nën frymën e dispozitave të Kushtetutës për pavarësinë e gjyqësorit dhe ndarjen e pushteteve, Gjykata ka pohuar se nuk duhet të cenohen elementet e

pavarësisë, të cilat në thelb prekin vetë funksionin e dhënies së drejtësisë *(shih vendimin nr. 20, datë 9.7.2009, të Gjykatës Kushtetuese)*.

64. Për sa i përket së drejtës për një gjykatë të paanshme, ajo nënkupton mungesën e paragjykimeve nga gjyqtarët në lidhje me çështjen e shtruar përpara tyre dhe që ata të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndihmojnë interesat e njërës prej palëve. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme të caktuar me ligj kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo, gjithashtu, duhet të shikohet që bëhet *(shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023; nr. 38, datë 15.10.2007, të Gjykatës Kushtetuese)*. Gjykata ka theksuar se respektimi i parimit të paanshmërisë duhet të verifikohet duke aplikuar testin *subjektiv*, që ka të bëjë me verifikimin e bindjes ose interesit personal të një gjyqtari në një çështje të caktuar dhe testin *objektiv*, me të cilin shqyrtohet nëse gjyqtari ka ofruar garanci procedurale të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim të anshmërisë *(shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023; nr. 23, datë 4.11.2008; nr. 7, datë 11.3.2008, të Gjykatës Kushtetuese)*. Veçanërisht për sa i përket kriterit të dytë, nëse ky kriter zbatohet për anëtarët e trupit gjykues, ai nënkupton se përveç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër, edhe dukja e jashtme mund të ketë njëfarë rëndësie. Në përcaktimin nëse një çështje konkrete ka arsye logjike për të dyshuar se një gjyqtar nuk është i paanshëm, këndvështrimi i atyre që ankohen për diçka të tillë është i rëndësishëm, por jo vendimtar. Në fakt, vendimtare është nëse objektiviteti i këtyre dyshimeve është mjaftueshmërisht i bazuar *(shih vendimin nr. 49, datë 16.10.2023, të Gjykatës Kushtetuese)*.

65. Bazuar në thelbin e pretendimeve të kërkuesit për mungesën e pavarësisë së gjyqtarëve të gjykatave të posaçme, Gjykata vëren se ato (pretendimet) lidhen me faktin që ligji nr. 95/2016 parashikon një regjim të kontrollit periodik edhe të telekomunikimeve vetjake të këtyre gjyqtarëve dhe familjarëve të tyre të afërt nga BKH-ja, e cila varet nga Prokuroria e Posaçme, që është organi që ka kërkuar masat e sigurimit personal në rastin e tij. Po kështu, Gjykata vëren se kërkuesi ka evidentuar edhe përmbajtjen e nenit 53 të ligjit, sipas të cilit prokurorët e Prokurorisë së Posaçme mund të nisin një hetim penal kundër secilit gjyqtar të gjykatave të posaçme edhe për vepra penale të cilat nuk janë brenda kompetencës së saj lëndore, për të mbështetur pretendimet e tij për mungesën e pavarësisë së gjyqtarëve të gjykatave të posaçme. Duke qenë se regjimi i kontrollit të telekomunikimeve vetjake të gjyqtarëve të GJKKO-ve autorizohet nga neni 135, pika 4, i Kushtetutës, se BKH-ja është organ i parashikuar nga neni 148, pika 4, i Kushtetutës, si një njësi e posaçme hetimore në varësi të Prokurorisë së Posaçme, dhe se kompetenca lëndore e Prokurorisë së Posaçme për hetimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar përcaktohet nga neni 148, pika 4, dhe 148/dh të Kushtetutës, përfshirë edhe i çështjeve penale të kryera nga subjektet e posaçme sipas nenit 135, pika 2, i Kushtetutës, në vijim Gjykata do të vlerësojë nëse ligji nr. 95/2016 përmban rregullimet e duhura organizative dhe procedurale të cilat janë në gjendje të garantojnë pavarësinë e gjyqtarëve të gjykatave të posaçme dhe, për pasojë, të drejtën e kërkuesit për t'u dëgjuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Në këtë kuptim, ashtu siç është theksuar edhe më sipër në këtë vendim (shih supra paragrafin 38 i vendimit), Gjykata do t'i shqyrtojë pretendimet e kërkuesit për pavarësinë e gjyqtarit në drejtim të testit objektiv të parimit të paanshmërisë.

66. Gjykata vëren se sipas neneve 148, pika 4 dhe 148/dh, pika 1, të Kushtetutës, Prokuroria e Posaçme ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën për veprat penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe akuzat penale kundër funksionarëve më të lartë të shtetit. Ndërsa, sipas nenit 135, pika 4, të Kushtetutës, kandidatët për gjyqtarë në gjykatat e posaçme, si dhe familjarët e tyre të afërm, japin pëlqimin për kontrollin periodik edhe të telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit. Në bazë edhe të këtij delegimi kushtetues, ligjvënësi ka miratuar ligjin nr. 95/2016, që ka për objekt, ndër të tjera, edhe përcaktimin e rregullave për organizimin dhe zbatimin e regjimit të vëzhgimit të telekomunikimeve të gjyqtarëve të GJKKO-ve, të cilat parashikohen edhe në nenet 48–54.

67. Referuar përmbajtjes së këtyre dispozitave rezulton se ligji nr. 95/2016 ka rregulluar procesin e vëzhgimit periodik të telekomunikimeve vetjake të gjyqtarëve të gjykatave të posaçme dhe të familjarëve të tyre të afërt. Në këtë proces marrin pjesë disa aktorë, të cilët kanë role të mirëpërcaktuara nga ligji. Kështu, organi përgjegjës për zbatimin e vëzhgimit të telekomunikimeve vetjake është BKH-ja, specifikisht oficeri përgjegjës për mbikëqyrjen, që është një hetues i saj (nenet 42, 49 dhe 51), i cili përzgjidhet me short çdo 6 muaj (neni 42). Vëzhgimi nga oficeri përgjegjës i BKH-së bëhet sipas një plani të krijuar nga vetë ai çdo muaj, plan i cili ndryshohet çdo 3 muaj dhe nuk i bëhet i ditur askujt (neni 51, pika 1). Oficeri përgjegjës i BKH-së, nëse gjatë vëzhgimit të telekomunikimeve vetjake të gjyqtarit të posaçëm i lind dyshimi i arsyeshëm se një telefonatë, mesazh ose komunikim me postë elektronike është provë e korrupsionit, nxjerrjes së informacionit, komunikimit me organizata kriminale, ndikimit politik apo çfarëdo veprimi tjetër që mund të jetë në shkelje të KP-së, ia raporton atë një prokurori të posaçëm të gatshëm (nenet 42, pika 5, 51, pika 3 dhe 53, pika 1), i cili edhe ai përzgjidhet me short çdo muaj (neni 42, pika 5), duke pasur ai në vijim kompetencën për nisjen e një hetimi penal (neni 53, pika 2), hetim që zhvillohet në përputhje me rregullat e përcaktuara nga KPP-ja. Po ashtu, oficeri përgjegjës i BKH-së, nëse gjatë vëzhgimit të telekomunikimeve vetjake të gjyqtarit të posaçëm vëren shkelje të etikës nga gjyqtari i posaçëm, ia raporton atë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (neni 42, pika 9), i cili ka kompetencën për fillimin e procedimit disiplinor, procedim i cili zhvillohet sipas rregullave të përcaktuara në ligjin nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" *(ligji nr. 96/2016)*. Në këtë kuptim rezulton se në procedurën e kontrollit periodik të gjyqtarëve të gjykatave të posaçme Prokuroria e Posaçme luan rolin e saj sipas parashikimeve të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 95/2016, si organi në varësi të të cilit janë vetë oficerët përgjegjës të BKH-së.

i. Ndikimi i regjimit të vëzhgimeve në pavarësinë e gjyqtarëve të gjykatave të posaçme

68. Për sa i përket vëzhgimit të telekomunikimeve vetjake të pjesëtarëve të afërt të familjes së gjyqtarëve të posaçëm, ky vëzhgim mund të bëhet vetëm nëse: a) ekziston dyshim i arsyeshëm se telefoni është përdorur nga gjyqtari i posaçëm për të shmangur vëzhgimin e tij apo për të shërbyer si ndërmjetës për atë; b) anëtari i afërt i familjes ka dhënë pëlqimin për vëzhgimin periodik, por jo ndaj anëtarëve të familjes nën 18 vjeç. Në një rast të tillë, oficeri përgjegjës i BKH-së, brenda 24 orëve, përgatit një raport me shkrim për rezultatet e monitorimit të anëtarit të afërt të familjes dhe ia paraqet prokurorit të posaçëm të gatshëm, ndërsa ky i fundit mund të autorizojë me shkrim vazhdimin e monitorimit të telefonit të pjesëtarit të afërt të familjes në situatën e përmendur në pikën "a" ose i kërkon gjykatës një autorizim për përgjim sipas kërkesave të KPP-së kur ka dyshime të arsyeshme për veprimtari kriminale (neni 42, pikat 6 dhe 7).

69. Në lidhje me vëzhgimin e telekomunikimeve vetjake të personave që nuk kanë dhënë miratim paraprak për vëzhgimin, oficeri përgjegjës i BKH-së nuk dëgjon telefonatat që shkelin të drejtën e tyre për jetë private, por nëse ai ka dyshim të arsyeshëm se ka ndodhur apo do të ndodhë një vepër penale dhe se vëzhgimi i asaj telefonate me këta persona do të japë prova për këtë vepër penale, ai i raporton menjëherë prokurorit të posaçëm për të marrë nga gjykata autorizim për përgjim sipas kërkesave të KPP-së (neni 51, pika 5).

70. Regjistrat e telekomunikimeve vetjake dhe shënimet e tjera, si rregull, shkatërrohen brenda 3 ditëve nga oficeri përgjegjës i BKH-së, ndërsa ato ruhen për një periudhë 6-mujore nëse ngrenë dyshime të arsyeshme për veprimtari të papërshtatshme apo kriminale, gjë e cila urdhërohet me shkrim nga një prokuror i posaçëm ose gjykata e posaçme (neni 42, pika 8). Kurse të dhënat nga vëzhgimi i telekomunikimeve vetjake, si rregull, shkatërrohen pas muajit të dytë nga oficeri përgjegjës i BKH-së, me përjashtim të rastit kur ruajtja e tyre urdhërohet nga një prokuror i posaçëm nëse ngrenë dyshime të arsyeshme për veprimtari të papërshtatshme apo kriminale (neni 51, pika 4). Në çdo rast, për sa u përket të dhënave personale, oficeri përgjegjës i BKH-së është përgjegjës për mbrojtjen e tyre dhe ato ruhen e përpunohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale (neni 51, pika 4 dhe 52).

71. Nga analiza si më lart e ligjit nr. 95/2016, ndryshe nga sa pretendohet nga kërkuesi, nuk rezulton që: i. komunikimet elektronike të gjyqtarëve të posaçëm dhe të familjarëve të tyre të afërt

të vëzhgohen nga Prokuroria e Posaçme, por nga oficeri përgjegjës i BKH-së, i cili në këtë proces nuk është në lidhje varësie me atë prokurori në kuptimin e përcaktimit të planit të vëzhgimit dhe realizimit të tij, përveçse kur ngrihen dyshime për veprimtari të papërshtatshme ose kriminale, rast në të cilin ajo ka kompetencën për ushtrimin e ndjekjes penale sipas ligjit. Vëzhgimi i telekomunikimeve vetjake të gjyqtarëve të posaçëm nuk është i pakufizuar në kohë dhe në hapësirë, ndërsa ai bëhet me qëllim garantimin e besimit tek ata dhe integriteti i tyre, duke u siguruar që mos kenë lidhje me grupe kriminale apo burime të tjera ndikimi të papërshtatshme. Gjykata vëren se këto çështje janë sjellë në vëmendje të hartuesve të Kushtetutës edhe nga Komisioni i Venecias në Opinionin e tij nr. 824/2015. Në këtë Opinion Komisioni i Venecias vlerësonte, midis, të tjerash, se: "*çdo 'vëzhgim i tillë i telekomunikimeve' duhet të shoqërohet me garanci procedurale të përshtatshme dhe efektive, të përshkruara qartë në ligj [...] në veçanti duhet të ketë një autorizim gjyqësor të bazuar në një dyshim të arsyeshëm[...]" (faqe 12*)[7]. Ky vëzhgim është përcaktuar nga Kushtetuta, ndaj kushtetutshmëria e kësaj ndërhyrjeje nuk mund të vihet në diskutim, ndërkohë që në rastin e dyshimit për kryerjen e një vepre penale, ndërhyrja përmes përgjimit të telekomunikimeve vetjake, si mjet për kërkimin e provës, ndjek rregullat e përcaktuara në KPP, ndërsa është gjykata ajo që autorizon një veprim të tillë; ii. oficeri përgjegjës për vëzhgimin është pjesë e strukturës së BKH-së, e cila varet nga Prokuroria e Posaçme, por kjo varësi nënkupton varësinë procedurale hetimore, jo varësinë e saj administrative për sa i përket procesit të vëzhgimit të telekomunikimeve vetjake; iii. neni 53 i ligjit nuk rregullon kompetencën lëndore të Prokurorisë së Posaçme dhe në këtë kuptim kjo dispozitë nuk i jep bazë ligjore kompetencës së asaj prokurorie për të hetuar çdo gjyqtar të gjykatave të posaçme edhe për veprat penale të cilat nuk janë brenda kompetencës së saj lëndore.

72. Në lidhje me pretendimin për ndikimin që mund të ketë në pavarësinë e gjyqtarëve të gjykatave të posaçme regjimi i vëzhgimit periodik të telekomunikimeve të tyre vetjake, Gjykata rithekson, *së pari*, se ky regjim autorizohet nga neni 135, pika 4, i Kushtetutës. Gjyqtarët që shërbejnë në gjykatat e posaçme janë të vetëdijshëm për zbatimin periodik të këtij vëzhgimi, i cili bëhet i mundur pikërisht falë pëlqimit paraprak të dhënë nga vetë gjyqtarët dhe familjarët e tyre të afërt. *Së dyti*, Gjykata, referuar nenit 1 të ligjit nr. 95/2016, që përcakton objektin e tij, konstaton se rregullave, kushteve dhe procedurave në lidhje me kontrollin e figurës, vëzhgimin e të dhënave financiare dhe vëzhgimin e telekomunikacioneve, u nënshtrohen, në të njëjtën mënyrë si gjyqtarët e gjykatave të posaçme, edhe prokurorët e Prokurorisë së Posaçme, ashtu edhe familjarët e tyre. Thënë ndryshe, ligji nuk parashikon një regjim kontrolli vetëm për gjyqtarët. *Së treti*, Gjykata vëren se ligji nr. 95/2016, duke marrë në konsideratë edhe rekomandimet e Komisionit të Venecias, parashikon disa garanci në mënyrën e zbatimit të vëzhgimit, si më poshtë: i. shqyrtimi i komunikimeve telefonike, mesazheve apo postës elektronike të gjyqtarëve është periodik (jo permanent). Ai kryhet bazuar në një plan mujor shqyrtimi të krijuar nga oficeri përgjegjës i BKH-së. Ky plan ndryshohet çdo 3 muaj (*neni 51, pika 1*); ii. oficeri i BKH-së përgjegjës për vëzhgimin i ruan të dhënat e përftuara nga vëzhgimi për 2 muaj dhe, në rast se nuk urdhërohet nga një prokuror i Prokurorisë së Posaçme t'i ruajë të dhënat për më gjatë, i shkatërron ato pas muajit të dytë. Oficeri i BKH-së është gjithashtu përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale të gjyqtarëve dhe familjarëve të tyre të afërt në përputhje me legjislacionin përkatës (*neni 51, pika 4*); iii. oficeri përgjegjës për vëzhgimin nuk mund të dëgjojë telefonatat e personave që nuk kanë dhënë miratim paraprak për vëzhgimin. Në qoftë se ai mendon se vëzhgimi i telekomunikimeve të personave që nuk kanë dhënë pëlqim paraprak për vëzhgimin është i rëndësishëm për zbulimin e një vepre penale, ai duhet të kontaktojë menjëherë një prokuror të posaçëm të papërfshirë në shkelje për të marrë autorizim nga gjykata (*neni 51, pika 5*); iv. vëzhgimet e kryera mbi telekomunikimet vetjake të gjyqtarëve të gjykatave të posaçme dhe të familjarëve të tyre të afërt kanë vlerën ligjore të përgjimeve parandaluese në kuptimin e nenit 221, pika 5, të KPP-së dhe të ligjit nr. 9157, datë 4.12.2003, "Për përgjimin e komunikimeve elektronike". Dallimi i vetëm lidhet me procedurën e

[7] Shih opinionin e Komisionit të Venecias CDL-AD (2016) 009, datë 14 mars 2016 (https://www.venice.coe.int/ëebforms/documents/?pdf=CDL-AD(2016)009-e)

autorizimit, e cila është automatike dhe periodike sipas ligjit nr. 95/2016. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se rregullimet e dispozitave të ligjit nr. 95/2016 lidhur me regjimin e vëzhgimit periodik të telekomunikimeve vetjake të gjyqtarëve të gjykatave të posaçme, të cilave, sipas nenit 1 të tij, u nënshtrohen në të njëjtën mënyrë edhe vetë prokurorët e Prokurorisë së Posaçme, për sa kohë që edhe vetë këta të fundit janë subjekte kontrolli, ofrojnë garanci të mjaftueshme kundër abuzimit dhe arbitraritetit në fazën e zbatimit, duke garantuar në këtë mënyrë edhe pavarësinë e gjyqtarëve të gjykatave të posaçme. Për sa më sipër, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit në këtë drejtim nuk janë të bazuara.

ii. Ndikimi i strukturës përgjegjëse për vëzhgimin mbi pavarësinë e gjyqtarëve të gjykatave të posaçme

73. Në lidhje me pretendimin për ndikimin që mund të ketë mbi pavarësinë e gjyqtarëve të gjykatave të posaçme fakti që struktura përgjegjëse për vëzhgimin e telekomunikimeve të tyre vetjake është BKH-ja, e cila varet nga Prokuroria e Posaçme, që është organi që ka kërkuar masat e sigurimit personal në rastin e tij dhe i mbron ato përpara gjykatave të posaçme, Gjykata vëren, *së pari*, se sipas nenit 148, pika 4, të Kushtetutës BKH-ja është në varësi të Prokurorisë së Posaçme. *Së dyti*, Gjykata sjell në vëmendje se BKH-ja ushtron funksionet e Policisë Gjyqësore pranë Prokurorisë së Posaçme *(neni 30, pika 4, i KPP-së)*. Në këtë funksion, BKH-ja duhet të kërkojë në mënyrë aktive dhe me nismën e vet informacione për veprat penale, të pengojë ardhjen e pasojave të mëtejshme të veprave penale, të kërkojë autorët e tyre, të kryejë hetime dhe të grumbullojë të dhëna që i shërbejnë zbatimit të ligjit penal *(neni 30, pika 1, i KPP-së)*. Në cilësinë e saj si polici gjyqësore, BKH-ja ka varësi procedurale nga Prokuroria e Posaçme, pasi oficerët e saj përgjigjen para prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme për veprimtarinë e kryer në kuadër të procedimit penal *(neni 39 i ligjit nr. 95/2016)*. Në këtë kuptim, Gjykata nuk vëren ndonjë dallim në mënyrën e funksionimit të BKH-së në krahasim me njësitë e tjera të Policisë Gjyqësore të parashikuara nga KPP-ja dhe ligji nr. 25/209, "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore". *Së treti*, Gjykata vëren se, pavarësisht faktit se BKH-ja është një njësi e Policisë Gjyqësore që funksionon nën drejtimin procedural të Prokurorisë së Posaçme, në bazë të ligjit nr. 95/2016, ajo ka elemente autonomie administrative në raport me Prokurorinë e Posaçme, e cila ilustrohet nga parashikimet e mëposhtme ligjore: i. oficerët e Policisë Gjyqësore nga Policia e Shtetit dhe institucionet e tjera shërbejnë nën drejtimin administrativ të zëvendësdrejtorit të BKH-së *(neni 31, pika 3, i ligjit 95/2016*); ii. organizimi dhe funksionimi i shërbimeve të Policisë Gjyqësore të BKH-së rregullohet në përputhje me urdhrat e drejtorit të saj (BKH-së), me pëlqimin e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme *(neni 31, pika 4, i ligjit nr. 95/2016)*; iii. drejtori i BKH-së, i cili emërohet dhe shkarkohet nga detyra nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, është përgjegjës për funksionimin e asaj strukture dhe nuk është në raporte të mirëfillta varësie me drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme. Ai (drejtori) mbikëqyret nga një komision i përbërë prej tre prokurorësh të Prokurorisë së Posaçme, njëri prej të cilëve është drejtuesi i saj dhe dy të tjerët zgjidhen çdo vit me short *(neni 33, pikat 1 dhe 5, i ligjit nr. 95/2016)*; iv. drejtori i BKH-së përzgjedh nga radhët e hetuesve një zëvendësdrejtor_me pëlqimin e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme *(neni 33, pika 6);* v. hetuesit e BKH-së emërohen nga drejtori i saj, me pëlqimin e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme; vi. oficeri i BKH-së përgjegjës për vëzhgimin e telekomunikimeve të gjyqtarëve vepron në mënyrë të pavarur nga drejtuesi ose prokurorët e Prokurorisë së Posaçme *(neni 51)*. Në këtë kuptim, Gjykata, duke pasur parasysh edhe përmbajtjen e dispozitave të sipërcituara, vlerëson se ndryshe nga sa pretendon kërkuesi rregullimi i ligjit nr. 95/2016 lidhur me strukturën që kryen vëzhgimin periodik të gjyqtarëve, ndonëse ia vesh këtë përgjegjësi BKH-së, e cila është një njësi e posaçme hetimore në varësi të Prokurorisë së Posaçme, ofron garanci të mjaftueshme për pavarësinë e gjyqtarëve të posaçëm.

iii. Ndikimi i kompetencës së Prokurorisë së Posaçme për hetimin e veprave penale të kryera nga gjyqtarët e gjykatave të posaçme mbi pavarësinë e tyre

74. Në lidhje me pretendimin e kërkuesit se, referuar nenit 53 të ligjit nr. 95/2016, bazuar në informacione dhe prova të servirura nga kushdo, Prokuroria e Posaçme ka të drejtë të hetojë çdo gjyqtar të gjykatave të posaçme, edhe për veprat penale të cilat nuk janë brenda kompetencës së saj lëndore, dhe se ky fakt ndikon negativisht mbi pavarësinë e gjyqtarëve të gjykatave të posaçme,

Gjykata vëren se rregullimi i nenit 53 nuk ka të bëjë me rregullat e përgjithshme të kompetencës lëndore, siç përcaktohen ato nga neni 75/a i KPP-së, por me një proces administrativ të raportimit të informacioneve dhe provave i cili, nëse rezulton në një procedim penal, do të ndjekë rregullat e përgjithshme të kompetencës lëndore. Për këtë arsye, Gjykata çmon se, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, rregullimi i nenit 53 të ligjit 95/2016 nuk cenon garancitë për pavarësinë e gjyqtarëve të gjykatave të posaçme.

75. Për sa më sipër, Gjykata vëren se në procedurën e vëzhgimit periodik të telekomunikimeve vetjake të gjyqtarëve të gjykatave të posaçme, oficeri përgjegjës i BKH-së nuk vepron nën drejtimin e prokurorit të posaçëm për sa kohë nuk ngrihen dyshime për veprime të papërshtatshme ose të karakterit penal. Përkundrazi vëzhgimi i telekomunikimeve është një veprimtari rutinore administrative e cila mund të përshkallëzohet në një procedim penal të nisur nga prokurori i posaçëm vetëm nëse nga kjo veprimtari konstatohen elemente të konsumimit të një vepre penale që është në kompetencën lëndore të Prokurorisë së Posaçme. Për më tepër, rezultatet e këtij vëzhgimi i nënshtrohen kontrollit gjyqësor, për sa kohë ato janë objekt vlerësimi nga gjykata në rastet e procedimit penal (kur konstatohen elemente të veprës penale) dhe nga KLGJ-ja (një organ i përbërë në shumicë nga gjyqtarë) në rastet e procedimeve disiplinore të gjyqtarëve. Po kështu, dispozitat e ligjit nuk pengojnë apo përjashtojnë të drejtën e gjyqtarit që të kërkojë pushimin e cenimit për shkak të veprimtarisë së kontrollit nëse ai pretendon se ajo është kryer në kundërshtim me të drejtat e tij kushtetuese, siç janë edhe e drejta për jetë private dhe familjare për aq sa ato janë të zbatueshme. Për sa më sipër, Gjykata vëren se, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, ligji përmban garanci të mjaftueshme për të siguruar pavarësinë e gjyqtarëve të gjykatave të posaçme lidhur me mënyrën se si realizohet vëzhgimi i telekomunikimeve të tyre vetjake dhe, për pasojë, pretendimet e kërkuesit në këtë drejtim nuk janë të bazuara..

76. Për më tepër, Gjykata vlerëson të theksojë se kuadri ligjor në fuqi që rregullon statusin e magjistratit dhe të drejtat që burojnë prej tij, përmban një tërësi garancish ligjore dhe procedurale shtesë, të cilat sigurojnë pavarësinë e këtyre gjyqtarëve të posaçëm në ushtrim të funksionit të tyre, ku përfshihet sistemi i emërimit, pagës, karrierës, shkarkimin ashtu edhe trajtimin e posaçëm të tyre.

77. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit në drejtim të përmbajtjes së neneve 48–51 të ligjit nr. 95/2016, nuk është i bazuar.

B.1.3. Për cenimin e së drejtës së mbrojtjes efektive

78. Në lidhje me pretendimet për cenim të së drejtës së mbrojtjes efektive, kërkuesi ka paraqitur në thelb argumentet si më poshtë: i. GJKKO-ja e Shkallës së Parë nuk e ka njoftuar rregullisht kërkuesin për vendimin nr. 112, datë 20.10.2023, me anë të të cilit mbi kërkuesin u vendosën masat e sigurimit personal; ii. GJKKO-ja e Shkallës së Parë nuk u ka dhënë kohën e mjaftueshme mbrojtësve të zgjedhur nga ai për të realizuar një mbrojtje efektive; iii. mbrojtësja e caktuar kryesisht nga ajo gjykatë, avokatja V.T., ishte e papërshtatshme për ta mbrojtur, për shkak të qëndrimeve të saj kundër tij në rrjetet sociale dhe duhej të përjashtohej si avokat i caktuar kryesisht për të njëjtin shkak që u përjashtua edhe avokati i mëparshëm i caktuar kryesisht; iv. GJKKO-ja e Shkallës së Parë nuk e ka dorëzuar vendimin për vazhdimin e masave të sigurimit ndaj kërkuesit (vendimi nr. 117, datë 26.10.2023) të arsyetuar sipas afatit të përcaktuar nga KPP-ja.

79. Në lidhje me pretendimet për cenimin e se drejtës për mbrojtje efektive, subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se ky pretendim i kërkuesit është i pabazuar për arsyet e mëposhtme: i. për sa i takon pretendimit për mosnjoftimin e rregullt të vendimit nr. 112, datë 20.10.2023, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka kryer të gjitha veprimet për t'ia vënë në dispozicion kërkuesit, por ky i fundit ka shfrytëzuar të gjitha mundësitë për të mos e marrë atë, duke refuzuar kështu njohjen me vendimin. Në seancën gjyqësore të datës 24.10.2023 për marrjen në pyetje të personit ndaj të cilit është ekzekutuar masa e sigurimit, vendimi nr. 112, datë 20.10.2023 iu është vënë në dispozicion mbrojtësve të kërkuesit, duke qenë se ata gëzonin tagrat për të marrë në dorëzim akte për llogari të tij; ii. për sa i takon pretendimit për mungesën e kohës së mjaftueshme për përgatitjen e një mbrojtjeje efektive, subjekti i interesuar ka prapësuar se mbrojtësve të kërkuesit

u është lënë një kohë e mjaftueshme për t'u njohur me aktet e dosjes për të realizuar mbrojtjen, por ata zgjodhën të mbroheshin duke kërkuar shtyrjen e seancës dhe nëpërmjet kërkesave të tjera procedurale; iii. për sa i takon pretendimit për papërshtatshmërinë e mbrojtësit të caktuar kryesisht, subjekti i interesuar ka parashtruar se GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vepruar në respektim të mbrojtjes së të drejtave të kërkuesit, duke i caktuar atij edhe mbrojtës kryesisht.

80. Për sa më lart, bazuar në thelbin e pretendimeve të kërkuesit, konkretisht, në lidhje me: *i.* parregullsinë në njoftimin e vendimit për caktimin e masave të sigurimit; *ii.* kohën e pamjaftueshme për të realizuar mbrojtjen dhe *iii.* mosarsyetimin e vendimit sipas afatit të parashikuar nga KPP-ja, Gjykata do t'i analizojë në aspekt të pamjaftueshmërisë së kohës për realizimin e mbrojtjes. Ndërsa për sa i përket pretendimit për *iv.* papërshtatshmërinë e mbrojtëses së caktuar kryesisht, Gjykata do ta analizojë atë në aspekt të cilësisë së mbrojtjes.

81. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pranuar se e drejta e mbrojtjes në procesin penal ka përmbajtje substanciale, ajo duhet të jetë reale dhe efektive e jo vetëm teorike, dhe se ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por, përkundrazi, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të marrin të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të rregullt ligjor t'i japin mundësinë individit të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar parimin e barazisë së armëve *(shih vendimet nr. 34, datë 17.11.2022; nr. 35, datë 1.6.2015, të Gjykatës Kushtetuese).* Veçanërisht në procesin penal, mbrojtja e të pandehurit lidhet ngushtë me barazinë e armëve dhe kontradiktoritetin, të cilat së bashku përbëjnë në vetvete elementet më të qenësishme e thelbësore të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Prandaj, për respektimin e tyre, gjykata duhet të përmbushë me rigorozitet një sërë detyrimesh, me synimin kryesor realizimin e një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata me objektivitet e paanësi. Këto kërkesa kushtetuese e ligjore janë në funksion të mbrojtjes sa më efektive të të pandehurit, pasi përballë tij qëndron vetë shteti, i përfaqësuar në procesin penal nga prokurori që paraqet dhe mbron akuzën kundër tij *(shih vendimet nr. 34, datë 17.11.2022; nr. 71, datë 30.11.2016, të Gjykatës Kushtetuese)*. Sipas Gjykatës, realizimi substancial i mbrojtjes së individit është, në radhë të parë, përgjegjësi e mbrojtësit që pranon detyrën e caktuar *(shih vendimin nr. 34, datë 17.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese).*

i. Pamjaftueshmëria e kohës për realizimin e mbrojtjes efektive

82. Në lidhje me pretendimet për pamjaftueshmërinë e kohës për realizimin e mbrojtjes efektive, Gjykata vëren se ato mund të ndahen në 3 nënpretendime: i. mosnjoftimi i vendimit nr. 112, datë 20.10.2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë që ka vendosur caktimin ndaj kërkuesit të masave të sigurimit personal; ii. koha e pamjaftueshme për t'u njohur me vendimin nr. 112 dhe aktet e depozituara nga organi i akuzës përpara seancës së marrjes në pyetje të kërkuesit; iii. mosarsyetimi brenda afatit ligjor i vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë për vazhdimin e masave të sigurimit ndaj kërkuesit (vendimi nr. 117, datë 26.10.2023).

83. Për sa më sipër, referuar pretendimeve të kërkuesit, bazuar në nenet 31 dhe 42 të Kushtetutës, Gjykata çmon t'i analizojë ato në drejtim të standardeve të mësipërme kushtetuese *(shih paragrafin 81 të vendimit)* të përshtatura me natyrën e gjykimit në procesin e kundërshtuar nga kërkuesi që lidhet me vendimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë për marrjen në pyetje të personit ndaj të cilit është caktuar masa e sigurimit, i cili, sipas nenit 248, pika 1, të KPP-së, duhet të jepet brenda 5 ditëve nga dita e zbatimit të masës së sigurimit.

84. Lidhur me *nënpretendimin e parë*, se GJKKO-ja e Shkallës së Parë nuk e ka dorëzuar/njoftuar vendimin për vendosjen ndaj tij të masave të sigurimit (vendimi nr. 112, datë 20.10.2023), GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se kërkuesi dhe familjarët e tij kanë refuzuar të marrin në dorëzim vendimin e gjykatës, dokumentuar kjo nga procesverbalet përkatëse të përpiluara nga oficerët e Policisë Gjyqësore, të cilët në mënyrë të vazhdueshme kanë bërë të gjitha përpjekjet për t'ia dorëzuar atë kërkuesit personalisht. Sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë, kërkuesi ka marrë dijeni për vendimin e gjykatës dhe ka refuzuar ta nënshkruajë atë, dokumentuar kjo nga qëndrimi që ka mbajtur në konferencën për shtyp në media të ndryshme në datën 21.10.2023. Në lidhje me këtë nënpretendim, GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se e konsideron të ezauruar atë, për sa kohë ai është

ankuar personalisht ndaj atij vendimi, duke ngritur shkaqe konkrete ankuese. Në lidhje me po këtë nënpretendim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se ai është i pabazuar, për sa kohë që kërkuesi qartazi ka paraqitur ankim ndaj masës së sigurimit personal dhe për sa kohë është konstatuar investimi ezaurues i GJKKO-së së Shkallës së Parë, gjyqtares të hetimeve paraprake, për realizimin e këtij njoftimi. Sipas Kolegjit Penal, përpjekjet e palëve në funksion të evitimit/devijimit të realizimit të procedurës së njoftimit përbëjnë sjellje të "abuzimit me procesin" dhe si të tilla nuk mund të shërbejnë për të kërkuar pavlefshmërinë (në formën e inekzistencës) e procedurës së realizimit të njoftimit, për sa kohë që është "kontribuar intensivisht" (prej tyre) në pengimin e realizimit të saj. Sipas atij kolegji, ndryshe nga sa pretendohet në rekurs, nuk konstatohen shkelje të dispozitave të KPP-së për njoftimin e kërkuesit *(shih faqet 80–81 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë).*

85. Lidhur me *nënpretendimin e dytë* (koha e pamjaftueshme për t'u njohur me vendimin nr. 112 dhe aktet e tjera), rezulton se GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka konstatuar formalisht se kërkuesi në mënyrë të vullnetshme ka hequr dorë nga e drejta për t'u pyetur dhe për t'u mbrojtur. Rezulton, gjithashtu, se ajo ka ndërprerë seancën për marrjen në pyetje të kërkuesit, për t'u dhënë kohë mbrojtësve për t'u njohur me aktet. Me riçeljen e seancës mbrojtësit e kërkuesit kanë deklaruar se me vendimin sapo janë njohur dhe për të siguruar një mbrojtje efektive ishte e pamundur të vijohej seanca. Në këto kushte, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka ndërprerë seancën dhe e ka shtyrë atë për në datën 25.10.2023, ora 14:30 për t'u dhënë kohë mbrojtësve të njihen me aktet. Në seancën e datës 25.10.2023 mbrojtësit e kërkuesit kanë paraqitur kërkesë për marrjen e kopjes së akteve që ka depozituar organi i akuzës, si dhe kërkesën për dërgimin e çështjes në Gjykatë për interpretimin e nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, bazuar në nenet 38, 73, 124 dhe 145 të Kushtetutës. GJKKO-ja e Shkallës së Parë me vendim të ndërmjetëm ka disponuar lidhur me kërkesat e parashtruara nga mbrojtja. Në lidhje me po këtë nënpretendim, GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se koha e vënë në dispozicion të përfaqësuesve të kërkuesit për njohjen me provat dhe aktet ka qenë e nevojshme dhe e mjaftueshme për realizimin e një mbrojtjeje efektive (*shih faqet 17–18 të vendimit të GJKKO-së së Apelit*). Qëndrimi i gjykatave të faktit lidhur me pretendimet e kërkuesit për pamjaftueshmëri të kohës për përgatitjen e një mbrojtjeje efektive është gjykuar i drejtë nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

86. Lidhur me *nënpretendimin e tretë* se GJKKO-ja e Shkallës së Parë nuk ka arsyetuar brenda afateve ligjore të parashikuara nga KPP-ja vendimin për vazhdimin e masave të sigurimit (vendimi nr. 117, datë 26.10.2023), GJKKO-ja e Apelit dhe Kolegji Penal kanë arsyetuar se, në thelb, kjo vonesë nuk ka sjellë pasoja në të drejtën e kërkuesit për kundërshtimin e tyre në një gjykatë më të lartë dhe për të pasur përgjigje përfundimtare për pretendimet e tij.

87. Për sa më lart, në analizë të pretendimeve, prapësimeve dhe arsyetimit të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, Gjykata vlerëson se nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë janë marrë të gjitha masat për njoftimin kërkuesit të vendimit nr. 112, datë 20.10.2023, i cili ka disponuar për masat e sigurimit personal të vendosura ndaj tij. Gjithashtu, nga faktet e parashtruara më sipër, të evidentuara nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, Gjykata evidenton se kërkuesit i është dhënë koha e nevojshme për të realizuar mbrojtjen në raport me volumin e akteve dhe afatin 5-ditor brenda të cilit, sipas parashikimeve të KPP-së, duhej të përfundonte gjykimi. Gjykata vëren se brenda këtij afati kohor, në një përpjekje për të mbyllur në kohë procedimin gjyqësor, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka zhvilluar 3 seanca gjyqësore, të cilat janë shtyrë për shkak të kërkesave procedurale të mbrojtësve dhe largimit të tyre. Disa prej këtyre seancave janë ndërprerë dhe rifilluar brenda ditës, fakt ky që dëshmon për angazhimin maksimal të GJKKO-së së Shkallës së Parë për përmbylljen në kohë të procesit gjyqësor në ngarkim të kërkuesit. Ndërsa në lidhje me vonesën në arsyetimin e vendimit për vazhdimin e masave të sigurimit, Gjykata vlerëson se kjo vonesë nuk ka sjellë pasoja mbi të drejtën e kërkuesit për mbrojtje efektive, për sa kohë ai ka ushtruar normalisht të drejtat procedurale të ankimit dhe rekursit në përgjigje të të cilave GJKKO-ja e Apelit dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë kanë disponuar me vendimet përkatëse. Në këto kushte, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesit lidhur me njoftimin e vendimit që ka disponuar për masat e sigurimit

personal ndaj tij, mungesën e kohës së nevojshme për të realizuar mbrojtjen dhe mosarsyetimin në kohë të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë për vazhdimin e masave të sigurisë nuk janë të bazuara.

ii. Cilësia e mbrojtjes

88. Në lidhje me pretendimin se mbrojtësja e caktuar kryesisht nga gjykata, avokatja V.T., ishte e papërshtatshme për ta mbrojtur kërkuesin, për shkak të qëndrimeve të saj kundër tij në rrjetet sociale, Gjykata vëren se në seancën e datës 24.10.2023 për marrjen në pyetje të personit ndaj të cilit është zbatuar masa e sigurimit sipas nenit 248 të KPP-së, janë paraqitur Prokuroria e Posaçme dhe mbrojtësit e zgjedhur të kërkuesit, të pajisur me prokurë të posaçme, avokatët G.GJ. dhe S.M., të cilët, pas legjitimimit të tyre, ndër të tjera, kanë deklaruar se kërkonin përjashtimin e gjyqtares së çështjes, me pretendimin se vendimi i caktimit të masës së sigurimit ishte antikushtetues dhe se për këtë shkak kanë paraqitur një kallëzim penal ndaj asaj gjyqtareje për kryerjen e veprës penale "Shpërdorimi i detyrës". Sipas procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 24.10.2024, kërkesa për dorëheqjen e gjyqtares, e formuluar verbalisht në seancë gjyqësore, nuk u materializua në atë seancë, nëpërmjet paraqitjes së saj, sipas nenit 19, pika 1, të KPP-së.

89. Seanca e radhës është caktuar të nesërmen. Gjykata ka urdhëruar njoftimin e kërkuesit për seancën nëpërmjet shërbimeve të Policisë Gjyqësore sipas shkresës nr. 676 prot., datë 25.10.2023 të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Departamenti i Policisë Kriminale. GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka konstatuar se kërkuesi ka refuzuar të marrë personalisht njoftimin për seancën gjyqësore të datës 25.10.2023 dhe në këto kushte, duke qenë se ai ka autorizuar avokatët e zgjedhur prej tij për përfaqësimin dhe mbrojtjen në mungesë, duke i autorizuar, ndër të tjera, të merrnin çdo njoftim drejtuar tij, bazuar në nenin 351 të KPP-së, ka vendosur deklarimin e mungesës së vullnetshme të kërkuesit, duke e konsideruar të pranishëm atë nëpërmjet avokatëve të zgjedhur prej tij.

90. Po në të njëjtën seancë gjyqësore (datë 25.10.2023, ora 14:30), mbrojtësit e zgjedhur kanë paraqitur kërkesë për t'u pajisur me një kopje audio të seancës gjyqësore të datës 24.10.2023 dhe një kopje të transkriptimit/procesverbalit të seancës së po kësaj date. Këto kërkesa janë pranuar nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë kundrejt pagesës së tarifave. Në vijim të gjykimit, mbrojtësit e kërkuesit kanë kërkuar të pajisen me kopje të akteve të paraqitura nga prokuroria, për të garantuar mbrojtje efektive. GJKKO-ja u ka sjellë në vëmendje që të vijonin të realizonin mbrojtjen, pasi i kanë pasur të gjitha mundësitë për t'u njohur dhe pajisur me kopje të akteve pranë sekretarisë së asaj gjykate, duke qenë se përveç kohës së lënë në seancën gjyqësore të datës 24.10.2023, u është lënë edhe një ditë kohë (seanca e ardhshme është caktuar më 25.10.2023, ora 14:30) për njohjen me aktet, në funksion të një mbrojtjeje efektive. Në vijim, mbrojtësit e kërkuesit kanë parashtruar kërkesë për përjashtimin e gjyqtares së çështjes nga gjykimi, lidhur me qëndrimin e mbajtur në seancën gjyqësore të datës 25.10.2023 dhe janë larguar nga salla me pretendimin se nuk mund të realizonin një mbrojtje efektive. Në këto kushte, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vijuar gjykimin duke caktuar avokat kryesisht për kërkuesin.

91. Në seancën gjyqësore të datës 26.10.2023, ora 10:39, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka urdhëruar njoftimin e kërkuesit për zhvillimin e seancës nëpërmjet shërbimeve të Policisë Gjyqësore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, sipas adresave respektive, në banesën e tij, në selinë e Partisë Demokratike dhe pranë selisë së Kuvendit. Po ashtu, nëpërmjet shkresës nr. 17, datë 25.10.2023 i është bërë me dije kërkuesit se mbrojtësit e tij të zgjedhur sipas prokurës së posaçme kanë braktisur seancën gjyqësore të datës 25.10.2023. Në këto kushte, bazuar në nenet 6, 49 dhe 248 të KPP-së, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vendosur të caktojë dy avokatë kryesisht nga lista e avokatëve kryesisht të Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë.

92. Duke qenë se avokatët e caktuar kryesisht nga GJKKO-ja e Shkallës së parë kanë kërkuar një kohë më të gjatë për t'u njohur me aktet dhe provat e çështjes, duke marrë parasysh kompleksitetin e saj, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vendosur të ndërpresë shqyrtimin gjyqësor dhe seanca gjyqësore është caktuar për t'u zhvilluar po në datën 26.10.2023, ora 15:00, me qëllim që t'u lihej kohë avokatëve të caktuar kryesisht për t'u njohur me aktet e dosjes, të cilat u janë vënë

në dispozicion. Po ashtu, rezulton se në seancën e datës 26.10.2023 nga kërkuesi është paraqitur një kërkesë për përjashtimin e gjyqtares nga shqyrtimi i çështjes, për shkak se, sipas tij, vendimi nr. 112, datë 20.10.2023 i GJKKO-së së Shkallës së Parë është marrë në kundërshtim me nenet 38 dhe 73 të Kushtetutës. Kjo kërkesë është shqyrtuar nga një gjyqtare tjetër e GJKKO-së, e cila, me vendimin nr. 430, datë 26.10.2023, ka vendosur mospranimin e saj.

93. Në lidhje me avokatët e caktuar kryesisht, sipas procesverbalit të seancës të datës 25.10.2023, rezulton se avokati A.S. është përjashtuar nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë, për shkak se ka bërë disa postime në rrjetet sociale, të cilat ngrinin dyshime për realizimin e mbrojtjes së tij. Në vijim është proceduar me caktimin e dy avokateve të tjera kryesisht, të cilat sipas procesverbalit të seancës të datës 26.10.2023 rezulton se janë përjashtuar nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë, për shkak se avokatja R.B. ka deklaruar se nuk ishte gati të realizonte mbrojtjen, ndërsa avokatja tjetër, shtetasja J.K. është përjashtuar nga gjykata për shkak se realizimi i mbrojtjes së saj ishte joprofesional. Këto avokate kryesisht janë zëvendësuar në të njëjtën seancë të datës 26.10.2023 me një tjetër avokate kryesisht, shtetasen V.T., së cilës gjykata i ka lënë kohën e nevojshme për t'u njohur me aktet e çështjes. Në vijim, seanca e datës 26.10.2023 është zhvilluar në prani të kësaj avokate dhe përfundimisht, po në të njëjtën seancë, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vendosur vazhdimin e masave të sigurimit personal me karakter shtrëngues "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore", të parashikuar nga neni 234 i KPP-së dhe "Ndalimi i daljes jashtë shtetit", në referim të nenit 233, pika 1, të KPP-së.

94. Lidhur me avokaten V.T., të caktuar për të mbrojtur kryesisht kërkuesin, pas largimit të mbrojtësve të tij të zgjedhur, GJKKO-ja e Apelit ka konstatuar se ajo ka përmbushur në mënyrë të rregullt detyrën e saj, në përputhje me detyrimet që i burojnë nga ligji procedural penal dhe ligji për avokatinë. Qenia aktive në rrjetet sociale e saj (avokates V.T.), sipas GJKKO-së së Apelit lidhet me liritë dhe të drejtat e saj personale dhe nuk mund të jetë objekt i këtij gjykimi, për sa kohë që nuk provohet të ketë ndikuar në përmbushjen e rregullt të detyrës së saj. Po ashtu, mosparaqitjen e vetë kërkuesit dhe largimin vullnetar të mbrojtësve të besuar të tij, GJKKO-ja e Apelit i ka konsideruar si veprime që nuk kanë ndikuar në standardet e mbrojtjes në procesin objekt gjykimi, në kushtet kur atij i është garantuar mbrojtja me një mbrojtës kryesisht. Ndërsa, lidhur me kohën e ofruar dhe mundësinë e qasjes me provat dhe aktet, GJKKO-ja e Apelit ka arritur në përfundimin se ato kanë qenë të nevojshme dhe të mjaftueshme për mbrojtjen *(shih faqet 17–18 të vendimit të GJKKO-së së Apelit).*

95. Edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i ka konsideruar të pabazuara pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës së mbrojtjes efektive sipas nenit 248 të KPP-së, të ngritura në rekurs. Në vlerësimin e Kolegjit Penal, ndodhur para faktit të mosparaqitjes së vetë kërkuesit dhe largimit vullnetar të mbrojtësve të zgjedhur prej tij, konstatohet se nuk janë cenuar standardet e mbrojtjes në procesin objekt gjykimi, në kushtet kur atij i është garantuar mbrojtja me mbrojtës të caktuar kryesisht.

96. Për sa më lart, Gjykata, duke marrë parasysh sjelljen e vetë kërkuesit për të mos marrë pjesë në gjykim dhe mbrojtësve të zgjedhur prej tij, të cilët janë larguar nga seanca e marrjes në pyetje të kërkuesit, ku ata kanë qenë të autorizuar ta përfaqësonin atë në mungesë të tij, vëren se vetë ai (kërkuesi) ka hequr dorë nga e drejta për t'u marrë në pyetje dhe për të parashtruar përpara gjykatave fakte, argumente ose prova për sqarimin e pozitës së tij dhe kundërshtimin e argumenteve të parashtruara në kërkesën e Prokurorisë së Posaçme për caktimin e masave të sigurimit personal, si dhe për të paraqitur fakte, argumente ose prova për lehtësimin apo revokimin e masës së sigurimit personal të dhënë më parë ndaj tij. Ndërsa në lidhje me pretendimin e kërkuesit se mbrojtësja e caktuar kryesisht, avokatja V.T., nuk ishte e përshtatshme për të realizuar mbrojtjen e tij, për shkak të qëndrimeve të saj në rrjetet sociale kundër tij, Gjykata konstaton se kërkuesi nuk ka sjellë ndonjë provë për të mbështetur këtë pretendim dhe nuk ka argumentuar se si qëndrimet e saj në rrjetet sociale kanë ndikuar në realizmin e mbrojtjes. Gjykata vlerëson, gjithashtu, se ecuria e procesit për vendosjen dhe vazhdimin e masave të sigurimit përpara GJKKO-së së Shkallës së Parë tregon se ajo gjykatë ka treguar angazhimin e duhur në identifikimin dhe caktimin kryesisht të një mbrojtësi

që do të ishte në gjendje t'i garantonte kërkuesit një mbrojtje efektive. Ky angazhim dëshmohet, veç të tjerash, edhe nga fakti që deri në caktimin e avokates V.T. gjykata ka zëvendësuar 3 mbrojtës të tjerë, të cilët në vlerësimin e asaj gjykate, për arsye të ndryshme, ishin të papërshtatshëm për t'i garantuar kërkuesit një mbrojtje efektive. Për më tepër, Gjykata vlerëson se diskrecioni i gjykatës si organ procedues në identifikimin dhe caktimin e mbrojtësit kryesisht është i kufizuar, pasi ajo mund të zgjedhë vetëm midis atyre avokatëve emrat e të cilëve gjenden në listën e vënë në dispozicion nga Dhoma e Avokatisë.

97. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se në procesin gjyqësor për caktimin dhe vazhdimin e masave të sigurimit në ngarkim të kërkuesit nuk vërehet mospërmbushje e dukshme e detyrave të mbrojtjes deri në atë shkallë që të përbëjë cenim të së drejtës së kërkuesit për mbrojtje efektive.

98. Për sa u përket afateve të shpejta procedurale të veprimit të gjykatave në kontekstin e vendosjes së masave të sigurimit dhe pasojave të tyre mbi të drejtën e kërkuesit për mbrojtje efektive, Gjykata vëren se këto afate të shpejta imponohen nga përmbajtja e nenit 248, pika 1, të KPP-së, i cili parashikon se marrja në pyetje e personit ndaj të cilit janë zbatuar masat e sigurisë "Detyrimi për paraqitje" dhe "Ndalimi i daljes jashtë shtetit" duhet të bëhet brenda pesë ditëve nga zbatimi i masës dhe nenit 249, pika 7, të KPP-së, sipas të cilit kur vendimi për caktimin e masave të sigurimit nuk shpallet ose zbatohet brenda afatit, ai e humbet fuqinë. Për sa i përket seancës për vlerësimin e kushteve të zbatimit të masës së sigurimit, qëllimi i saj është që të dëgjohet subjekti i masave të sigurimit, për të vlerësuar nëse masa e caktuar ndaj tij është apo jo e arsyeshme. Referuar veprimeve të kërkuesit, që ka zgjedhur të mos marrë pjesë në këtë seancë, ashtu edhe veprimeve të mbrojtësve të tij, që kanë kërkuar kohë nga gjykata dhe në vijim janë larguar nga salla, Gjykata vlerëson se ato, në dukje, duket se janë një zgjedhje e vullnetshme e kërkuesit dhe, për këtë shkak, ai (kërkuesi) duhej të ishte në gjendje të parashikonte zëvendësimin e mbrojtësve të zgjedhur me një avokat të caktuar kryesisht nga lista e avokatëve. Në përfundim, Gjykata vlerëson se kërkuesi e ka ushtruar lirisht të drejtën e mbrojtjes në të gjitha shkallët e gjykimit, nëpërmjet mbrojtësve të caktuar kryesisht në shkallën e parë, nëpërmjet paraqitjes së ankimit dhe rekursit nga mbrojtësit e zgjedhur prej tij dhe pjesëmarrjes së tyre në gjykim (në rastin e gjykimit në gjykatën e apelit). Për këto arsye, Gjykata çmon se edhe pretendimi i kërkuesit për cenimin së drejtës së mbrojtjes, lidhur me mbrojtësen e caktuar kryesisht nuk është i bazuar.

99. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se në tërësi pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së mbrojtjes efektive është i pabazuar.

B. 1.3. Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit

100. Kërkuesi ka pretenduar se në vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është përdorur një gjuhë e pakuptueshme, e cila krijon konfuzion dhe nuk përcjell vijimësi të mendimit logjik dhe juridik, si dhe konkluzionit të arritur, duke e bërë vendimin të pakuptueshëm. Po ashtu, sipas kërkuesit, vendimet e gjykatave përmbajnë të dhëna kontradiktore, nuk janë logjike dhe nuk u kanë dhënë përgjigje shteruese pretendimeve të tij.

101. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se pretendimet e kërkuesit janë të pabazuara, pasi gjykatat i kanë kushtuar vëmendjen e duhur provave të paraqitura, analizës së tyre, bazës ligjore dhe kanë konkluduar më pas në vendimmarrjet respektive. Sipas Prokurorisë së Posaçme, pretendimet e kërkuesit kanë marrë përgjigje të arsyetuara nga gjykatat dhe vendimi për caktimin e masës së sigurimit përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 245 të KPP-së. Po ashtu, Prokuroria e Posaçme ka argumentuar se edhe vendimet e GJKKO-së së Apelit dhe Gjykatës së Lartë i përmbajnë elementet për arsyetimin e tyre dhe vendimet e kundërshtuara janë logjike, nuk kanë kundërthënie, si dhe përmbajnë referenca në ligjin e zbatueshëm.

102. Gjykata vëren se pretendimet e kërkuesit për cenimin e standardit të arsyetimit kanë të bëjnë me mjaftueshmërinë dhe qartësinë e arsyetimit nga të tria gjykatat. Për rrjedhojë, bazueshmëria e këtyre pretendimeve do të vlerësohet nga Gjykata duke analizuar mënyrën e arsyetimit të gjykatave të zakonshme.

103. Në jurisprudencën e saj në lidhje me standardin e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, Gjykata ka theksuar se funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë

dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 19, datë 21.3.2024; nr. 21, datë 26.9.2022; nr. 67, datë 10.11.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë dhe duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimet nr. 19, datë 21.3.2024; nr. 79, datë 14.12.2017; nr. 63, datë 23.9.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithsesi, zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes dhe natyrës së vendimit, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e tyre *(shih vendimet nr. 19, datë 21.3.2024; nr. 21, datë 26.9.2022; nr. 6, datë 16.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese)*. Gjykata nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme *(shih vendimet nr. 19, datë 21.3.2024; nr. 4, datë 31.1.2024; nr. 30, datë 29.5.2023, të Gjykatës Kushtetuese)*.

104. Për sa më lart, Gjykata, referuar edhe arsyetimit të gjykatave të zakonshme, vëren se ato kanë arsyetuar në mënyrë shteruese pretendimet e kërkuesit duke u dhënë përgjigje të arsyetuar atyre. Në vlerësimin e Gjykatës, vendimet e gjykatave të zakonshme plotësojnë kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për arsyetimin e tyre. Ato pasqyrojnë tërësinë e fakteve/ngjarjeve ashtu siç janë administruar në gjykim, si dhe mënyrën mbi bazën e së cilës janë analizuar dhe vlerësuar provat, mbi bazën e të cilave është vlerësuar vazhdimi i masave të sigurimit personal. Ato nuk rezultojnë që të jenë alogjike, të kenë kundërthënie, të mos kenë referencë në ligjin e zbatueshëm dhe të mos respektojnë elementet e trajtuara nga jurisprudenca kushtetuese, ndërkohë që përmbajnë arsyetim të plotë dhe të detajuar të pretendimeve të parashtruara në mjetin e ankimit mbi të cilin janë vënë në lëvizje. Gjithashtu, Gjykata konstaton se edhe Gjykata e Lartë ka ushtruar rolin e saj si gjykatë e ligjit, duke u dhënë përgjigje në thelb pretendimeve të kërkuesit të ngritura në rekurs me një vendim të arsyetuar sipas standardeve të jurisprudencës kushtetuese.

105. Për sa i përket arsyetimit të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në vlerësimin e Gjykatës, edhe pse në atë vendim janë përdorur terma teknikë që vështirësojnë në pamje të parë kuptimin e vendimit, përdorimi i tyre nuk është në atë nivel që të cenojë standardin e arsyetimit nga pikëpamja e qartësisë. Për më tepër që në Gjykatën e Lartë, në përputhje me parashikimet ligjore, kërkuesi ka qenë i përfaqësuar nga mbrojtës të zgjedhur prej tij, të cilët kanë kualifikimin e nevojshëm për të kuptuar termat teknikë të përdorur në vendim. Për këto arsye, Gjykata arrin në përfundimin se argumentet e parashtruara në vendimet e kundërshtuara janë të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese të tyre dhe nuk cenojnë ndonjë prej elementeve të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

106. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar.

B.2. Për aspektin substancial

107. Kërkuesi ka pretenduar se gjykatat nuk kanë arsyetuar nevojshmërinë e caktimit të masave të sigurimit personal të vendosura ndaj tij, duke cenuar lirinë e tij personale dhe atë të lëvizjes, si edhe të drejta të tjera të parashikuara nga Kushtetuta. Sipas tij, masat e sigurimit personal të vendosura për të janë bërë në shkelje të ligjit, nuk janë të arsyeshme ose të nevojshme, si edhe janë qartazi joproporcionale me qëllimin e kërkuar.

108. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka parashtruar se gjykatat i kanë kushtuar vëmendjen e duhur provave të paraqitura, analizës së tyre, bazës ligjore dhe kanë konkluduar më pas në vendimmarrjet respektive. Sipas Prokurorisë së Posaçme, pretendimet e ngritura nga kërkuesi kanë marrë përgjigje të arsyetuara nga gjykatat dhe vendimi për caktimin e masës së sigurimit përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 245 të KPP-së.

109. Në referim të pretendimeve të kërkuesit dhe prapësimeve të subjektit të interesuar, Gjykata, në vijim, do të vlerësojë nëse kërkuesit i janë cenuar e drejta për t'u zgjedhur dhe liria e lëvizjes, pra nëse ka pasur ndërhyrje në to, nëse ndërhyrja ka qenë me ligj, për një qëllim legjitim dhe nëse ka qenë proporcionale. Me fjalë të tjera, në këndvështrim të parashikimeve kushtetuese dhe ligjore të

jurisprudencës kushtetuese, Gjykata, në vijim, do të analizojë masat e sigurimit personal të caktuara ndaj kërkuesit përkundrejt parashikimeve të nenit 17 të Kushtetutës, sipas të cilit kufizimi i të drejtave dhe lirive mund të vendoset vetëm me ligj për një interes publik dhe duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka shkaktuar atë, si dhe kushteve e kritereve të përcaktuara në nenet 228 e 229 të KPP-së. Për të vlerësuar nëse në rastin e kërkuesit janë respektuar kriteret kushtetuese për kufizimin e lirisë së lëvizjes dhe së drejtës për t'u zgjedhur në drejtim të ushtrimit të funksionit të deputetit, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë dhe parimin e subsidiaritetit, në vijim, do të verifikojë nëse gjykatat e zakonshme kanë arsyetuar dhe interpretuar në drejtim të nevojës, përshtatshmërisë dhe ashpërsisë së masave të sigurimit të caktuara ndaj kërkuesit, si dhe nëse kanë mbajtur në konsideratë se ato përmbushin qëllimin për të cilin janë caktuar.

110. Në lidhje me të drejtën për t'u zgjedhur, Gjykata evidenton se ajo garantohet nga neni 45 i Kushtetutës dhe, sipas kësaj dispozite, çdo shtetas që ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta për t'u zgjedhur shtrihet jo vetëm mbi të drejtën për të kandiduar, por edhe mbi të drejtën për të ushtruar funksionin publik të besuar nga zgjedhësit (*shih vendimin nr. 19, datë 21.3.2024, të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, sipas nenit 38 të Kushtetutës, kushdo ka të drejtë të zgjedhë vendbanimin, si dhe të lëvizë lirisht në çdo pjesë të territorit të shtetit dhe askush nuk mund të pengohet të dalë lirisht jashtë shtetit.

111. Sipas GJEDNJ-së, çdo masë që kufizon lirinë e lëvizjes duhet të jetë në përputhje me ligjin, të ndjekë një qëllim legjitim dhe të respektojë një ekuilibër të drejtë midis interesit publik dhe të drejtave të individit *(shih De Tommaso kundër Italisë [GC], 2017, § 104; Pagerie kundër Francës, 2023, § 171; Battista kundër Italisë, 2014, § 37; Khlyustov kundër Rusisë, 2013, § 64; Labita kundër Italisë [GC], 2000, §§ 194–195)*. Një ndërhyrje do të konsiderohet "e nevojshme në një shoqëri demokratike" për një qëllim të ligjshëm nëse i përgjigjet një "nevoje sociale urgjente" dhe, në veçanti, nëse është proporcionale me qëllimin legjitim të ndjekur dhe nëse arsyet e paraqitura nga autoritetet kombëtare për ta justifikuar atë janë "relevante dhe të mjaftueshme". Testi i proporcionalitetit të ndërhyrjes kërkon që masa të jetë e përshtatshme për të arritur funksionin mbrojtës *(shih Bartik kundër Rusisë, 2006, § 46; Soltysyak kundër Rusisë, 2011, § 48 Berkovich dhe të tjerët kundër Rusisë, 2018, § 93)*. Me fjalë të tjera, sipas GJEDNJ-së, një kufizim është i justifikueshëm vetëm për aq sa ai ndihmon në arritjen e qëllimit legjitim të synuar *(shih Gochev kundër Bullgarisë, 2009, § 49; Battista kundër Italisë, 2014, § 41)*. Sipas GJEDNJ-së, vlerësimi i proporcionalitetit të ndërhyrjes bazohet në tri shtylla kryesore: justifikimi i kufizimit nën dritën e funksionit të tij mbrojtës; cilësia e vlerësimit të brendshëm; ashpërsia e kufizimit. Kjo e fundit përfshin kohëzgjatjen e masës dhe ndikimin specifik te kërkuesi *(shih Bartik kundër Rusisë, 2006, § 46; Soltysyak kundër Rusisë, 2011, § 48 Berkovich dhe të tjerët kundër Rusisë, 2018, § 93)*.

112. Në rastin konkret, Gjykata vëren se masat e sigurimit personal në ngarkim të kërkuesit janë caktuar nga gjykatat në kuadër të procedimit penal të nisur ndaj tij, në zbatim të neneve 228 e vijuese të KPP-së, në cilësinë e personit të dyshuar për kryerjen e veprës penale "Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërore ose të zgjedhurve vendorë", të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 260 e 25 të KP-së. Lidhur me interesin publik, Gjykata sjell në vëmendje se rregullat procedurale penale që lejojnë vendosjen e masave të sigurimit personal i shërbejnë mbarëvajtjes së procedimit penal të lidhur me ushtrimin e ndjekjes penale dhe zhvillimin e procesit të rregullt ligjor, ndaj ai është i prezumuar. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se ndërhyrja në të drejtat e tij kushtetuese është bërë me ligj dhe i përgjigjet një interesi publik.

113. Për sa më sipër, Gjykata, në vijim do të shqyrtojë kriterin e proporcionalitetit, duke analizuar aspektet e nevojës, përshtatshmërisë dhe ashpërsisë në raport me parashikimet e neneve 228 e vijuese të KPP-së. Në lidhje me kriterin e proporcionalitetit të ndërhyrjes, pra që marrëdhënia midis masave të sigurimit personal dhe qëllimit të ndjekur të jetë e arsyeshme, Gjykata, do të analizojë, nevojën për kufizimin e lirisë së lëvizjes dhe së drejtës për t'u zgjedhur, në drejtim të ushtrimit të funksionit të deputetit, në raport me nevojat konkrete për mbarëvajtjen e procedimit penal. Në këtë kontekst dhe në bazë të parimit të subsidiaritetit, Gjykata thekson se u takon

gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, që përveç zbatimit të ligjit material dhe procedural penal, të mbajnë parasysh edhe jurisprudencën e Gjykatës dhe të GJEDNJ-së, në lidhje me parimin e proporcionalitetit dhe se ajo duhet të konsiderohet si mjeti i fundit për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

114. Në gjykimin kushtetues lidhur me nevojën e ndërhyrjes mbi të drejtat kushtetuese të kërkuesit, Gjykata analizon fillimisht nëse masat konkrete të sigurimit të vendosura mbi të (kërkuesin) janë të nevojshme për të realizuar qëllimin e ligjshëm të mbarëvajtjes së procedimit penal në kuadër të të cilit ato janë vendosur. Më tej, Gjykata vlerëson nëse masat e vendosura janë të përshtatshme për të realizuar këtë qëllim. Së fundi, Gjykata vlerëson nëse qëllimi i ligjshëm i mbarëvajtjes së procedimit penal mund të arrihej me vendosjen e masave më pak të ashpra. Nën këtë prizëm, Gjykata vëren se sipas nenit 228, pika 3, të KPP-së, masat e sigurimit personal vendosen: i. kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit; ii. kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet; iii. kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet. Po kështu, Gjykata konstaton se sipas nenit 232 të KPP-së, masat shtrënguese janë edhe ndalimi i daljes jashtë shtetit dhe detyrimi për t'u paraqitur në Policinë Gjyqësore, të caktuara në rastin konkret ndaj kërkuesit. Masa e ndalimit të daljes jashtë shtetit është parashikuar nga neni 233 i KPP-se dhe me caktimin e saj gjyqtari urdhëron të pandehurin të mos largohet nga territori shtetëror shqiptar pa autorizimin e tij. Për sa i përket masës tjetër, ajo për detyrimin për t'u paraqitur në Policinë Gjyqësore, të parashikuar nga neni 234 i KPP-së, përmes saj gjykata urdhëron të pandehurin të paraqitet në një zyrë të caktuar të Policisë Gjyqësore dhe ajo cakton ditët dhe orët e paraqitjes, duke mbajtur parasysh punën dhe vendbanimin e të pandehurit.

115. Në rastin konkret, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 112, datë 20.10.2023, ka arsyetuar se për kërkuesin plotësohen kushtet e veçanta të parashikuara nga neni 228, pika 3, shkronjat "a" dhe "b", të KPP-së. Në vlerësimin e saj, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka arsyetuar se ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës në funksion të kësaj çështjeje, për shkak të funksionit që ka ushtruar më parë kërkuesi në kohën e kryerjes së veprës penale. Për këtë arsye, sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë, ekziston mundësia që ai të ndërhyjë dhe të ndikojë në prishjen ose asgjësimin e provave, si dhe në krijimin e rrethanave që vështirësojnë mbledhjen e provave, çfarë do të ndikonte në një hetim të mangët për sqarimin e plotë të faktit penal objekt gjykimi. Gjithashtu, sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë plotësohet edhe kushti i dytë i veçantë i parashikuar nga shkronja "b", pika 3, e nenit 228 të KPP-së, pasi për shkak të rrethanave të faktit ekziston rreziku i ikjes së kërkuesit. Vazhdimi i masës së sigurimit personal të vendosur ndaj kërkuesit me vendimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë, nr. 112, datë 20.10.2023, është konfirmuar edhe nga vendimi nr. 117, datë 26.10.2023 i së njëjtës gjykatë, e cila ka konkluduar në ekzistencën e të gjitha kushteve dhe kritereve të përgjithshme dhe të veçanta për caktimin e një mase sigurimi personal, të parashikuara në nenet 228, 229 dhe 230 të KPP-së.

116. Po kështu, GJKKO-ja e Apelit, në arsyetimin e saj ka vlerësuar se për të hetuarin (kërkuesin), plotësohet kushti i tretë për caktimin e një mase garantuese personale që është një ndër kushtet e përgjithshme, të kërkuara nga dispozita e nenit 228, pika 3, të KPP-së. Sipas GJKKO-së së Apelit ekzistojnë kushtet për kufizimin e lirisë së tij, të parashikuar në pikën 3 të nenit 228 të KPP-së, pasi vërtetohet ekzistenca e të paktën një prej tri rrethanave të parashikuara nga ajo dispozitë, siç është helmimi i procesit të marrjes ose vërtetësisë së provave dhe rreziku i ikjes së tij. Ndërkohë, vlerësimi i gjykatave të zakonshme është çmuar i drejtë nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili nuk ka gjetur të meta në arsyetimin dhe interpretimin që ato i kanë bërë nevojës për kufizimin e lirisë së lëvizjes dhe së drejtës për t'u zgjedhur në drejtim të ushtrimit të funksionit të deputetit, të kërkuesit.

117. Për sa më sipër, referuar arsyetimit dhe interpretimit të vendimeve të gjykatave të zakonshme lidhur me shqyrtimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme për caktimin ndaj kërkuesit të këtyre dy masave, Gjykata konstaton se atyre (gjykatat e juridiksionit të zakonshëm – GJKKO-

ja e Shkallës së Parë dhe ajo e Apelit) u mungon arsyetimi, për rrjedhojë nuk rezulton të kenë vlerësuar nevojën për caktimin e dy masave të sigurimit personal për të njëjtin procedim ndaj kërkuesit. Gjykata thekson se kjo mungesë arsyetimi, interpretimi dhe vlerësimi, ngre dyshime nëse ato e kanë vlerësuar kriterin e proporcionalitetit të masave në drejtim të nevojës për kufizimin e lirisë së lëvizjes dhe së drejtës për t'u zgjedhur në drejtim të kërkuesit, në funksionin e deputetit, sipas neneve 228 e vijuese të KPP-së, në raport të drejtë me qëllimin legjitim të mbarëvajtjes së procedimit penal. Në këtë kuptim, për sa kohë u konstatua mungesë në vlerësimin e elementit të nevojës për kufizimin e të drejtave dhe lirive të kërkuesit, në raport mbarëvajtjen e procedimit penal, çka është e detyrueshme sipas Kushtetutës dhe KPP-së, Gjykata vlerëson se kjo përbën shkak të mjaftueshëm për të konstatuar cenimin e parimit të proporcionalitetit në caktimin e masës "Ndalimi i daljes jashtë shtetit". Po kështu, Gjykata, mbi bazën e të njëjtave argumente, konstaton se edhe vetëm masa e sigurimit personal "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësor" duket se i plotësonte nevojat e sigurimit të mbarëvajtjes se procedimit penal[8].

118. Për sa më lart, Gjykata çmon se, në mungesë të arsyetimit të nevojës për caktimin e dy masave të sigurimit, si dhe të faktit që qëllimi legjitim i mbarëvajtjes së procedimit penal përmbushet nga masa e sigurimit të detyrimit për paraqitje, arrin në përfundimin se ka cenim të parimit të proporcionalitetit nga caktimi i masës së sigurimit "Ndalimi i daljes jashtë shtetit". Në vlerësimin e Gjykatës, mungesa e arsyetimit të nevojës në përcaktimin e dy masave tregon ndër të tjera, mosvlerësimin e këtij aspekti kushtetues dhe ligjor nga ana e gjykatave të zakonshme në caktimin e masave të sigurimit personal. Për rrjedhojë, caktimi i kësaj mase të fundit ka cenuar, në aspektin substancial, të drejtën për t'u zgjedhur dhe lirinë e lëvizjes.

119. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesit në drejtim të së drejtës për t'u zgjedhur dhe të lirisë së lëvizjes, në shkelje të nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, parimeve të paanësisë dhe pavarësisë të Gjykatës, si rezultat i rregullimeve ligjore, së drejtës për mbrojtje efektive, standardit të arsyetimit, janë të pabazuara, kurse pretendimi për cenimin e parimit të proporcionalitetit në caktimin e masës së sigurimit personal "Ndalimi i daljes jashtë shtetit" është i bazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të vendimit, ndaj kërkesa pranohet pjesërisht. Nisur nga rrethanat e çështjes, bazuar edhe në arsyetimin e mësipërm, Gjykata çmon se nuk është rasti për ta kthyer çështjen për rishqyrtim.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës.

2. Shfuqizimin, e vendimeve nr. 112, datë 20.10.2023 dhe nr. 117, datë 26.10.2023, të Gjykatës së Posaçme së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, nr. 56 (87-2023-156), datë 21.11.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

[8] Gjyqtarët Holta Zaçaj dhe Genti Ibrahimi, vlerësuan se përtej asaj që ka vendosur Gjykata, vendimet e gjykatave të zakonshme nuk kanë vlerësuar, arsyetuar dhe interpretuar veçmas për secilën masë të sigurimit personal, dhe se si këto masa i shërbejnë mbarëvajtjes së procedimit penal. Më konkretisht, gjykatat nuk kanë arsyetuar dhe vlerësuar se si caktimi i masës "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore", ishte i nevojshëm në kuptim të nenit 228 e vijuese të KPP-së, për të garantuar mos rrezikimin e marrjes apo vërtetësisë së provave të këtij procedimi (ose siç shprehen gjykatat për helmimin e provave). Për këtë arsye, kjo përbënte shkak të mjaftueshëm për të konstatuar cenim të parimit të proporcionalitetit, në drejtim të nenit 45 të Kushtetutës, në caktimin edhe të kësaj mase. Për rrjedhojë, në lidhje me aspektin substancial, kërkesa e kërkuesit duhej të pranohej pjesërisht, edhe për këtë shkak.

dhe nr. 00-2024-384, datë 5.3.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, vetëm për pjesën që kanë caktuar masën "Ndalimi i daljes jashtë shtetit" ndaj kërkuesit Sali Berisha.

3. Rrëzimin e kërkesës për pretendimet e tjera.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 21.11.2024.
Shpallur më 31.12.2024.

Kryetare pjesërisht kundër: Holta Zaçaj
Anëtarë: Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Marjana Semini
Anëtarë pjesërisht kundër: Fiona Papajorgji, Ilir Toska, Sonila Bejtja, Genti Ibrahimi

MENDIM PJESËRISHT KUNDËR

1. Në çështjen nr. 12 (S) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket kërkuesit Sali Berisha, me objekt shfuqizimin e vendimeve penale që kanë caktuar masat e sigurimit personal ndaj tij, jam e qëndrimit se kërkesa është e bazuar, dhe duhej të ishte vendosur pranimi tërësisht i saj, duke u shfuqizuar vendimet gjyqësore të të tria shkallëve të gjykimit për shkak se janë bazuar në një procedurë jokushtetuese, në kundërshtim me detyrimin e përcaktuar nga neni 73, pika 2, i Kushtetutës.

2. Shumica, bazuar në parimin *iura novit curia*, duke mbajtur në konsideratë se neni 27 garanton lirinë personale, e cila është e ndryshme nga liria e lëvizjes, e garantuar nga neni 38 i Kushtetutës, funksionin e deputetit që ushtron kërkuesi, si edhe thelbin e argumenteve të kërkuesit, i ka trajtuar ato në themel nën prizmin: *i.* e *së drejtës për t'u zgjedhur* në drejtim të ushtrimit të mandatit përfaqësues të deputetit nga kërkuesi, e mbrojtur nga neni 45 i Kushtetutës, për shkak të caktimit të dy masave të sigurimit personal ndaj tij; *ii. lirisë së lëvizjes*, e mbrojtur nga neni 38 i Kushtetutës, për shkak të caktimit të masës së sigurimit "Ndalimi i daljes jashtë shtetit". Në këtë kuptim, ajo ka vlerësuar të shqyrtojë, fillimisht, në drejtim të së drejtës kushtetuese për t'u zgjedhur dhe lirisë së lëvizjes, nëse ka pasur shkelje të nenit 73, pika 2, të Kushtetutës dhe, në vijim, në varësi të përfundimit të arritur në lidhje me këtë pretendim, të vijojë me shqyrtimin e aspekteve të tjera të procesit gjyqësor *(shih paragrafin 38 të vendimit)*.

3. Fillimisht, vlerësoj të theksoj se nuk jam dakord me mënyrën e trajtimit të çështjes nga shumica, e cila i ka parë të ndara dy masat e sigurimit personal të caktuara ndaj kërkuesit, duke i trajtuar ato edhe në themel në lidhje me aspekte të ndryshme të lirive e të drejtave kushtetuese të kërkuesit. Në vlerësimin tim, për sa kohë që në rastin konkret të dyja këto masa sigurimi janë kërkuar nga prokuroria dhe janë caktuar nga gjykatat në një procedurë të vetme gjyqësore, e cila është edhe objekt kundërshtimi, ato nuk mund të shihen dhe analizohen në mënyrë të shkëputur nga njëra-tjetra, pasi kjo qasje, siç ka ndodhur edhe në rastin konkret, çon në një qëndrim dhe përfundim të gabuar në lidhje me pretendimet e kërkuesit, duke shmangur kështu kontrollin kushtetues në drejtim të mënyrës së zbatimit të nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, që është edhe thelbi i pretendimeve të parashtruara në ankimin kushtetues individual.

4. Për sa i përket detyrimit të parashikuar nga neni 73, pika 2, i Kushtetutës, shumica e ka vlerësuar pretendimin e kërkuesit në drejtim të: i. nëse ky rregullim kushtetues shtrihet vetëm mbi *lirinë personale* ose edhe mbi *lirinë e lëvizjes* apo *liri të tjera,* të garantuara nga Kushtetuta; ii. nëse masa "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" përbën ose jo cenim të së drejtës për t'u zgjedhur dhe lirisë së lëvizjes. Për kryerjen e kësaj analize ajo ka vlerësuar të ndalet në identifikimin e qëllimit të kushtetutëbërësit, duke iu referuar: *travaux preparatoires* të procesit kushtetues të vitit 2012; analizës semantike të dispozitës kushtetuese në fjalë; precedentit të zbatimit të kësaj dispozite në rastin e deputetit S.T., të referuar nga kërkuesi, si dhe doktrinës. Në përfundim, shumica ka arritur

në përfundimin: "*Togfjalëshi "ose t'i hiqet liria në çfarëdo lloj forme" i referohet vetëm lirisë personale, të mbrojtur nga neni 27 i Kushtetutës dhe ai gjen zbatim vetëm në ato raste kur ndaj deputetit vendoset një masë kufizuese, që i heq lirinë personale. Për pasojë, autorizimi i Kuvendit është i nevojshëm vetëm nëse masat kufizuese të vendosura ndaj kërkuesit përbëjnë kufizim/heqje të lirisë së tij personale, i cili është i tillë që sjell pasoja në vetë të drejtën e deputetit për t'u zgjedhur, në aspektin e ushtrimit të të drejtave të tij si deputet, pra të vetë veprimtarisë parlamentare. Gjykata vlerëson se masa e sigurimit "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore", në këndvështrim të së drejtës për t'u zgjedhur, sipas nenit 45 të Kushtetutës, duke iu referuar llojit të detyrimit dhe shpeshtësisë së zbatimit të saj (në rastin konkret një herë në dy javë), nuk prek funksionet legjislative të Kuvendit dhe nuk e pengon kërkuesin të ushtrojë të drejtat e tij si deputet. Mbi të njëjtin argument, Gjykata vlerëson se edhe masa e sigurimit e ndalimit për të dalë jashtë shtetit nuk e pengon kërkuesin të zhvilloje jetën e tij parlamentare. Për rrjedhojë, për sa kohë që kjo masë nuk përbën kufizim të lirisë personale pika 2 e nenit 73 të Kushtetutës nuk kërkon autorizimin e Kuvendit për zbatimin e saj ndaj deputetit. Në këtë këndvështrim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit në drejtim të mënyrës së zbatimit të nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, është i pabazuar* (*shih paragrafët 46 e 59 të vendimit*).

5. Për sa më sipër, referuar qëndrimit të shumicës, ajo ka vlerësuar, se: "gjykatave të juridiksionit të zakonshëm u mungon arsyetimi, për rrjedhojë nuk rezulton të kenë vlerësuar nevojën për caktimin e dy masave të sigurimit personal për të njëjtin procedim ndaj kërkuesit. Në vlerësimin e shumicës, kjo mungesë arsyetimi, interpretimi dhe vlerësimi, ngre dyshime nëse ato e kanë vlerësuar kriterin e proporcionalitetit të masave në drejtim të nevojës për kufizimin e lirisë së lëvizjes dhe së drejtës për t'u zgjedhur në drejtim të kërkuesit, në funksionin e deputetit, sipas neneve 228 e vijuese të KPP-së, në raport të drejtë me qëllimin legjitim të mbarëvajtjes së procedimit penal. Në këtë kuptim, për sa kohë u konstatua mungesë në vlerësimin e elementit të nevojës për kufizimin e të drejtave dhe lirive të kërkuesit, në raport mbarëvajtjen e procedimit penal, çka është e detyrueshme sipas Kushtetutës dhe KPP-së, shumica ka vlerësuar se kjo përbën shkak të mjaftueshëm për të konstatuar cenimin e parimit të proporcionalitetit në caktimin e masës "Ndalimi i daljes jashtë shtetit". Po kështu, shumica, mbi bazën e të njëjtave argumente, ka konstatuar se edhe vetëm masa e sigurimit personal "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësor" duket se i plotësonte nevojat e sigurimit të mbarëvajtjes se procedimit penal. Për rrjedhojë, shumica ka çmuar se, në mungesë të arsyetimit të nevojës për caktimin e dy masave të sigurimit, si dhe të faktit që qëllimi legjitim i mbarëvajtjes së procedimit penal përmbushet nga masa e sigurimit të detyrimit për paraqitje, ka arritur në përfundimin se ka cenim të parimit të proporcionalitetit nga caktimi i masës së sigurimit "Ndalimi i daljes jashtë shtetit". Në vlerësimin e shumicës, mungesa e arsyetimit të nevojës në përcaktimin e dy masave tregon ndër të tjera, mosvlerësimin e këtij aspekti kushtetues dhe ligjor nga ana e gjykatave të zakonshme në caktimin e masave të sigurimit personal. Për rrjedhojë, caktimi i kësaj mase të fundit ka cenuar, sipas shumicës, në aspektin substancial, të drejtën për t'u zgjedhur dhe lirinë e lëvizjes *(shih paragrafët 117 dhe 118 të vendimit)*.

6. Në ndryshim nga shumica, për sa kohë që në rastin konkret masat e sigurimit ndaj kërkuesit janë caktuar në një procedurë të vetme, që është edhe objekt i këtij gjykimi kushtetues, unë kam mbajtur qasjen që zbatimi dhe interpretimi i nenit 73, pika 2, të Kushtetutës duhet të verifikuar në lidhje me këtë procedurë në tërësinë e saj dhe jo i shkëputur për secilën masë sigurimi, duke qenë kjo e vetmja mënyrë për të arritur në përfundimin nëse ka pasur shkelje të nivelit kushtetues që e bëjnë të gjithë këtë proces jokushtetues, pra nëse pretendimet e kërkuesit në këtë drejtim janë të bazuara.

7. Fillimisht, vlerësoj të sqaroj qëndrimin tim në lidhje me mënyrën se si unë e lexoj dhe interpretoj tekstin kushtetues në drejtim të konceptit *"t'i hiqet liria në çfarëdo lloj forme*". Për këtë arsye e çmoj të nevojshme të ndalem në vlerësimin e asaj se çfarë ka synuar të kuptojë norma kushtetuese me heqje të lirisë dhe se cilat janë ato forma të tjera të heqjes së lirisë së deputetit, përveç rastit të arrestimit të tij (siç ka vlerësuar shumica), për të cilat kërkohet në çdo rast marrja e autorizimit nga Kuvendi. Kjo me qëllimin për të arritur në përfundimin nëse edhe këto dy masa sigurimi personale të vendosura ndaj kërkuesit janë të tilla që përfshihen në fushën e mbrojtjes së normës kushtetuese.

8. Konstatoj se neni 73 i Kushtetutës është ndryshuar në përmbajtjen e tij aktuale në vitin 2012, ndërkohë që në përmbajtjen e tij fillestare, të miratuar në vitin 1998, kjo dispozitë parashikonte se

deputeti nuk mund të ndiqej penalisht pa autorizimin e Kuvendit dhe se autorizimi kërkohej edhe në rastin kur ai do të arrestohej. Referuar përmbajtjes së normës kushtetuese në momentin e miratimit të saj, rezulton se ajo e kishte lidhur qartësisht detyrimin për marrjen e autorizimit në mënyrë të shprehur me ndjekjen penale dhe arrestimin e deputetit. Ndërkohë, që ndryshimet që i janë bërë kësaj dispozite në vitin 2012 e kanë shtrirë tashmë mbrojtjen e saj përtej rasteve të arrestimit, duke iu referuar konceptit të "heqjes së lirisë" së deputetit.

9. Sipas nenit 27, pikat 1 dhe 3, të Kushtetutës, askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj. Ndërkohë që në pikën 2 të kësaj dispozite parashikohen si raste të kufizimit të lirisë: a) kur është dënuar me burgim nga gjykata kompetente; b) për moszbatim të urdhrave të ligjshëm të gjykatës ose për moszbatim të ndonjë detyrimi të caktuar me ligj; c) kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj; ç) për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij në organin kompetent; d) kur personi është përhapës i një sëmundjeje ngjitëse, i paaftë mendërisht dhe i rrezikshëm për shoqërinë; dh) për hyrje të paligjshme në kufirin shtetëror, si dhe në rastet e dëbimit ose të ekstradimit. Ndërkohë që në nenin 28 të Kushtetutës janë përcaktuar garancitë dhe të drejtat që i njihen personit të cilit i hiqet liria.

10. Liria dhe siguria personale gjejnë mbrojtje edhe nga neni 5 i KEDNJ-së, që parashikon se askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve të përcaktuara prej kësaj dispozite dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj. GJEDNJ-ja ka theksuar se neni 5 i Konventës, në deklarimin e "së drejtës për liri", parashikon lirinë fizike të personit dhe qëllimi i kësaj dispozite është që të sigurojë që askush të mos privohet nga liria në mënyrë arbitrare. Sipas GJEDNJ-së, heqja e lirisë nuk kufizohet në rastin klasik të paraburgimit pas arrestimit ose dënimit, por mund të marrë forma të tjera të shumta *(shih Guzzardi kundër Italisë, 1980, § 95).* Çështja e zbatueshmërisë së nenit 5 është ngritur në një sërë rrethanash, duke përfshirë: vendosjen e individëve në institucionet psikiatrike ose të kujdesit social *(shih De Ëilde, Ooms dhe Versyp kundër Belgjikës, 1971; Nielsen kundër Danimarkës, 1988; H.M. kundër Zvicrës, 2002; H.L kundër Mbretëria e Bashkuar, 2004; Storck kundër Gjermanisë, 2005; A. dhe të tjerët kundër Bullgarisë, 2011; Stanev kundër Bullgarisë [DHM], 2012);* dërgimin nga mjekët ndihmës dhe oficerët e policisë në spitale *(shih Aftanache kundër Rumanisë, 2020);* izolimin në zonat e transitit të aeroportit *(shih Z.A. dhe të tjerët kundër Rusisë [DHM], 2019; Amuur kundër Francës, 1996; Shamsa kundër Polonisë, 2003; Mogoş dhe të tjerët kundër Rumanisë (dhjetor), 2004; Mehdidi dhe Haddar kundër Austrisë (dhjetor), 2005; Riad dhe Idiab kundër Belgjikës, 2008*); mbylljen në zonat e transitit kufitar tokësor *(Ilias dhe Ahmed kundër Hungarisë [DHM], 2019;* R.R. *dhe të tjerët kundër Hungarisë, 2021*); marrjen në pyetje në një stacion policie *(shih Cazan kundër Rumanisë, 2016; I.I. kundër Bullgarisë, 2005; Osypenko kundër Ukrainës, 2010; Salayev kundër Azerbajxhanit, 2010; Farhad Aliyev kundër Azerbajxhanit, 2010; Kreangă kundër Rumanisë [DHM], 2012);* vendosjen në një makinë policie për të hartuar një kallëzim për kundërvajtje administrative *(shih Zelčs kundër Letonisë, 2020*); ndalimet dhe kontrollet nga policia *(shih Foka kundër Turqisë, 2008; Gillan dhe Quinton kundër Shteteve të Bashkuara Mbretëria, 2010; Shimovolos kundër Rusisë, 2011);* kontrollin e banesës *(shih Stănculeanu kundër Rumanisë, 2018*); shoqërimin policor *(shih Rozhkov kundër Rusisë (nr. 2), 2017; Tsvetkova dhe të tjerët kundër Rusisë, 2018);* masat e kontrollit të turmës të miratuara nga policia për arsye të rendit publik *(Austin dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar [GC], 2012)*; masa e arrestit në shtëpi (*Buzadji kundër Republikës së Moldavisë [GC], 2016; Mancini kundër Italisë, 2001; Lavents kundër Letonisë, 2002; Nikolova kundër Bullgarisë (nr. 2), 2004; Dacosta Silva kundër Spanjës, 2006*); mbajtjen e emigrantëve nga deti në ambientet e pritjes dhe në anije *(shih Khlaifia dhe të tjerët kundër Italisë [GC], 2016*); mbajtjen e emigrantëve të parregullt në objektet e vendeve të azilit *(shih J.R. dhe të tjerët kundër Greqisë, 2018);* bllokimin kombëtar për shkak të pandemisë COVID-19 *(shih Terheş kundër Rumanisë (dhjetor), 2021).*

11. Sipas GJEDNJ-së, për të përcaktuar nëse dikujt i është "hequr liria", sipas nenit 5 të KEDNJ-së, së pari, duhet të merret parasysh gjendja specifike e personit ndaj të cilit është marrë ajo masë dhe një sërë faktorësh të tjerë, siç janë lloji, kohëzgjatja, efektet dhe mënyra e zbatimit të masës në fjalë. Dallimi midis "heqjes" dhe "kufizimit", sipas nenit 5, pika 1, dhe kufizimit të lirisë së lëvizjes, sipas qëllimit të nenit 2 të protokollit nr. 4 të KEDNJ-së, përcaktohet nga shkalla ose

intensiteti dhe jo nga natyra ose substanca *(shih Guzzardi kundër Italisë, 6 nëntor 1980, §§ 92-93; Nada kundër Zvicrës [DHM], nr. 10593/08, § 225, GJEDNJ 2012; Austin dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar [DHM], nr. 39692/09, 40713/09 dhe 41008/09, § 57, GJEDNJ 2012; Stanev kundër Bulgarisë [DHM], nr. 36760/06, § 115; dhe Medvedyev dhe të tjerët kundër Francës [DHM], nr. 3394/03, GJEDNJ 2010*). Gjithsesi, nocioni i "heqjes së lirisë", sipas kuptimit të nenit 5, pika 1, të KEDNJ-së, përmban si elementin *objektiv* të izolimit të një individi në një hapësirë të caktuar dhe të kufizuar për një kohë jo të papërfillshme, ashtu edhe një element shtesë *subjektiv* në atë që personi nuk ka dhënë pëlqimin në mënyrë të vlefshme për izolimin në fjalë *(shih Storck v. Germany, 2005, § 74; Stanev v. Bulgaria [GC], 2012, § 117).*

12. Nga ana tjetër, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se kufizimi i lëvizjes, në disa rrethana specifike, mund të jetë mjaft serioz sa të konsiderohet heqje lirie, e cila mund të marrë forma të ndryshme nga rasti klasik i paraburgimit ose dënimit *(shih Guzzardi kundër Italisë, 6 nëntor 1980, § 95)*. Faktorët objektivë që duhet të merren parasysh përfshijnë dimensionet dhe karakteristikat e një zone të kufizuar në të cilën është kufizuar lëvizja e një individi, mundësia për t'u larguar nga kjo zonë, shkalla e mbikëqyrjes dhe kontrollit mbi lëvizjet e tij, shtrirja e izolimit dhe disponueshmëria e kontakteve sociale *(shih Guzzardi kundër Italisë, 1980, § 95; De Tommaso kundër Italisë [DH], 2017, §§ 83-88; Nada kundër Zvicrës [DHM], 2012, §§ 229–232).*

13. Duke iu referuar analizës së mësipërme të GJEDNJ-së në drejtim të lirisë personale dhe ndërthurjes së saj me lirinë e lëvizjes, në vijim do të ndalem në vlerësimin se në çfarë mase kufizimi i lirive dhe i të drejtave të deputetit përmes caktimit të masave të sigurimit është i tillë që mund të barazohet me heqjen e lirisë ndaj tij. Dua të ritheksoj edhe njëherë në këtë drejtim se kushtetutëbërësi jo pa qëllim në tekstin kushtetues nuk i është referuar në mënyrë të shprehur arrestimit të deputetit, duke dashur ai të shtrijë mbrojtjen kushtetuese jo vetëm në këto raste, por në çdo rast kur ndërhyrja në gëzimin dhe ushtrimin e të drejtave dhe lirive nga deputeti është e tillë që mund të përbëjë, në thelb, heqje të tyre. Edhe pse i bashkohem qëndrimit të shumicës se imuniteti i deputetëve nuk është privilegj personal i tyre, por qëllimi kryesor i tij është mbrojtja e vetë parlamentit dhe në veçanti funksionimi i duhur i tij *(shih paragrafin 50 të vendimit),* nuk jam dakord me qëndrimin e shumicës, se: *"kur interpretohen rregullat për imunitetin duhet të përjashtohet metoda e interpretimit të zgjeruar, ndaj edhe fusha e rregullimit të pikës 2 të nenit 73, që lidhet me imunitetin procedural të deputetëve, duhet interpretuar në mënyrë të kufizuar/ngushtë" (shih paragrafin 49 të vendimit).*

14. Qasja e shumicës në fakt ka zhveshur normën kushtetuese nga qëllimi dhe fusha e mbrojtjes së saj, për rrjedhojë duke e bërë të pavlefshëm parashikimin aktual të kësaj dispozite. Nëse kushtetutëbërësi do të kishte pasur qëllim të ofronte një mbrojtje kaq të kufizuar ndaj deputetëve ai do ta kishte bërë këtë në mënyrë të shprehur, ashtu siç ka vepruar në miratimin e Kushtetutës në vitin 1998 dhe në të njëjtën mënyrë siç është vepruar edhe në tekste kushtetuese të vendeve të tjera, në të cilat gjenden parashikime të shprehura në drejtim të dhënies së autorizimit nga Kuvendi, duke përcaktuar qartësisht llojin e masës së sigurimit personal ndaj së cilës zbatohet ky detyrim.

15. Në këtë kuptim, në ndryshim nga shumica, jam e mendimit se togfjalëshi *"ose t'i hiqet liria në çfarëdo lloj forme"* nuk i referohet dhe nuk gjen zbatim vetëm në ato raste kur ndaj deputetit vendoset një masë kufizuese e lirisë personale, siç është arrestimi i tij, por i referohet dhe gjen zbatim edhe në lidhje me masat e tjera me karakter shtrëngues personal për sa kohë ato janë të afta të prekin në forma të ndryshme ushtrimin e lirive dhe të drejtave themelore. Duke pasur parasysh se heqja e lirisë nuk mund dhe nuk duhet të interpretohet në kuptim të ngushtë dhe strikt literal se nënkupton vetëm arrestimin e deputetit, unë vlerësoj se togfjalëshi "*ose t'i hiqet liria në çfarëdo lloj forme*" nuk i referohet vetëm lirisë personale, të mbrojtur nga neni 27 i Kushtetutës, por se ai gjen zbatim në të gjitha ato raste kur masat e sigurimit me karakter personal prekin liritë dhe të drejtat e deputetit në atë masë që konsiderohen, në thelb, si heqje të tyre.

16. Në këtë këndvështrim, vlerësoj se mbrojtja e dhënë nga neni 73, pika 2, i Kushtetutës nuk kufizohet vetëm në rastin klasik të arrestimit të deputetit, por se ajo mund të shfaqet dhe të marrë edhe forma të tjera, pra zbatohet edhe në lidhje me masat e tjera me karakter shtrëngues, llojet e të cilave janë të përcaktuara në dispozitat e KPP-së. Për rrjedhojë, me qëllim arritjen në një përfundim

të drejtë në lidhje me zbatimin e kësaj dispozite kushtetuese kërkohet vlerësimi, rast pas rasti, i llojit të masës së caktuar në drejtim të lirisë/së drejtës kushtetuese që preket dhe, në vijim, në drejtim të mënyrës në të cilën ajo ndërhyn në ato liri dhe të drejta të deputetit dhe pasojat që sjell konkretisht në ushtrimin e këtyre të fundit.

17. Thënë sa më sipër, qasja ime është se zbatimi i nenit 73, pika 2, të Kushtetutës nuk është i lidhur në vetvete me llojin e masës së sigurimit, por me pasojat që vijnë prej saj në liritë dhe të drejtat kushtetuese. Kjo do të thotë se vlerësimi në rastin konkret nuk ka të bëjë thjesht me llojin e masës personale shtrënguese që kërkohet nga prokuroria dhe caktohet nga gjykata, por me pasojat e ardhura dhe të provuara në ushtrimin dhe gëzimin e të drejtave dhe lirive kushtetuese, pra nëse kufizimi është në atë masë që e bën thuajse të pamundur ushtrimin e tyre, duke u konsideruar kështu se përbën, në thelb, heqje të tyre.

18. Referuar vendimeve gjyqësore objekt kërkese, rezulton se për zbatimin e masës së sigurimit personal "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" është përcaktuar për kërkuesin detyrimi që ai të paraqitet të hënën e parë dhe të tretë të çdo muaji, ora 10:00, përpara OPGJ-së pranë Prokurorisë së Posaçme. Për rrjedhojë, duke pasur parasysh mënyrën e zbatimit të kësaj mase në drejtim të pasojave të ardhura në ushtrimin dhe gëzimin e lirive dhe të drejtave kushtetuese të kërkuesit, ku përfshihet edhe e drejta për t`u zgjedhur, e garantuar nga neni 45 i Kushtetutës, vlerësoj se detyrimi që kërkuesi të paraqitet një herë në dy javë përpara OPGJ-së në drejtim të natyrës së këtij detyrimi dhe vetë periodicitetit të masës, nuk është provuar dhe as nuk rezulton që ta ketë vendosur atë në pamundësinë për të ushtruar të drejtat që burojnë nga mandati përfaqësues ose ndonjë liri a të drejtë tjetër kushtetuese. Vetëm në këtë aspekt unë vlerësoj se kjo masë sigurimi nuk e kufizon lirinë personale të kërkuesit në atë masë e formë që të konsiderohet si heqje e saj, për sa kohë që jo vetëm nuk përbën kufizim të veprimtarisë parlamentare në atë masë që të cenojë thelbin e saj, pra të kufizojë, deri në pamundësinë e ushtrimit të tij, mandatin e deputetit, por as kufizim të ndonjë lirie pse të drejte tjetër kushtetuese.

19. Për rrjedhojë, vlerësoj se në rastin konkret nuk gjen zbatim detyrimi i parashikuar nga pika 2 e nenit 73 të Kushtetutës për caktimin e masës së sigurimit personal "Detyrimi për t`u paraqitur në policinë gjyqësore". Ndaj jam e qëndrimit se në lidhje me këtë masë nuk ishte e detyrueshme marrja e autorizimit nga Kuvendi, duke arritur në këtë përfundim, bazuar ngushtësisht në rrethanat konkrete të çështjes në shqyrtim dhe vetëm në pasojat konkrete të ardhura në të drejtat e kërkuesit.

20. Megjithatë, vlerësoj të theksoj edhe njëherë se çështje të kësaj natyre duhet të trajtohen rast pas rasti, duke u vlerësuar nëse mënyra e zbatimit të masës së sigurimit personal "*Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore*", e caktuar ndaj një deputeti të Kuvendit, për nga lloji i detyrimit dhe shpeshtësia e tij, pra për nga mënyra e zbatimit të saj, është e tillë që sjell pasoja që ndërhyjnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në ushtrimin e funksionit kushtetues nga vetë deputeti ose në liritë dhe të drejtat e tjera kushtetuese të tij.

21. Në vijim, duke e parë çështjen në tërësinë e saj, vlerësoj se për sa i përket masës tjetër personale të caktuar ndaj kërkuesit "Ndalimi i daljes jashtë shtetit", ajo ka ndërhyrë në liritë kushtetuese vetjake të tij në atë masë që kërkonte respektimin e detyrimit të përcaktuar nga neni 73, pika 2, i Kushtetutës. Për sa kohë që vlerësova më sipër se heqja e lirisë së individit merr dhe shfaqet në forma të ndryshme, në rastin konkret vlerësoj se masa e sigurimit *"Ndalimi i daljes jashtë shtetit"* është e tillë që e pengon individin në ushtrimin e një të drejte themelore, duke përbërë kështu zhveshje nga kjo e drejtë, pra, në thelb, heqje të saj.

22. Në lidhje me këtë masë sigurimi personale, unë jam e qëndrimit se ajo është e tillë që nuk sjell thjesht një kufizim të një lirie, por e zhvesh kërkuesin nga njëra prej lirive themelore kushtetuese, të parashikuara në kreun II të Kushtetutës. Në këtë kre, së bashku me të drejtat dhe liritë themelore të individit, ku përfshihet edhe liria personale, e garantuar në nenin 28, është përfshirë edhe liria e lëvizjes, duke parashikuar neni 38, pika 2, i Kushtetutës, se: *"Askush nuk mund të pengohet për të dalë lirisht jashtë shtetit"*. Liria e lëvizjes është një nga të drejtat vetjake të individit, e cila është e përfshirë nën të njëjtën ombrellë kushtetuese dhe gëzon të njëjtën mbrojtje sikundër të drejtat e tjera kushtetuese vetjake, ku përfshihet edhe liria personale. Kjo nënkupton se çdo

ndërhyrje në të drejtat dhe liritë vetjake duhet të vlerësohet dhe konsiderohet nën dritën e garancive të nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, pra nëse ajo për nga pasojat dhe efektet e saj është e tillë që e zhvesh individin në atë masë sa ia heq tërësisht lirinë/të drejtën.

23. Për sa i takon rastit konkret, urdhërimi i kërkuesit për të mos u larguar jashtë territorit të vendit pa vendim të gjykatës e ka asgjësuar tërësisht lirinë e tij kushtetuese të lëvizjes jashtë shtetit, duke e bërë nul atë dhe duke përbërë kjo ndërhyrje, në thelb, heqje të kësaj lirie. Kjo nënkupton se në lidhje me këtë masë sigurimi personale të caktuar ndaj kërkuesit, për shkak të natyrës së saj dhe mënyrës se si ka ndërhyrë në lirinë vetjake të tij të garantuar nga neni 38, pika 2, i Kushtetutës, duhej të ishte kërkuar në çdo rast autorizimi i Kuvendit në përputhje me parashikimet e nenit 73, pika 2, të Kushtetutës. Mosrespektimi i kësaj kërkese e bën tërësisht jokushtetuese të gjithë procedurën e ndjekur nga Prokuroria e Posaçme, për pasojë edhe vendimmarrjen e gjykatave që e kanë vlerësuar të ligjshme atë.

24. Në këto kushte, për sa kohë që arrita në përfundimin se procedura e ndjekur në rastin e kërkuesit përmban probleme kushtetutshmërie, unë nuk e vlerësoj të nevojshme të ndalem në aspekte të tjera të procesit të kundërshtuar që kanë të bëjnë me ligjshmërinë e masave të caktuara ndaj kërkuesit në drejtim të proporcionalitetit të tyre.

25. Në përfundim, bazuar në argumentet e mësipërme, vlerësoj se kërkesa duhej të ishte pranuar tërësisht, për sa kohë që në procedurën e caktimit të masave të sigurimit ndaj kërkuesit nuk është respektuar detyrimi i parashikuar nga neni 73, pika 2, i Kushtetutës, çka e bën këtë procedurë dhe vendimet gjyqësore të dhëna nga gjykatat jokushtetuese në tërësinë e tyre.

Anëtare: Sonila Bejtja

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkuesit Sali Berisha, me objekt: "*Shfuqizimi i vendimeve nr. 112, datë 20.10.2023 dhe nr. 117, datë 26.10.2023, të Gjykatës së Posaçme së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 56 (87-2023-156), datë 21.11.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2024-384, datë 5.3.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*", jemi kundër qëndrimit të shumicës për pranimin e pjesshëm të kërkesës, pasi vlerësojmë se kërkesa duhej të ishte rrëzuar tërësisht. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës, parashtrojmë në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin tonë kundër.

2. Nga rrethanat e çështjes, rezulton se ndaj kërkuesit, deputet i Kuvendit, ka filluar një procedim për kryerjen e disa veprave penale të kryera gjatë kohës kur ai ushtronte funksionin e Kryeministrit. Prokuroria e Posaçme ka paraqitur kërkesën për caktimin e masave të sigurimit personal "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" dhe "Ndalimi i daljes jashtë shtetit", të cilat janë pranuar nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë, si për caktimin, ashtu edhe vazhdimin e zbatimit të tyre. Këto vendime janë lënë në fuqi nga GJKKO-ja e Apelit, ndërsa për rekursin e kërkuesit Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e tij.

3. Në këto kushte, kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual, duke pretenduar se vendimet gjyqësore për caktimin e masave të sigurimit personal i kanë cenuar lirinë personale dhe lirinë e lëvizjes, në aspektin substancial dhe procedural. Fillimisht, theksojmë se bashkohemi me shumicën, e cila, bazuar në parimin *iura novit curia*, i ka trajtuar pretendimet e kërkuesit në lidhje me: *i. të drejtën për t'u zgjedhur* në drejtim të ushtrimit të mandatit përfaqësues të deputetit nga kërkuesi, të mbrojtur nga neni 45 i Kushtetutës, për shkak të caktimit të dy masave të sigurimit personal ndaj tij; *ii. lirinë e lëvizjes*, të mbrojtur nga neni 38 i Kushtetutës, për shkak të caktimit të masës së sigurimit "Ndalimi i daljes jashtë shtetit". Po në këtë kuptim, në drejtim të së drejtës kushtetuese për t'u zgjedhur dhe lirisë së lëvizjes, jemi me të njëjtin mendim me shumicën në vlerësimin në lidhje me autorizimin e Kuvendit të parashikuar nga neni 73, pika 2, i Kushtetutës, si dhe me analizën për

aspektet e tjera procedurale të procesit gjyqësor, që kanë të bëjnë me: i. cenimin e parimeve të paanshmërisë dhe pavarësisë së gjykatës si rezultat i rregullimeve ligjore; ii. cenimin e së drejtës për mbrojtje efektive; iii. cenimin e standardit të arsyetimit.

4. Ajo që na ndan nga shumica ka të bëjë me vlerësimin e aspektit substancial të kufizimit të së drejtës për t'u zgjedhur në lidhje me ushtrimin e funksionit të deputetit dhe së drejtës kushtetuese të lëvizjes së lirë, të garantuara nga nenet 45 dhe 38 të Kushtetutës, në drejtim të parimit të proporcionalitetit të masave të sigurimit personal të vendosura për kërkuesin. Për këtë qëllim, shumica ka evidentuar se këto masa kanë sjellë si pasojë një kufizim në të drejtat kushtetuese të lartpërmendura. Për këtë arsye, ajo ka analizuar nëse ky kufizimi plotëson kriteret e nenit 17 të Kushtetutës, pra nëse ai është bërë vetëm me ligj, për interes publik dhe nëse është në raport të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë (kriteri i proporcionalitetit) *(shih paragrafin 109 të vendimit).*

5. Ndërsa bashkohemi me shumicën për dy kriteret e para, pra që masat e sigurimit personal marra janë bërë me ligj (në kuadër të një procedimi penal për veprat penale të parashikuara nga nenet 260 dhe 25 të KP-së) dhe për interes publik, i cili në këto raste është i prezumuar dhe lidhet me mbarëvajtjen e procesit penal në funksion të dhënies së drejtësisë *(shih paragrafin 112 të vendimit),* nuk ndajmë të njëjtin qëndrim në lidhje me kriterin e proporcionalitetit. Në analizën e këtij kriteri shumica bazuar në parimin e subsidiaritetit sipas të cilit u takon gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të shprehen fillimisht në lidhje me parimin e proporcionalitetit, ka analizuar aspektet e nevojës, përshtatshmërisë dhe ashpërsisë së masave në raport me parashikimet e neneve 228 e vijuese të KPP-së. Në këtë drejtim në mënyrë që marrëdhënia midis masave të sigurimit personal dhe qëllimit të ndjekur të jetë e arsyeshme, shumica ka analizuar nevojën për kufizimin e lirisë së lëvizjes dhe të drejtës për t'u zgjedhur, në drejtim të ushtrimit të funksionit të deputetit, në raport me nevojat konkrete për mbarëvajtjen e procedimit penal *(shih paragrafin 113 të vendimit).*

6. Kriteri i proporcionalitetit është analizuar nga shumica në drejtim të nevojës dhe arsyetimit të gjykatave të zakonshme në lidhje me të. Sipas saj (shumicës), referuar arsyetimit dhe interpretimit të vendimeve të gjykatave të zakonshme lidhur me shqyrtimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme për caktimin ndaj kërkuesit të këtyre dy masave, atyre (gjykatave të juridiksionit të zakonshëm) u mungon arsyetimi, për rrjedhojë nuk rezulton të kenë vlerësuar nevojën për caktimin e dy masave të sigurimit personal për të njëjtin procedim ndaj kërkuesit. Në vlerësimin e shumicës kjo mungesë arsyetimi, interpretimi dhe vlerësimi, ngre dyshime nëse ato e kanë vlerësuar kriterin e proporcionalitetit të masave në drejtim të nevojës për kufizimin e lirisë së lëvizjes dhe së drejtës për t'u zgjedhur në drejtim të kërkuesit, në funksionin e deputetit, sipas neneve 228 e vijuese të KPP-së, në raport të drejtë me qëllimin legjitim të mbarëvajtjes së procedimit penal. Në këtë kuptim, shumica ka vlerësuar se për sa kohë u konstatua mungesë në vlerësimin e elementit të nevojës për kufizimin e të drejtave dhe lirive të kërkuesit, në raport mbarëvajtjen e procedimit penal, çka është e detyrueshme sipas Kushtetutës dhe KPP-së, kjo përbën shkak të mjaftueshëm për të konstatuar cenimin e parimit të proporcionalitetit në caktimin e masës "Ndalimi i daljes jashtë shtetit". Po kështu, shumica, mbi bazën e të njëjtave argumente, ka konstatuar se edhe vetëm masa e sigurimit personal "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësor" duket se i plotësonte nevojat e sigurimit të mbarëvajtjes se procedimit penal *(shih paragrafin 117 të vendimit).*

7. Në vlerësimin tonë, analiza për proprocionalitetin e masave të sigurimit personal dhe verifikimi nëse gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë arsyetuar në këtë drejtim lidhet me nevojat e sigurimit në rastin konkret, të identifikuara përmes kushteve dhe kritereve të përcaktuara në nenet 228, pika 3 dhe 229 të KPP-së. Konkretisht, sipas nenit 228, pika 3, të KPP-së, masat e sigurimit personal vendosen: i. kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit; ii. kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet; iii. kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet. Ndërsa sipas nenit 229 të KPP-së, në caktimin e masave, gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës masë me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret *(pika 1)* dhe ato duhet të jenë në raport me rëndësinë e faktit dhe

me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Në këtë rast, mbahen parasysh vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga KPP-ja *(pika 2).*

8. Në këtë kuptim vërejmë se në vlerësimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme për vendosjen e masave të sigurimit personal ndaj kërkuesit *"Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore"* dhe *"Ndalimi i daljes jashtë shtetit",* GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 112, datë 20.10.2023, ka arsyetuar se, në rastin konkret, për kërkuesin, plotësohen kushtet e veçanta të parashikuara nga neni 228, pika 3, shkronjat "a" dhe "b", të KPP-së. Në vlerësimin e saj, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka arsyetuar se ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës në funksion të kësaj çështjeje, për shkak të marrëdhënieve të krijuara si rezultat i ushtrimit më parë nga kërkuesi të funksionit të Kryeministrit, por edhe atij aktual si deputet, sikundër edhe të influencave që mund të ketë te persona të tjerë. Për këtë arsye, sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë, ekziston mundësia që ai të ndërhyjë dhe të ndikojë në prishjen ose asgjësimin e provave, si dhe në krijimin e rrethanave që vështirësojnë mbledhjen e provave, çfarë do të ndikonte në një hetim të mangët për sqarimin e plotë të faktit penal objekt gjykimi. Gjithashtu, sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë plotësohet edhe kushti i dytë i veçantë i parashikuar nga shkronja "b", pika 3, i nenit 228 të KPP-së, pasi nisur nga natyra e veprës penale që ai dyshohet dhe sanksioni që ligji parashikon për të, ekziston rreziku i ikjes së kërkuesit. Për sa u takon kritereve për caktimin e masave të sigurimit, të parashikuara në nenin 229 të KPP-së, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka mbajtur parasysh rëndësinë e faktit dhe rrezikshmërinë e lartë të veprës penale, sanksionin me burgim të parashikuar për të dhe përhapjen e gjerë të saj, rolin e personit nën hetim dhe kryerjen e veprës penale në formën e bashkëpunimit, pasojat e ardhura prej saj, si dhe moshën e gjendjen gjyqësore të personit nën hetim, referuar të cilave, sipas saj, masat e sigurimit të kërkuara nga prokurori janë në përshtatje me shkallën e nevojave të sigurimit në rastin konkret.

9. Vazhdimi i zbatimit të masës së sigurimit personal të vendosur ndaj kërkuesit është konfirmuar në vijim me vendimin nr. 117, datë 26.10.2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë, pas realizimit të seancës për pyetjen e kërkuesit, ndërsa ajo ka rikonfirmuar vijimin e ekzistencës së kushteve dhe kritereve të caktimit të masës, si dhe të nevojave të sigurimit, duke mbajtur në konsideratë për këtë edhe sjelljen e tij, pas njoftimit/zbatimit të masës, ku referuar deklaratave të tij për të mos e zbatuar masën e sigurimit, ngrihej dyshimi për rrezikun se ai nuk do të ishte në dispozicion të organit procedues gjatë hetimeve paraprake.

10. Analiza për plotësimin e kushteve dhe kritereve të caktimit të masave të sigurimit personal, të parashikuara nga neni 228 i KPP-së, është bërë edhe nga GJKKO-ja e Apelit, e cila ka arritur në të njëjtat përfundime si dhe GJKKO-ja e Shkallës së Parë. Vendimet e gjykatave të posaçme, mbi rekursin e kërkuesit, i janë nënshtruar kontrollit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i cili i ka vlerësuar se në rekurs nuk janë ngritur shkaqe nga ato të parashikuara nga ligji, duke i gjetur praktikisht të drejta ato vendime. Sipas tij, gjykatat më të ulëta kanë argumentuar mjaftueshëm dhe në mënyrë ezauruese kushtet dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit personal të parashikuara nga nenet 228 dhe 229 të KPP-së, bazuar në një vlerësim cilësor të provave dhe jo në konstatime të përgjithshme.

11. Për sa më lart, ne, gjyqtarët në pakicë, vërejmë se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në vlerësimin e tyre për masat e sigurimit personal të vendosura ndaj kërkuesit, kanë arsyetuar mjaftueshëm në lidhje me justifikimin e vendosjes bashkërisht të tyre, duke arsyetuar edhe në drejtim të "masës së duhur", pra nëse ajo ishte e "përshtatshme" në raport me nevojat e sigurimit. Po kështu, ato (gjykatat) kanë analizuar rrezikun e "helmimit" të marrjes ose vërtetësisë së provave, sikundër edhe atë të largimit të kërkuesit, referuar rrethanave konkrete të faktit, situata këto që, sipas tyre, do të ndikonin në mbarëvajtjen e procesit penal dhe dhënien e drejtësisë.

12. Në arsyetimin e tyre, në kuadër të vlerësimit të përshtatshmërisë së masës së sigurimit personal dhe nevojave të sigurimit në rastin konkret, krahas rrezikut që diktonte dhe justifikonte vendosja e masave të sigurimit, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm e kanë analizuar dhe vlerësuar atë edhe në raport me rëndësinë e faktit, rrezikshmërinë e lartë të veprës penale dhe pasojat e

ardhura prej saj, sanksionin vetëm me burgim që parashikohet për atë vepër penale, rolin e personit nën hetim, sikundër edhe me praninë e rrethanave rënduese dhe atyre lehtësuese. Në vlerësimin tonë, ato (gjykatat) kanë arsyetuar mjaftueshëm në drejtim të proporcionalitetit të masave së sigurimit personal, duke parashtruar gjerësisht arsyet se përse nevojat e sigurimit në rastin konkret diktonin caktimin ndaj kërkuesit të atyre masave. Nga ana tjetër, vlen të përmendet se kërkuesi në asnjë moment të procesit gjyqësor, por edhe në ankimin e tij kushtetues individual, papërshtatshmërinë e masave të sigurimit personal nuk e ka lidhur me aspektin numerik të tyre, pra se caktimi dhe zbatimi ndaj tij i dy masave të sigurimit personal ishte në vetvete jo proporcional.

13. Në përfundim, ne, gjyqtarët në pakicë, mbajtëm qëndrimin se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të proporcionalitetit në caktimin e masës së sigurimit "Ndalimi i daljes jashtë shtetit" është i pabazuar, prandaj duhej të ishte vendosur rrëzimi i kërkesës.

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Ilir Toska